



**ELEMENTE TË PRAKTIKËS  
SË MIRË TË IDENTIFIKUARA  
GJATË ZBATIMIT TË PROJEKTI  
TË PËRBASHKËT BE/KIE  
„NXITJA E TË DREJTAVE TË NJERIUT  
DHE E MBROJTJES SË PAKICAVE  
NË EVROPËN JUGLINDORE“**



Centre for  
Southeast  
European  
Studies



Financuar nga  
Bashkimi Europian



COUNCIL OF EUROPE



Zbatuar nga  
Këshilli i Europës



**Elemente të praktikës së mirë të  
identifikuara gjatë zbatimit të  
Projektit të përbashkët BE/KiE  
“Nxitja e të drejtave të njeriut dhe  
e mbrojtjes së pakicave  
në Evropën Juglindore”**

**Autor**

Ky botim është përgatitur nga Florian Bieber,  
Marko Kmezic, Emma Lantschner dhe Lura Pollozhani  
nga Qendra për Studime të Evropës Juglindore  
(Centre for Southeast European Studies)  
pranë Universitetit të Gracit, Austri.

*“Ky dokument është hartuar me ndihmën e fondeve  
të një projekti të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës.  
Pikëpamjet e shprehura në të nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se  
shprehin mendimin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës”*

Këshilli i Evropës

### **Versioni në gjuhën shqipe**

Të gjitha të drejtat e rezervuara.  
Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të  
përkthehet, riprodhohet apo transmetohet,  
në ndonjë mënyrë apo me ndonjë mjet  
elektronik (CD, Internet etj..) apo mekanik,  
duke përfshirë fotokopjimin, regjistrimin  
apo ruajtjen e informacionit, pa miratimin  
paraprak në formë të shkruar nga Drejtoria  
e Komunikimeve (F-67070 Strazburg Cedex  
ose [publishing@coe.int](mailto:publishing@coe.int))

### **Printimi dhe dizajni**

Dosije studio, Belgrade

### **Copyright©2016**

Këshilli i Europës

### **Bashkimi European**

Drejtoria e përgjithshme për Politikat e  
Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit

Rue da la Loi 15

B.1000 Brussels

[www.europa.eu](http://www.europa.eu)

### **Këshilli i Europës**

Avenue de l'Europe

F-67075 Strasbourg Cedex

[www.coe.int](http://www.coe.int)

# Pasqyra e Lëndës

---

LISTA E SHKURTIMEVE	5
PËRMBLEDHJE E DOKUMENTIT	7
I. KUADRI I MBROJTJES SË PAKICAVE NË EVROPËN JUGLINDORE	9
II. PRAKTIKAT E MIRA NË KUADËR TË PROJEKTIT TË PËRBASHKËT TË BE/KIE “NIXITJA E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE E MBROJTJES SË PAKICAVE NË EVROPËN JUGLINDORE”	43
VLERËSIMI I PRAKTIKAVE MË TË MIRA NË SHQIPËRI	
Të investosh në barazi: nxitja dhe promovimi i pjesëmarrjes së pakicave në pushtetin vendor dhe përmirësimi i realizimit të shërbimeve për komunitetet minoritare	45
VLERËSIMI I PRAKTIKAVE TË MIRA NË BOSNJË DHE HERCEGOVINË	
Shfrytëzimi i qëndrueshëm i teknologjive informatike në funksion të nxitjes së pakicave kombëtare nga zona e Bashkisë Gradishkë	55
VLERËSIMI I PRAKTIKAVE MË TË MIRA NË KROACI	
Fuqizimi i administratës për minoritarët çon në barazi	63
VLERËSIMI I PRAKTIKAVE MË TË MIRA NË MALIN E ZI	
Ndërmjetësit dhe asistentët arsimorë romë dhe egjiptianë	69
VLERËSIMI I PRAKTIKAVE MË TË MIRA NË SERBI	
Trigjuhësia elektronike	79
VLERËSIMI I PRAKTIKAVE MË TË MIRA NË ISH-REPUBLIKËN JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË	
Përmes vlerave kulturore tradicionale të komuniteteve drejt një jete më të mirë për qytetarët e Staro Nagoriçanës	85

# Pasqyra e Lëndës

---

## VLERËSIMI I PRAKTIKAVE MË TË MIRA NË KOSOVË\*

---

Komunitetet jo shumicë në vendimmarrje	93
III. REKOMANDIME	103
BIBLIOGRAFIA	109
RAPORTE DHE BAZA TË DHËNASH	113
SHTOJCA I	115
SHTOJCA II	116
SHTOJCA III	118

---

\* Ky emërtim nuk cenon qëndrimet për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën nr. 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe me Opinionin e GJND-së "Për deklaratën e pavarësisë së Kosovës".

## Lista e shkurtimeve

---

ACFC	Komiteti Këshillimor për Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare
COMEX	Komiteti i Ekspertëve i Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
KEGJRM	Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KMPK	Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare



## Përmbledhje e dokumentit

---

**S** hqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Serbia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Kosova\* janë angazhuar të sigurojnë mbrojtjen e pakicave kombëtare. Për të gjitha këto vende, zbatohet Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KMPK). Gjithashtu, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi dhe Serbia kanë nënshkruar dhe ratifikuar Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare (KEGJRM). Mirëpo, në praktikë të drejtat e pakicave nuk mbrohen gjithmonë sipas standardeve evropiane në Evropën Juglindore, sidomos në nivel vendor.

Për t'i dhënë përgjigje nevojës për përmirësimin e nivelit të përmbushjes së standardeve evropiane për mbrojtjen e pakicave që rrjedhin kryesisht nga KMPK dhe KEGJRM, projekti i përbashkët i BE/KiE "Nxitja e të drejtave të njeriut dhe e mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore" gjatë katër viteve të fundit ka synuar përmirësimin e mundësisë për t'i shfrytëzuar të drejtat e tyre për pakicat në nivel vendor. Pas zbatimit të 36 projekteve individuale në njësitë e vetëqeverisjes vendore në shtatë përfituesit e lartpërmendur, në këtë botim identifikohen elementet e praktikës së mirë që kanë lindur gjatë zbatimit të shtatë projekteve të parapërzgjedhura (nga një për përfitues). Në të vlerësohet shkalla e suksesit të këtyre projekteve sa i takon qëndrueshmërisë në kohë, nivelit të faktorit udhëheqës nga palët vendore gjatë zbatimit dhe efektit që kanë pasur në jetën e përditshme të pakicave kombëtare dhe komunitetin e gjerë ku jetojnë këto pakica. Në bazë të rasteve studimore individuale, në të identifikohen elementet e përsëritshme gjetkë dhe propozohen modele të praktikës së mirë që mund të përshtaten sipas nevojave dhe që trajtojnë çështje konkrete në fushën e mbrojtjes së pakicave për t'u shpërndarë më gjerë. Shpresohet se këto modele të nxjerra nga konteksti mund të përdoren në njësi të tjera të qeverisjes vendore në kuadrin rajonal dhe më gjerë.

Botimi fillon me një informacion të përgjithshëm të strukturuar lidhur me sistemet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të pakicave në shtatë vendet përfituese, duke i krahasuar me standardet e kërkuara nga KMPK dhe KEGJRM, me fokus veçanërisht te konstatimet e kohëve të fundit lidhur me mekanizmat përkatëse të monitorimit. Konstatimet përfshijnë secilin vend përfitues, duke u fokusuar në fushat që kanë rëndësi kritike për nxitjen me sukses të pakicave kombëtare: kultura minoritare, të drejtat gjuhësore, arsimi, mediat dhe pjesëmarrja e efektshme në jetën politike dhe ekonomike. Analiza empirike

gjurmton produktet e shtatë projekteve të parapërzgjedhura të mbrojtjes së pakicave, në mënyrë që të vlerësojë zbatimin praktik në nivel vendor, me qëllim përpilimin e përfundimeve të përgjithësuara dhe gjetjen e elementeve të përsëritshme. Studimi mbyllet me një trajtim të shkurtër të konstatimeve dhe rekomandimeve praktike për punën në të ardhmen në funksion të përmirësimit të nxitjes së të drejtave të pakicave në nivel vendor.

# I. Kuadri i mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore<sup>1</sup>

---

**Q**ëllimi i përgjithshëm i projektit të përbashkët BE/KiE “Nxitja e të drejtave të njeriut dhe e mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore” ka qenë përmirësimi i mundësisë për t’i shfrytëzuar të drejtat e tyre për pakicat në përputhje me standardet evropiane për mbrojtjen e pakicave që rrjedhin kryesisht nga Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KMPK) dhe nga Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare (KEGJRM). Pas zbatimit të 36 projekteve në nivel vendor në shtatë përfituesit (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Serbia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Kosova\*), në këtë botim identifikohen elementet e praktikës së mirë që kanë lindur gjatë zbatimit të shtatë projekteve të përzgjedhura (nga një për përfitues). Në të vlerësohet shkalla e suksesit të këtyre projekteve sa i takon qëndrueshmërisë në kohë, nivelit të faktorit udhëheqës nga palët vendore gjatë zbatimit dhe efektit që kanë pasur në jetën e përditshme të pakicave kombëtare dhe komunitetin e gjerë ku jetojnë këto pakica. Në bazë të rasteve studimore individuale, në të identifikohen elementet e përsëritshme gjatë dhe propozohen modele të praktikës së mirë për t’u shpërndarë më gjerë.

Për t’i vendosur këto shtatë projekte të përzgjedhura në kontekstin e tyre ligjor (kombëtar dhe ndërkombëtar), në këtë kapitull të parë jepet një informacion i përgjithshëm i strukturuar se si mbrohen aktualisht të drejtat e pakicave nga sistemet ligjore të shtatë vendeve përfituese. Do të flitet për secilin vend përfitues, duke u fokusuar në fushat që kanë rëndësi kritike për përmirësimin e jetës së pakicave kombëtare si: kultura minoritare, të drejtat gjuhësore, arsimi, mediat dhe pjesëmarrja e efektshme në jetën politike dhe ekonomike. Rezultatet e kësaj analize do të krahasohen me standardet që kërkohen në kuadër të KMPK-së dhe KEGJRM-së, duke u fokusuar në veçanti te konstatimet e fundit nga mekanizmat përkatës të monitorimit. Theks i veçantë do t’u vihet atyre fushave që kanë lidhje me projektet e veçanta që do të analizohen në pjesën e dytë të këtij botimi.

Në këtë kuadër, duhet theksuar se megjithëse KMPK dhe monitorimi i saj zbatohet për të shtatë vendet përfituese, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë vetëm

---

1 Kjo pjesë mbështetet në një version të rishikuar dhe përditësuar në mënyrë të konsiderueshme të Kapitullit 1.2 të studimit “Integrimi i të drejtave të njeriut në procesin e zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor, me fokus të veçantë te pakicat”, i realizuar me kërkesë të Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut të Parlamentit Evropian nga bashkautorët Emma Lantschner dhe Florian Bieber, 2012.

e ka nënshkruar (që në vitin 1996) por nuk e ka ratifikuar KEGJRM-në, ndërsa Shqipëria, as e ka nënshkruar, as e ka ratifikuar këtë instrument, megjithëse të dyja këto vende janë angazhuar ta nënshkruajnë dhe ratifikojnë Kartën kur kanë aderuar në Këshillin e Evropës. Autoritetet shqiptare kanë premtuar ta përfshijnë nënshkrimin e Kartës në agjendën e tyre<sup>2</sup> dhe në takimet ndërmjet autoriteteve shqiptare dhe ekspertëve të Këshillit të Evropës është diskutuar për një projekt-instrument paraprak ratifikimi në prill 2014.<sup>3</sup> Mirëpo, konkluzionet e një grupi pune për reformimin e legjislationit shqiptar për pakicat kombëtar kanë sugjeruar vetëm një “ekzaminim të situatës, me qëllim nënshkrimin dhe ratifikimin e Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare”.<sup>4</sup> Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, hë për hë, nuk është duke ndërmarrë asnjë hap drejt ratifikimit të KEGJRM-së. Sa i takon Kosovës\*, Këshilli i Evropës ka nënshkruar një marrëveshje të posaçme me UNMIK për zbatimin e KMPK-së, por jo të KEGJRM-së. KEGJRM pra zbatohet vetëm për katër nga shtatë vendet përfituese. Ndërkohë që Kroacia, Serbia dhe Mali i Zi kanë vendosur të zbatojnë të njëjtat pika të Pjesës III për të gjitha gjuhët e mbuluara nga kjo pjesë, Bosnja dhe Hercegovina ka bërë disa ndryshime të vogla lidhur me gjuhën rome.

Është përgjegjësia e shteteve palë të KMPK-së dhe KEGJRM-së që të përcaktojnë pakicat kombëtare dhe gjuhët minoritare për të cilat synojnë ta zbatojnë dokumentin përkatës. Për shkak se KEGJRM përmban një përkufizim të gjuhëve rajonale ose minoritare dhe gjuhët joterritoriale, marzhi i vlerësimit (pra i diskrecionit shtetëror) duket më i kufizuar në krahasim me KMPK-në, që nuk përmban asnjë përkufizim të pakicës kombëtare. Në të dyja rastet, dy organet monitoruese e konsiderojnë si detyrë të tyre të shohin nëse kjo zgjedhje është në përputhje me frymën e KMPK-së dhe me përmbajtjen e KEGJRM-së. Pra, objekti i zbatimit është diçka që evoluon gjatë cikleve të monitorimit si pasojë e dialogut ndërmjet shtetit palë, nga njëra anë, dhe organit monitorues, nga ana tjetër. Në tabelën më poshtë jepet një përmbledhje e situatës aktuale në këtë aspekt.

Tabela 1: Grupet minoritare/gjuhët minoritare që mbulohen nga KMPK dhe KEGJRM

	Pakicat që mbulohen nga KMPK	Gjuhët minoritare që mbulohen nga KEGJRM
Shqipëria	Grekë, maqedonas, malazezë dhe serbë, si pakica kombëtare; romë dhe arumunë/vllahë si pakica etno-gjuhësore <i>ACFC: të mendohet përfshirja e egjiptianëve dhe boshnjakëve</i>	NA

- 2 Shih, për shembull, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Raport Dyvjeçar “Zbatimi i Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare” i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për Asamblenë Parlamentare, 3 mars 2014.
- 3 Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Raport Dyvjeçar “Zbatimi i Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare” i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për Asamblenë Parlamentare, 2 mars 2016.
- 4 Ministria shqiptare e Integritimit Evropian, Raport Vjetor Progresi, 2015. Kontributi shqiptar – fusha II. maj-shtator 2015, 194.

	Pakicat që mbulohen nga KMPK	Gjuhët minoritare që mbulohen nga KEGJRM
Bosnja dhe Hercegovina	Shqiptarë, çekë, gjermanë, hungarezë, italianë, çifutë, maqedonas, malazezë, polakë, romë, rumunë, rusë, rutenë, sllovakë, sllovenë, turq, ukrainas	Pjesa II dhe III: gjuhët shqipe, çeke, gjermane, hungareze, italiane, ladine, polake, rome, rumune, rutene, sllovaqe, sllovene, turke, ukrainase dhe jidish <i>Në dritën e informacioneve që jepen në raportin e dytë për situatën, COMEX vendosi të mos e monitorojë maqedonishten dhe gjuhën malazeze (megjithëse përmbahen në dokumentin e ratifikimit) meqë nuk përdoren tradicionalisht në Bosnjë dhe Hercegovinë. Shih raportin e dytë të COMEX për Bosnjën dhe Hercegovinën, 2016, pika 14</i>
Kroacia	Shqiptarë, austriakë, boshnjakë, bullgarë, çekë, gjermanë, hungarezë, italianë, çifutë, maqedonas, malazezë, polakë, romë, rumunë, rusë, rusinë, serbë, sllovakë, sllovenë, turq, ukrainas, vllahë <i>ACFC: të mendohet përfshirja e myslimanëve</i>	Pjesa II: Gjuhët rumune në versionin bojash, gjermane, sllovene (plus gjuhët e Pjesës III) Pjesa III: Gjuhët çeke, hungareze, italiane, rutene, serbe, sllovaqe dhe ukrainase <i>Kroacia ka shprehur rezervë lidhur me zbatimin e Kartës për gjuhën rome.</i>
Mali i Zi	Serbë, boshnjakë, shqiptarë, myslimanë, kroatë dhe "të tjerët" <i>ACFC: të vijohet dialogu me "të tjerët", të përshtatet ligji për pakicat me Kushtetutën (kjo e fundit nuk e përfshin shtetësinë si kriter për përkufizimin e pakicave), që ka sidomos rëndësi për romët dhe egjiptianët</i>	Pjesa II: Gjuhët boshnjake, kroate (plus gjuhët e Pjesës III) Pjesa III: Gjuhët shqipe, rome <i>Serbisht-folësit nuk dëshirojnë që gjuha e tyre të mbulohet nga Karta</i>
Serbia	Nuk ka listë, të gjitha grupet që mbulohen nga kriteret e nenit 2 të ligjit serb për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare. Në raportin më të fundit mbi situatën përfshihen: shqiptarët, ashkallitë, boshnjakët, bullgarët, bunjevçët, vllahët, goranët, grekët, egjiptianët, çifutët, jugosllavët, hungarezët, maqedonasit, myslimanët, gjermanët, romët, rumunët, rusët, rutenët, sllovakët, sllovenët, turqit, ukrainasit, kroatët, xinxarët, malazezët, çekët, shokqët	Pjesa II: Gjuhët bunjevce, çeke, gjermane, maqedonase, vllahe (plus gjuhët e Pjesës III) Pjesa III: Gjuhët shqipe, boshnjake, bullgare, kroate, hungareze, rome, rumune, rutene, sllovaqe, ukrainase

	Pakicat që mbulohen nga KMPK	Gjuhët minoritare që mbulohen nga KEGJRM
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	Shqiptarë, turq, vllahë, serbë, romë, boshnjakë <i>ACFC: të mendohet përfshirja e egjiptianëve dhe kroatëve</i>	NA
Kosova*	Serbë, turq, boshnjakë, goranë, romë, ashkali, egjiptianë, kroatë, malazezë	NA

Shumica e përfituesve (Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë) i përkufizojnë pakicat, mes kritereve të tjera, në bazë të shtetësisë. Sipas Komitetit Këshillimor për Konventën Kuadër për Mbrotjtjen e Pakicave Kombëtare (ACFC), kjo nuk përbën shkelje të asnjë instrumenti ndërkombëtar me fuqi ligjore,<sup>5</sup> por, duke pasur parasysh shpërbërjen e Jugosllavisë dhe shpalljen e pavarësisë më pas nga Mali i Zi dhe Kosova\*, kjo është sidomos problematike për personat pa një status të qartë shtetësie. Nga ky problem preken veçanërisht romët. Një kriter i tillë mund të cenojë ushtrimin e të drejtave të këtyre personave. Në këtë kuadër, ACFC rregullisht përmend për referim raportin e Komisionit të Venecias për personat pa shtetësi dhe të drejtat e pakicave.<sup>6</sup> Sipas këtij raporti, kriteri i shtetësisë është mirë të përdoret vetëm në kuadër të atyre dispozitave që e bëjnë të nevojshme këtë kërkesë, për shembull në lidhje me të drejtat zgjedhore në nivel kombëtar, por të mos përdoren përgjithësisht për përkufizimin e një pakice.

Sa i takon të drejtës për vetë-identifikim, disa shtete kanë krijuar lista në legjislacionin e tyre për të përcaktuar se cilat janë pakicat në territorin e tyre. Edhe kur janë të hapura këto lista, duket e vështirë për pakicat e papërfshira në listë që të njihen apo që të përdorin të drejtat e parashikuara për pakicat e “përfshira në listë” apo të drejtat që u jep KMPK. Megjithëse njohja nga shteti, as nuk është e nevojshme për të “ekzistuar” si pakicë, as nuk është parakusht për të përfituar mbrotjtje nga KMPK,<sup>7</sup> është gjithsesi e rëndësishme për shkak të përjashtimit nga të drejtat që garanton shteti.

Një sfidë e përbashkët e vendeve të Evropës Juglindore është sigurimi i të dhënave statistikore të besueshme. Deri tani, ky është sidomos problem në Shqipëri<sup>8</sup> dhe

5 Shih, për shembull, ACFC, opinion i tretë për Kroacinë, 2010, pika 42–46.

6 Komisioni i Venecias, Raport për personat pa shtetësi dhe të drejtat e pakicave, miratuar më 15–16 dhjetor 2006 CDL-AD(2007)001.

7 Shih, për shembull, ACFC, opinion i tretë për Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, 2011, pika 33. Të gjitha referimet për monitorimin janë marrë nga opinioni i tretë, sepse opinioni i katërt për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, i miratuar në shkurt 2016, ishte ende rezervat në kohën e hartimit të dokumentit.

8 Në rastin e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, ACFC shprehte shqetësim lidhur me përdorimin e gjobave në rastet kur informacionet e dhëna në kuadër të regjistrimit të popullsisë nuk përkonin me të dhënat e gjendjes civile. Ai u bënte thirrje autoriteteve “të respektojnë rreptësisht të drejtën për vetë-identifikim ... Në veçanti, Komiteti Këshillimor i nxiste autoritetet të mos vendosnin asnjë gjobë kundër personave që ushtronin të drejtën e tyre për vetë-identifikim. ACFC, opinion i tretë për Shqipërinë, 2011, pika 30–51. Rezultatet

në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.<sup>9</sup> Në Bosnjë dhe Hercegovinë, pas vitit 1991 censusi i parë i popullsisë u zhvillua në vitin 2013. Rezultatet përfundimtare u botuan në korrik 2016. Siç është theksuar nga ACFC në “Shpjeguesin tematik për pjesëmarrjen”, “të dhënat e besueshme dhe lehtësisht të arritshme janë një parakusht thelbësor për zhvillimin e masave të efektshme në përgjigje të diskriminimit shoqëroro-ekonomik dhe për nxitjen e barazisë së efektshme”.<sup>10</sup> Edhe kur ekzistojnë rezultate nga censusi, pakicat shpesh numërohen më pak nga ç’janë.

## Kultura minoritare

---

Nxitja e “kushteve të nevojshme që personat që u përkasin pakicave kombëtare ta ruajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet e identitetit të tyre” është detyrimi qendror i shteteve palë të KMPK-së, sipas nenit 5. Në bazë të kësaj dispozite, veprimtaritë monitoruese të ACFC-së fokusohen te mbështetja financiare që japin institucionet në nivel qendror ose vendor për mbrojtjen dhe nxitjen e kulturave të pakicave dhe ngritja e një sistemi transparent të caktimit të fondeve i cili parashikon mundësinë e përfshirjes në mënyrë adekuate të përfaqësuesve të pakicave. Sipas KEGJRM-së, të gjitha vendet që e kanë ratifikuar këtë instrument kanë përzgjedhur sipërmarrjen për të nxitur veprimtaritë kulturore që janë specifike për gjuhët minoritare rajonale në këto gjuhë. Krahas kësaj, Serbia dhe Mali i Zi angzhohen të ndihmojnë shpërndarjen e veprave në gjuhët minoritare përtej bashkësisë gjuhësore të tyre dhe të mbështesin mundësinë që u jepet gjuhëve minoritare për të pasur vepra të nxjerra në gjuhë të tjera (nëpërmjet mbështetjes së përkthimeve etj.). Të gjithë përfituesit u angazhuan të nxisnin pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të përfaqësuesve të përdoruesve të gjuhëve minoritare në planifikimin e veprimtarive kulturore. Të gjitha vendet përfituesve, përveç Kroacisë, ndërmorën promovimin e veprimtarive kulturore edhe jashtë zonës në të cilën është përdorur historikisht një gjuhë e caktuar minoritare.

Në Shqipëri, mungojnë masat legjislative ose masa të tjera për mbrojtjen dhe promovimin e kulturave minoritare. Plani Kombëtar i Veprimit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit 2007–2013 parashikonte krijimin e një fondi të posaçëm për të financuar projekte që synojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kulturave minoritare, por ky fond nuk është krijuar. ACFC ka konstatuar se financimi që jepet mbi baza ad hoc është “jo adekuat dhe i paqëndrueshëm”.<sup>11</sup>

Ligjet në nivel shteti dhe entiteti në Bosnjë dhe Hercegovinë i detyrojnë shtetin, entitetet, kantonet dhe bashkitë të caktojnë fonde në buxhet për të mbështetur

---

e regjistrimit të popullsisë janë kundërshtuar nga përfaqësuesit e pakicave me argumentin se nuk pasqyrojnë realitetin në terren. Shih rezolutën e Komitetit të Ministrave për zbatimin e KMPK-së nga Shqipëria, 2014.

9 Regjistrimi i popullsisë i planifikuar për në vitin 2011 u ndërpre dhe u anulua. Përdorimi i regjistrave administrativë konsiderohet si një metodë alternative, krahas regjistrimit të popullsisë. Komisioni Evropian, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Raport Progresi, 2014, 7.

10 ACFC, “Shpjegues për pjesëmarrjen e efektshme të personave që u përkasin pakicave kombëtare në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe në çështjet publike”, ACFC/31DOC(2008)001, 4.

11 ACFC, opinioni i tretë për Shqipërinë, 2011, pika 26 dhe 79–83.

punën e shoqatave të pakicave kombëtare.<sup>12</sup> Në praktikë, shumë pak shoqata marrin mbështetje dhe shumat e livruara janë shumë të ulëta. Duke pasur parasysh sa të vogla janë pakicat, ACFC e konsideronte thelbësore rritjen e mbështetjes për ruajtjen e kulturës së pakicave. Shumica e masave merren në nivel bashkiak, që nuk duken në nivel entiteti apo shteti. Sipas mendimit të ACFC-së, pakicat nuk konsultohen sa duhet në proceset vendimmarrëse që lidhen me financimin e veprimtarive në fushën e kulturës minoritare.<sup>13</sup> Po kështu, Komiteti i Ekspertëve i Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare (COMEX) e ka kritikuar mungesën e një skeme të përkushtuar që do duhej të jepte mbështetje financiare të rregullt dhe të qëndrueshme për veprimtaritë kulturore dhe objektet e lidhura me gjuhët minoritare. Fondet ekzistuese jepen në bazë projekti, në nivel bashkiak ose kantonal.<sup>14</sup>

Në Kroaci, Këshilli për Pakicat Kombëtare ka detyrën të “livrojë fonde nga buxheti qendror të caktuara për nevojat e pakicave kombëtare.”<sup>15</sup> Përfaqësuesit e pakicave kanë kritika për mundësitë e pabarabarta në marrjen e fondit, me pretendimin se Këshilli priret të favorizojë disa shoqata të caktuara. Përfaqësuesit e pakicave e perceptojnë shpërndarjen e fondeve si të pamjaftueshme, por në nivel vendor ka mbështetje shtesë. Përfaqësuesit e pakicave gjerësisht kanë mendimin se qasja kundrejt kulturës së pakicave kombëtare është me “orientim folklorik”. ACFC rekomandon nxitjen e ngjarjeve ndërkulturore dhe përpjekjet kundër mbajtjes së kulturës minoritare në skajet e shoqërisë duke e konsideruar si të veçuar apo të huaj.<sup>16</sup> Në raportin e tij më të fundit për Kroacinë, COMEX komentonte vetëm për krijimin e një organi “përgjegjës për mbledhjen, mbajtjen e një kopjeje dhe prezantimin ose botimin e veprave të nxjerra në gjuhët minoritare ose rajonale” dhe konstatonte se Kroacia i përmbushte këto detyrime.

Në Malin e Zi, Ligji për Kulturën, i vitit 2008, rregullon nxitjen e kulturës në bazë të ruajtjes së barabartë të të gjitha identiteteve kulturore dhe respektimin e larmisë kulturore. Ai vendos mbi shtetin detyrimin për të krijuar kushtet për “ruajtjen e kulturës origjinale dhe tradicionale dhe të karakteristikave etno-kulturore.”<sup>17</sup> Programi Kombëtar për Zhvillim Kulturor 2011–2015 përfshin objektiva dhe prioritete për zhvillimin e kulturës në Malin e Zi si një “vend shumëkombësh, shumëkulturor dhe shumëfetar”. Në vitin 2009 është ngritur Qendra për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Kulturave Minoritare. Pavarësisht nga të gjitha këto masa, sipas raporteve, mbështetja financiare është tepër e kufizuar dhe e pamjaftueshme dhe përfaqësuesit e pakicave nuk përfshihet sa duhet në proceset e vendimmarrjes për shpërndarjen e fondeve. Në raportin më të fundit të COMEX për zbatimin e KEGJRM-së në Malin e Zi, Komiteti monitoronte vetëm zbatimin e pikës që ka të bëjë me nxitjen e veprimtarive kulturore jashtë zonës ku është përdorur historikisht një gjuhë minoritare, por nuk qe në gjendje të arrinte në një përfundim lidhur me përmbushjen e këtij angazhimi.

12 Ligji Shtetëror për Pakicat Kombëtare, neni 8; Ligji për Pakicat Kombëtare i Republikës Srpska, neni 5; Ligji për Pakicat Kombëtare i Federatës, neni 6.

13 ACFC, opinioni i tretë për Bosnjën dhe Hercegovinën, 2013, pika 81–84.

14 COMEX, raporti i parë për Bosnjën dhe Hercegovinën, 2013, në konstatim të

15 Ligji kushtetues për mbrojtjen e pakicave kombëtare (LKPK), neni 35, pika 4.

16 ACFC, opinioni i katërt për Kroacinë, 2015, pika 36–40.

17 ACFC, opinioni i dytë për Malin e Zi, 2013, pika 79.

Ligj serb për Këshillat Kombëtarë për Pakicat Kombëtare, i vitit 2009, dhe rregulloret në nivel shteti dhe province për shpërndarjen e fondeve publike për funksionimin e tyre ka kontribuar për të pasur më shumë qartësi lidhur me fondet që mund të jepen për veprimtaritë minoritare. ACFC konstatonte në opinionin e tij të fundit, se financimi është rritur. Por, sipas raporteve, disa pakica më të vogla ose të njohura tani vonë vihen në pozita të pafavorshme nga sistemi i shpërndarjes së fondeve. Gjithashtu, ka mospërputhje ndërmjet mbështetjes së gatshme për pakicat për të cilat këshilli i pakicave ndodhet në Vojvodinë dhe për pakicat për të cilat këshilli ndodhet në pjesë të tjera të Serbisë, duke qenë se Vojvodina ofron mbështetje tjetër shtesë në nivel province.<sup>18</sup> Sipas COMEX, shumica e angazhimeve nuk janë përbushur ose Komiteti nuk qe në gjendje të arrinte në një përfundim lidhur me përbushjen e tyre. Në nivel të kënaqshëm u vlerësua vetëm mundësia që u jepej gjuhëve bullgare dhe ukrainase për vepra kulturore të nxjerra në gjuhë të tjera.

Ministria e Kulturës e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (e cila ka ngritur një Zyrë për Nxitjen dhe Çuarjen Përpamë Kulturës së Komuniteteve) dhe autoritetet vendore ofrojnë financim në mbështetje të kulturës së komuniteteve minoritare. ACFC vërente se bashkëbiseduesve të ndryshëm financimi u dukej i pamjaftueshëm, sidomos për grupet me një numër më të vogël anëtarësh. ACFC vërente edhe se pakicat nuk përfshihen sa duhet në vendimmarrjen për shpërndarjen e fondeve.<sup>19</sup> Projekti i zbatuar në Nagoriçanin e Vjetër që analizohet më poshtë kishte si grupe të synuara dy pakica me numër më të vogël anëtarësh—serbët dhe romët—dhe është shembull i faktit se shumë shpesh i mbetet nivelit vendor t’u japë mbështetje veprimtarive kulturore të pakicave kombëtare.

Kosova\* nuk parashikon një sistem të institucionalizuar për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës së komuniteteve më të vogla. Kështu, këtyre komuniteteve u duket se nxitet dhe mbrohet vetëm kultura serbe. ACFC vërente “me shqetësim të madh mungesën e një politike kulturore që të ketë qartë si synim një shoqëri shumëkulturore.”<sup>20</sup>

Një çështje e përbashkët për të gjitha vendet përfituese është se mbështetja financiare publike është e kufizuar dhe nuk është e mjaftueshme për të ruajtur dhe zhvilluar kulturën minoritare. Në disa prej vendeve, kjo cenon sidomos pakicat më të vogla.<sup>21</sup> ACFC u bën thirrje autoriteteve të kërkojnë rritjen e fondeve të gatshme për kulturën minoritare dhe të sigurojnë që vështirësitë financiare të mos prekin në mënyrë jo proporcionale kulturën minoritare. Në shumicën e vendeve përfituese, ACFC konstatonte edhe se përfaqësuesit e pakicave nuk angazhohen sa duhet në vendimmarrjen për shpërndarjen e fondeve për projekte kulturore.<sup>22</sup> Në rastin e Kroacisë dhe të Kosovës\*, ACFC shprehimisht nxiste vendosjen e një fokusi më të fortë të veprimtaritë ndërkulturore dhe shumëkulturore, me synim krijimin e një shoqërie shumëkulturore dhe nxitjen e diversitetit.

18 ACFC, opinionin i tretë për Serbinë, 2013, pika 85–90.

19 ACFC, opinionin i tretë për Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, 2011, pika 75–78.

20 ACFC, opinionin i tretë për Kosovën\*, 2013, pika 64.

21 Sipas konstatimeve të ACFC-së, kjo vlen për Bosnjën dhe Hercegovinën, Serbinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovën\*.

22 Sipas konstatimeve të ACFC-së, kjo vlen për Bosnjën dhe Hercegovinën, Malin e Zi, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovën\*.

Nenet 10 dhe 11 të KMPK-së dhe neni 10 i KEGJRM-së rregullon përdorimin e gjuhëve minoritare në marrëdhëniet me autoritetet administrative si edhe sinjalistikën topografike. Për detyrimin e shteteve lidhur me të parën, KMPK parashikon një sërë kufizimesh. Një zonë duhet të "banohet nga persona që u përkasin tradicionalisht pakicave kombëtare ose që janë në një numër të konsiderueshëm", këta personat duhet të "kërkojnë një gjë të tillë"<sup>24</sup> dhe nëse "kërkesa përkon me një nevojë reale, Palët ndërmarrin të sigurojnë sa më shumë kushtet që do të bënin të mundur përdorimin e gjuhës minoritare në marrëdhëniet ndërmjet këtyre personave dhe autoriteteve administrative. Kushtet për të dytën nuk janë po aq të shumta, por zona duhet "tradicionalisht të banohet nga një numër i konsiderueshëm personash që i përkasin një pakice kombëtare". KEGJRM, nga ana tjetër, nuk kërkon bërjen e një kërkesë nga personat e interesuar dhe as që kjo kërkesë të përkojë me një nevojë reale. Karta ofron një grup mundësish nga të cilat të mund të zgjidhet, që nga vendosja në mënyrë të drejtë e barazimit midis gjuhës shtetërore dhe minoritare deri në ofrimin e përkthimit me shkrim ose me gojë, sipas nevojës. Numri i banorëve që e përdorin gjuhën minoritare duhet të justifikojë sipërmarrjen e përzgjedhur. Shtetet palë kanë detyrimin të zgjedhin të paktën një nga 21 pikat dhe paragrafët. Të gjitha vendet që e kanë ratifikuar KEGJRM-në premtojnë të sigurojnë që përdoruesit e gjuhëve minoritare të mund të bëjnë kërkesa me gojë dhe me shkrim në zyrat e shtetit, autoritetet rajonale dhe vendore dhe t'i lejojnë autoritetet administrative shtetërore t'i hartojnë dokumentet në një gjuhë të tillë. Ato angazhohen edhe që të përdorin ose miratojnë toponime në gjuhët rajonale ose minoritare nëse numri i përdoruesve të një gjuhe minoritare në bashkinë ose rajonin në fjalë është aq sa për ta justifikuar këtë masë. Angazhimet e tjera ndryshojnë, sipas vendit.

Si ACFC, ashtu edhe COMEX, janë marrë shumë me çështjen se çfarë është numri i konsiderueshëm (që e kërkon KMPK) apo numri që justifikon një masë të caktuar (që e kërkon KEGJRM). Në këtë aspekt, legjislacioni i vendeve përfituese ka këtë pamje:

Ligj shtetëror për pakicat kombëtarë i Bosnjës dhe Hercegovinës<sup>25</sup> i detyron bashkitë me shumicë<sup>26</sup> të popullsisë minoritare të përdorin gjuhën e kësaj pakice në marrëdhëniet ndërmjet autoriteteve vendore dhe personave që i përkasin pakicës kombëtare. Kur ka një popullsi minoritare që përbën të paktën një të tretën e popullsisë gjithsej, bashkia mund të vendosë ta lejojë këtë përdorim.

23 Mbështetur në një version të rishikuar dhe të përditësuar në mënyrë të konsiderueshme të botimit të Emma Lantschner, "Emerging European Standards of Minority Protection through Soft Jurisprudence?" (Standardet e reja evropiane të mbrojtjes së pakicave përmes praktikës gjyqësore jo të detyrueshme), në Emma Lantschner e të tjerë (red.), *European Integration and its Effects on Minority Protection in South Eastern Europe* (Integrimi evropian dhe pasojat për mbrojtjen e pakicave në Evropën Juglindore), Nomos, Baden-Baden, 2008, f. 53–83, në f. 65–67.

24 Theksi është i shtuar. Kjo do të thotë se secili nga të dy kriteret mjafton për të kërkuar përfitimin e kësaj të drejte.

25 Ligji për të Drejtat e Pakicave Kombëtare, 2003, neni 12.

26 Fillimisht, ligji kërkonte një shumicë "absolute ose relative" të popullsisë minoritare, kërkesë që u hoq me ndryshimet e bëra në vitin 2005.

Ligjet e të dyja entiteteve<sup>27</sup> janë më elastike, në kuptimin që nuk parashikojnë një prag minimal që duhet arritur në mënyrë që bashkitë të vendosin vetë për të lejuar përdorimin e gjuhëve minoritare. Të njëjtat pragje minimale zbatohen për përdorimin e emërtimeve topografike. Por kjo situatë ligjore ka bërë që në praktikë të ketë raste të rralla vetëm, çka justifikohet nga autoritetet me faktin se anëtarët e pakicave flasin gjuhët zyrtare dhe nuk kanë kërkuar përdorimin e gjuhës së tyre në marrëdhëniet me organet zyrtare apo në emërtimet topografike. Fillimisht, legjisllacioni kroat për përdorimin e gjuhës minoritare në marrëdhëniet administrative në nivel vendor dhe për emërtimet topografike parashikonte një prag minimal prej 50% i cili më pas u ul në një e treta, me mundësinë për futjen në mënyrë vullnetare të gjuhës minoritare në përdorim zyrtar me ligj nën këtë prag minimal.<sup>28</sup> Neni 11 i Ligjit për pakicat i Malit të Zi, i vitit 2006, kërkon që pakicat të përbëjnë “shumicën ose një pjesë të konsiderueshme të popullsisë” për të përdorur gjuhën minoritare në marrëdhëniet me administratën publike ose për emërtimet topografike. Legjisllacioni maqedonas parashikon një prag minimal prej 20% për emërtimet topografike në gjuhë minoritare dhe për përdorimin e kësaj gjuhe me autoritetet publike.<sup>29</sup> Në Serbi ky prag minimal është vendosur në 15%.<sup>30</sup>

Nga opinionet e ACFC-së për këto vende përfutuese del qartë se një përqindje e popullsisë minoritare edhe sa 50% e popullsisë së një bashkie shkon përtej kërkesës për “numër të konsiderueshëm”.<sup>31</sup> Në rastin e Malit të Zi, ACFC qe e mendimit se formulimi në ligj “mund të bëhet objekt i interpretimeve kufizuese” dhe, për rrjedhojë, u kërkonte autoriteteve të “siguronin qartësi ligjore në mënyrë që të sigurohet se autoritetet vendore ta interpretojnë këtë kërkesë në mënyrë të tillë që të përputhet me parimet e Konventës Kuadër”.<sup>32</sup> Në opinionin e dytë për Kroacinë, ACFC e mirëpret uljen e përqindjes së nevojshme në popullsi nga shumicë në një të tretën, por qe ende e mendimit se kjo përjashtonte një sërë bashkish me një numër të konsiderueshëm personash që u përkasin pakicave kombëtare.<sup>33</sup> Në opinionin e

27 Ligji për Mbrojtjet e të Drejtave të Pakicave Kombëtare të Republikës Srpska, 2005, dhe Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Anëtarëve të Pakicave Kombëtare në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës, në të dy ligjet neni 9.

28 Shih Nenin 12 të LKPK-së (ku parashikohet përdorimi zyrtar i gjuhëve minoritare nëse miratohet edhe në traktatet ndërkombëtare) dhe nenin 4 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhës dhe Alfabetit të Pakicave Kombëtare.

29 Neni 7 i Kushtetutës; Ligji për Vetëqeverisjen Vendore, Fletorja Zyrtare e RM nr.5/2002; Ligji për Përdorimin e Gjuhëve të Folura nga të paktën 20% e Shtetasve të Republikës së Maqedonisë dhe e Njësisve të Qeverisjes Vendore, Fletorja Zyrtare e RM nr.101/2008. ACFC gjithashtu mirëpriste “faktin se autoritetet vendore kanë mundësinë të vendosin për përdorimin e gjuhëve që fliten nga më pak se 20% e popullsisë (shih nenin 7 të Kushtetutës dhe nenin 90, pika 2, të Ligjit për Vetëqeverisjen Vendore, datë 24 janar 2002).” ACFC, opinion i parë për Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, 2004, pika 69.

30 Neni 11 i Ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Pakicave Kombëtare. Për kompetencat e Këshillave Kombëtarë të Pakicave Kombëtare në fushën e përdorimit zyrtar të gjuhëve dhe alfabetit, shih nenet 21–22 e Ligjit për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare, i vitit 2009.

31 Për emërtimet topografike, për shembull, ACFC, opinionin i parë për Bosnjën dhe Hercegovinën, 2004, pika 82, opinionin i dytë për Bosnjën dhe Hercegovinën, 2008, pika 163 dhe opinionin i parë për Kroacinë, 2001, pika 46. Për kontaktet me autoritetet publike, për shembull, ACFC, opinionin i parë për Bosnjën dhe Hercegovinën, 2004, pika 78–81, opinionin i dytë për Bosnjën dhe Hercegovinën, 2008, pika 158 dhe opinionin i parë për Kroacinë, 2001, pika 43–45.

32 ACFC, opinionin i parë për Malin e Zi, 2008, pika 73 dhe 73.

33 ACFC, opinionin i dytë për Kroacinë, 2004, pika 112.

tretë, ACFC e quan pragun minimal prej një të tretash, që ende ekziston, si “të lartë”. Në mënyrë të ngjashme me opinionin e parë për Bosnjën dhe Hercegovinën,<sup>34</sup> ACFC rekomandon që të nxiten autoritetet në zonat ku pakicat nuk përbëjnë një të tretën e popullsisë por, gjithsesi, përbëjnë një numër të konsiderueshëm të banorëve në to “të përdorin kompetencën diskrecionare për të zbatuar mundësinë e përdorimit të një gjuhe minoritare në marrëdhëniet me autoritetet administrative.<sup>35</sup> Në opinionin e fundit, ACFC u rikujtonte autoriteteve kroate pikëpamjen e saj të përgjithshme se “pragjet numerike është mirë të mos përdoren në mënyrë tepër të shtrënguar dhe se është mirë të tregohet fleksibilitet dhe kujdes në veçanti kur përdoren të dhënat statistikore për zbatimin e të drejtave të pakicave.”<sup>36</sup> Në opinionin e dytë për Bosnjën dhe Hercegovinën, ACFC që e mendimit se pragu minimal prej një të tretash që parashikonte ligji shtetëror “në praktikë e pengonte përdorimin e gjuhëve minoritare, përfshirë edhe në zonat e banuara tradicionalisht nga persona që u përkasin pakicave kombëtare” (kusht i cili, i vetëm, do ta bënte nenin 10, pika 2, të KMPK-së të zbatueshëm)<sup>37</sup> dhe shprehimisht që e mendimit se ishte “tepër i lartë” në funksion të emërtimeve topografike.<sup>38</sup> Në opinionin e tretë përsëriste qëndrimin se do të duhej të bëhej më shumë për të vlerësuar nevojat dhe kërkesat e personave që u përkasin pakicave kombëtare.<sup>39</sup> ACFC dhe COMEX janë të një mendjeje se e konsiderojnë nivelin e njohurive për gjuhën shtetërore si të parëndësishëm për përcaktimin e nevojës dhe se kërkesa do të duhej të nxitej aktivisht.<sup>40</sup> Legjislacioni që fuste emërtimet topografike në një gjuhë minoritare ose lejonte përdorimin e një gjuhe minoritare me autoritetet publike me 20% popullsi minoritare, siç është rasti i legjislacioni maqedonas, ose 15% popullsi minoritare, siç është rasti i Serbisë, është mirëpritur nga ACFC.<sup>41</sup> Në këto raste, ACFC konstatonte vështirësi në zbatimin e këtyre të drejtave, që lidheshin me progres të ngadaltë, pjesërisht e lidhur me rezistencë në nivel vendor, mungesë të përkthyesve të kualifikuar ose njohuri të pamjaftueshme të gjuhëve minoritare nga ana e nëpunësve civilë. U rekomandohej shteteve të bënin përpjekje të tjera shpesh për të siguruar një zbatim më konsekuent dhe për të siguruar mjetet financiare për t’i kapërcyer këto probleme.

Qëndrimi i COMEX për kuotat është disi më strikt. Nëse nuk mund të arrihet një kuotë nga asnjë me përjashtim të një bashkie, kjo nuk është në përputhje me frymën e Kartës. COMEX e interpreton gjithmonë Kartën në kuptimin që vetëm pragu minimal prej 20% është tepër i lartë dhe se “numri i personave që justifikojnë masat e mbrojtjes sipas Kartës zakonisht është shumë më poshtë se kjo përqindje.”<sup>42</sup>

34 ACFC, opinioni i parë për Bosnjën dhe Hercegovinën, 2004, pika 79–82.

35 ACFC, opinioni i dytë për Kroacisë, 2004, pika 114 dhe opinioni i tretë për Kroacinë, 2010, pika 141.

36 ACFC, opinioni i katërt për Kroacinë, 2015, pika 57.

37 Shih edhe ACFC, opinioni i katërt për Kroacinë, 2015, pika 57.

38 ACFC, opinioni i dytë për Bosnjën dhe Hercegovinën, 2008, pika 158 dhe 163.

39 ACFC, opinioni i tretë për Bosnjën dhe Hercegovinën, 2013, pika 111 dhe 116.

40 Shih, për shembull, COMEX, raporti i parë për Bosnjën dhe Hercegovinën, 2013, pika 125 dhe 128, raporti i pestë për Kroacinë, 2014, pika 96.

41 20% për emërtimet topografike, ACFC, opinioni i parë për Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, 2004, pika 73; 20% për kontaktet me autoritet publike, ACFC, opinioni i parë për Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, 2004, pika 67–68; 15% për kontaktet me autoritetet publike, ACFC, opinioni i parë për Serbinë dhe Malin e Zi, 2003, pika 76.

42 Shih edhe COMEX, raporti i parë për Sllovakinë, 2005, pika 42, 44 dhe 47, përsëritur në raportin e pestë për Kroacinë, 2014, pika 25, dhe në raportin e tretë për Malin e Zi, 2015, pika 21.

Një kuotë prej 10%, në rrethana të caktuara, do të ishte e arsyeshme.<sup>43</sup> Për pasojë, COMEX qe i mendimit se pragu prej 15% i futur me legjislacionin serb e pengon zbatimin e Kartës në zonat e banuara nga një numër i mjaftueshëm folësish të një gjuhe minoritare. Ai e mirëpriste faktin se, gjithsesi, gjuhët rajonale dhe minoritare janë futur në përdorim zyrtar mbi baza vullnetare nga një sërë bashkish dhe i nxiste autoritetet të vijonin identifikimin e territoreve të tilla bashkiake.<sup>44</sup> Në rastin e Bosnjës dhe Hercegovinës, i nxiste autoritetet t'i ulnin pragjet minimale dhe të zbatonin angazhimet e përzgjedhura edhe kur nuk arriheshin këto pragje.<sup>45</sup> Bashkia e Gradishkës përmendet disa herë si një bashki veçanërisht e lidhur me zbatimin e angazhimeve sipas nenit 10 të KEGJRM-së. Përkthimi i faqeve zyrtare në internet të bashkisë apo afishimi i toponimeve në gjuhën minoritare në tabelat publike turistike janë përmendur si mënyra të zbatimit të angazhimeve të përzgjedhura nga Bosnja dhe Hercegovina lidhur me këtë nen. Gjithashtu, në rastin e Kroacisë, nxiste zbatimin e angazhimeve sipas nenit 10 në bashkitë me më pak se një të tretën popullsi minoritare. Qyteti i Pulës është përmendur në këtë kuadër si shembull i praktikës së mirë.<sup>46</sup> Por edhe në ato raste kur parashikohet zyrtarisht përdorimi i një gjuhe minoritare, COMEX konstatonte se praktika ndryshonte nga vendi në vend,<sup>47</sup> që nga përdorimi efektiv i italishtes, deri në përdorim pjesërisht (i hungarishtes, serbishtes), në emblematik (i çekishtes) apo deri në mospërdorim (i rutenishtes, sllovakishtes, ukrainishtes). Në mënyrë kritike, ai vërente mungesën e përdorimit të serbishtes për shkak të frikës nga mëria që ndienin folësit<sup>48</sup> apo për shkak të mungesës së plotë të ndërgjegjësimit në nivel qarku për detyrimet që rrjedhin nga Karta.<sup>49</sup> Në nëntor 2015, COMEX vendosi ta shqyrtonte zbatimin e Kartës ndërmjet dy cikleve të monitorimit, si reagim ndaj vendimit të bashkisë së Vukovarit për të mos vendosur tabela dygjuhëshe në institucionet zyrtare dhe rrugët e qytetit. Gjithashtu, vendosi ta ndiqte në vijimësi situatën dhe të fillonte një dialog me autoritetet për këtë çështje.<sup>50</sup> Opinioni i katërt i ACFC-së për Kroacinë (i vitit 2015) u kushtonte një pjesë të madhe komenteve në bazë të nenit 11 për këtë situatë. Ai qe thellësisht i shqetësuar për protestat e dhunshme kundër vendosjes së pllakave dygjuhëshe me shkronja latine dhe cirilike dhe i nxiste autoritetet “të rrisnin ndërgjegjësimin e publikut të Kroacisë për detyrimet ndërkombëtare dhe kombëtare kundrejt pakicave kombëtare.”<sup>51</sup> Në ngjashmëri me ACFC-në, COMEX i nxiste autoritetet malazeze të sqaronin se çfarë përbënte një “pjesë të konsiderueshme” të popullsisë duke qenë se paqartësia juridike në lidhje me këtë koncept, në praktikë mund të çojë në situata ku baskitë të marrin në konsideratë vetëm kriteri e shumicës kur të duan

43 Shih Jutta Engbers, “Artikel 10”, në Sigrid Boysen e të tjerë (redaktorë) Europäische Charta der Regional- oder Minderheitensprachen. Handkommentar, 2011, f. 249–284, në f. 257–258.

44 COMEX, raporti i dytë për Serbinë, 2013, pika 8–11.

45 COMEX, raporti i parë për Bosnjën dhe Hercegovinën, 2013, pika 35–36 dhe 136.

46 COMEX, raporti i pestë për Kroacinë, 2014, pika 27.

47 Opinioni i katërt për Kroacinë, 2015, pika 62, ACFC gjithashtu vërente se niveli i zbatimit të dispozitave ligjore ndryshonin “sipas nivelit të kohezionit në shoqëri”.

48 Për konstatime të ngjashme të ACFC-së shih opinionin e katërt për Kroacinë, 2015, pika 64–67.

49 COMEX, raporti i pestë për Kroacinë, konstatimi F.

50 Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Raport Dvyyjeçar “Zbatimi i Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare” i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për Asambleenë Parlamentare, 2 mars 2016, 9.

51 ACFC, opinionin e katërt për Kroacinë, 2015, pika 62–67.

të vendosin t'i japin një gjuhë minoritare statusin e gjuhës zyrtare.<sup>52</sup> Në përgjithësi, COMEX konstatonte se Mali i Zi paraqet praktikën më të mirë në zbatimin e Kartës në bashkitë ku shqipja përdoret zyrtarisht, ndërsa shumica e angazhimeve që kanë të bëjnë me gjuhën rome nuk janë përmbushur.<sup>53</sup>

Legjislacioni që është më mbështetëspër pakicat dhe më ambiciozi sa i takon përdorimit zyrtar të gjuhëve minoritare gjendet në Kosovë\*.<sup>54</sup> Sipas ligjit për përdorimin e gjuhëve, i vitit 2006,<sup>55</sup> shqipja dhe serbishtja janë të dyja gjuhë zyrtare dhe, si të tilla, kanë status të barabartë dhe të drejta të barabarta sa i takon përdorimit në të gjitha institucionet kosovare.<sup>56</sup> Në nivel bashkiak, gjuhët e tjera, si turqishtja, boshnjake dhe rome, mund të kenë "statusin e një gjuhë zyrtare" nëse të paktën 5% e banorëve të bashkisë janë anëtarë të një komuniteti të tillë. Në një rast të tillë, gjuha minoritare përdoret njësoj krahas shqipes dhe serbishtes.<sup>57</sup> Me ligj, në Prizren gjuha turke ka statusin e gjuhës zyrtare. Folësit e një gjuhë që ka statusin e gjuhës zyrtare kanë të njëjtat të drejta me folësit e shqipes dhe serbishtes.<sup>58</sup> Në bashkitë ku një komunitet minoritar përfaqëson të paktën 3% të popullsisë ose ku një gjuhë është folur tradicionalisht, gjuha e atij komuniteti gëzon "statusin e një gjuhë në përdorim zyrtar".<sup>59</sup> Folësit e këtyre gjuhëve kanë të drejtën t'u drejtohen institucioneve vendore me gojë ose me shkrim në gjuhën amtare dhe të marrin përgjigje po në atë gjuhë. Aktet nënligjore vendore duhet të përkthehen dhe të publikohen në një gjuhë në përdorim zyrtar vetëm nëse bën kërkesë komuniteti përkatës. Në punimet ose takimet e organeve përfaqësuese bashkiake dhe në mbledhjet publike të organizuara nga bashkia, anëtarët e komuniteteve gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare kanë të drejtën të përdorin gjuhën e tyre. Sipas kërkesës, sigurohet përkthim me gojë.<sup>60</sup> Ky legjislacion parashikon një nivel shumë më të lartë mbrojtjeje në krahasim me shumicën e vendeve të tjera evropiane, por zbatimi vijon të jetë një sfidë shumë e madhe për autoritetet në të gjitha nivelet. Kjo është theksuar edhe nga ACFC në opinionin e tij më të fundit, ku e përshkruante legjislacionin e Kosovës\* si "një prej me ambiciozëve në Evropë sa u takon pragjeve minimale të ulëta", por konstatonte se zbatimi "duket se është përkeqësuar më tej."<sup>61</sup> ACFC shprehte shqetësim lidhur me mungesën e vullnetit në shumë bashki për të ofruar qoftë edhe shërbimet bazë në gjuhët e komuniteteve minoritare dhe vështirësinë në

52 COMEX, raporti i tretë për Malin e Zi, 2014, pika 16–21.

53 Po aty, konstatimet A dhe D.

54 Mbështetur në një version të rishikuar dhe të përditësuar në mënyrë të konsiderueshme të botimit të Emma Lantschner, "Protection of Minority Communities in Kosovo: Legally Ahead of European Standards – Practically Still a Long Way to Go" (Mbrojtja e komuniteteve minoritare në Kosovë: ligjërisht më lart se standardet evropiane – praktikisht mbetet ende shumë për të bërë), 33(4) *Review of Central and East European Law*, 2008, f. 451–490, në f. 468–469.

55 Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, Ligj Nr. 02/L-37 miratuar më 27 korrik 2006.

56 Neni 1, pika 1, nënpika ii, dhe neni 2 Ligji për Gjuhët.

57 Neni 1, pika 2, dhe neni 2, pika 3, Ligji për Gjuhët.

58 Neni 7, Ligji për Gjuhët.

59 Neni 2, pika 4, Ligji për Gjuhët. Neni 2, pika 4, Ligji për Gjuhët. Për një informacion të përgjithshëm se cila gjuhë është zyrtare dhe në cilat zona, shih, Republika e Kosovës, Zyra e Komisionerit për Gjuhët, Monitorimi dhe vlerësimi i të drejtave gjuhësore në Kosovë, mars 2015, 25, në adresën <http://www.ecmikosovo.org/uploads/English322.pdf>.

60 Neni 8, Ligji për Gjuhët.

61 ACFC, opinionin i tretë për Kosovën\*, 2013, pika 18.

rritje për të rekrutuar nëpunës publikë që të zotërojnë të dyja gjuhët zyrtare, pa përmendur gjuhët përkatëse minoritare.<sup>62</sup>

Në mbyllje, ka informacion krahasues i përgjithshëm ka treguar se, me përjashtim të legjislacionit të Kosovës\*, ligjet e vendeve të tjera përfituese përdorin pragje (tepër) të larta duke ua lënë më së shumti kompetencës diskrecionare të autoriteteve vendore që të lejojnë përdorimin e gjuhëve minoritare në zonat ku popullsia minoritare është nën këto pragje minimale. Kështu, pra, ky legjislacion e shpërfill në shkallë të madhe faktin që të paktën neni 10, pika 2, për përdorimin e gjuhëve minoritare në marrëdhëniet me administratën publike është i zbatueshëm edhe në situatat ku pakica përkatëse banon “tradicionalisht” në një zonë të caktuar, pavarësisht sa e madhe është. Siç e thekson rasti i Kosovës\*, edhe pragjet e ulëta mund të mos jenë të mjaftueshme, nëse mungon zbatimi.

## E drejta për arsimim

---

Mundësia për të marrë arsim cilësor përgatit terrenin për pjesëmarrje në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike. Duke qenë se personat që u përkasin pakicave kombëtare mund të përballen me vështirësi në të gjitha fushat është me rëndësi maksimale që fëmijët që u përkasin pakicave kombëtare të marrin vëmendje të veçantë sa i takon të drejtës për arsimim.

Edhe pse nenet 12 deri 14 të KMPK-së janë dispozita që i kushtohen enkas arsimimit, nenet 4 deri 6 të KMPK-së janë po aq të lidhura me këtë. Sidomos neni 6 thotë se objektivi i politikave arsimore sipas KMPK-së është: nxitja dhe mbrojtja e gjuhëve dhe kulturave minoritare, zhvillimi i kontakteve dhe dialogut ndërkulturor, nxitja e një fryme tolerance në të gjitha përpjekjet arsimore dhe një etos i dygjuhësisë dhe shumëgjuhësisë. Krahas ofrimit të një game mundësish sa i takon mësimdhënies së gjuhëve minoritare ose në gjuhët minoritare në të gjitha nivelet e arsimit, neni 8 i KEGJRM-së përmban edhe angazhime të lidhura me mësimin e historisë dhe kulturës të pasqyruara nga gjuhët rajonale ose minoritare, formimin e mësuesve dhe ngritjen e mekanizmave monitorues për arsimin në gjuhët minoritare.

Kushtetuta e Shqipërisë<sup>63</sup> dhe Ligji për sistemin arsimor parauniversitar<sup>64</sup> u garantojnë personave që u përkasin pakicave kombëtare të drejtën e studimit dhe mësimin në gjuhën amtare dhe të drejtën për të mësuar për kulturën dhe historinë e tyre brenda kornizës së programeve dhe planeve mësimore. Sipas opinionit të fundit të ACFC-së, që i përket vitit 2011, “mundësitë për të mësuar gjuhët minoritare dhe për të mësuar në këto gjuhë mbeten të pamjaftueshme” dhe kërkesat e shumta për të mësuar gjuhët minoritare ose në gjuhët minoritare nuk janë pritur në mënyrë të favorshme nga autoritetet. Kështu, nxiten autoritetet ta intensifikonin dialogun me të interesuarit dhe të analizojnë propozimet ekzistuese.<sup>65</sup> Shqetësim të veçantë përbënte për ACFC-në situata e romëve, ku

---

62 Po aty.

63 Neni 20, pika 2, i Kushtetutës së Shqipërisë.

64 Ligji Nr. 7952, datë 21.06.1995, neni 10, pika 1, i ndryshuar.

65 ACFC, opinionin i tretë për Shqipërinë, 2011, pika 20, 161, 166.

rekomandonte fuqizimin e përpjekjeve lidhur me dhënien mundësi për t'u futur në objektet parashkollore dhe me analfabetizmit të rriturit.<sup>66</sup>

Versioni fillestar i ligjit të Bosnjës dhe Hercegovinës për pakicat kombëtare parashikonte hapjen e klasave për të mësuar në gjuhët minoritare kur shumica absolute ose relative e popullsisë së bashkisë i përkiste kësaj pakice. Me shtesat dhe ndryshimet e vitit 2005 u ul ky prag minimal në një të tretën me kalimin e të cilit lindte detyrimi për të ofruar arsimim në gjuhën minoritare dhe në një të pestën për detyrimin për të siguruar mësimë fakultative në këtë gjuhë. Ligjet për pakicat në nivel entiteti gjithashtu parashikojnë pragje kaq të larta (shumicë absolute ose relative në rastin e Republikës Serpska, një të tretën ose një të pestën në rastin e Federatës). Këto pragje janë konsideruar si tepër të larta nga ACFC, duke qenë se në praktikë asnjë shkollë nuk parashikon dhënien e mësimin në një gjuhë minoritare dhe shumë pak shkolla ofrojnë klasa optimale në gjuhë të tilla. Pikat kritike në opinionin e dytë të ACFC-së qenë jo vetëm kuadri i pabërshëm legjislativ por edhe fakti se nevojat e shprehura nga pakicat kombëtare nuk mbaheshin me kujdes në konsideratë dhe se mungonin materialet mësimore.<sup>67</sup> Në opinionin e tretë, fusha e arsimit mbulonte pjesë të mëdha të çështjeve që kishin nevojë për ndërhyrje të menjëhershme, përfshirë a) eliminimin e veçimit në arsim, nëpërmjet ndalimit të të gjitha rasteve ku “në një ndërtesë kishte dy shkolla” dhe zëvendësimit të tyre me arsim të integruar dhe b) zbatimin e një programi shkollor qendror të përbashkët për lëndë të tilla si historia, gjeografia dhe feja, që dukshëm favorizon një qasje gjithëpërfshirëse për mësimin e këtyre lëndëve.<sup>68</sup> Në të u bëhej sërish thirrje autoriteteve në të gjitha nivelet të ndjekin një qasje proaktive dhe të vlerësojnë si duhet nevojat dhe kërkesat e personave që u përkasin pakicave kombëtare në këtë fushë.<sup>69</sup> Sikurse edhe në lidhje me të drejtat për gjuhën, COMEX vëren, në raportin e parë, se neni 8 i Kartës zbatohet edhe për zonat ku personat që u përkasin pakicave kombëtare nuk i arrijnë pragjet minimale të lartpërmendura por gjithsesi përbëjnë një numër të konsiderueshëm në kuptim të angazhimit përkatës.<sup>70</sup> Gjithashtu, ai vëren se 15 nga 17 gjuhët e mbuluara nga angazhimi që lidhet me arsimin fillor nuk mësohen në këtë nivel në institucionet publike dhe duket se nuk gjendet asnjë mësues që të japë mësim këto gjuhë.<sup>71</sup> Kjo vlen edhe për 14 gjuhë në nivelin e arsimit të mesëm. Prandaj, ai i nxiste autoritetet t'i informonin nxënësit dhe prindërit “aktivisht për çfarë ofrohet dhe t'i nxisin ata për t'i shfrytëzuar këto.”<sup>72</sup>

Ligji kushtetues për mbrojtjen e pakicave kombëtare (LKPK) i Kroacisë<sup>73</sup> dhe Ligji për arsimimin në gjuhën dhe alfabetet e pakicave kombëtare garantojnë të drejtën për mësim të gjuhëve dhe shkronjave të pakicave kombëtare dhe arsim në këto gjuhë dhe shkronja. Ligji parashikon tri modele: në orët e mësimin

66 ACFC, opinionin i tretë për Shqipërinë, 2011, pika 145–154.

67 ACFC, opinionin i dytë për Bosnjën dhe Hercegovinën, 2008, pika 186–192.

68 ACFC, opinionin i tretë për Bosnjën dhe Hercegovinën, 2013, f. 2 dhe pika 119–124.

69 Po aty, pika 143–145.

70 COMEX, raporti i parë për Bosnjën dhe Hercegovinën, pika 76.

71 Po aty, 80–83.

72 Po aty, pika 86–94.

73 Neni 7, dhe sidomos neni 11.

të Modelit A, i gjithë mësimi zhvillohet në gjuhë minoritare, ndërsa kroatistja është e detyrueshme për t'u mësuar; në orët e mësimin të Modelit B, mësimi zhvillohet në të dy gjuhë, ku shkencat e natyrës mësohen në kroatisht, ndërsa programi i shkencave sociale mësohet në gjuhën e pakicës kombëtare; në orët e mësimin të Modelit C, mësimi bëhet në kroatisht, ndërsa dy deri pesë orë në javë jepen në gjuhë minoritare, përfshirë mësimin e letërsisë, gjeografisë, historisë, muzikës dhe artit të pakicës kombëtare.<sup>74</sup> Modeli B është më pak i përdoruri. COMEX konstatonte se “efektiviteti i arsimit sipas Modelit C pengohet nga fakti se zhvillohet më së shumti jashtë orarit të rregullt.”<sup>75</sup> Megjithëse në përgjithësi sistemi i mësimin të gjuhës minoritare i ngritur në Kroaci i duket i pranueshëm, ACFC i nxiste autoritetet të vlerësonin vazhdimisht kërkesën dhe nevojat faktike të pakicave. Rekomandohet të punohet më tej për formimin e mësuesve (sidomos në gjuhën rome dhe në lidhje me aftësinë për të përballuar larminë në klasë) dhe përgatitjen e materialeve mësimore në mënyrë që të pasqyrojë sa duhet larminë e shoqërisë kroate, përfshirë edhe perspektivat e shumta historike. U kërkohet autoriteteve nga të dyja organet monitoruese të mendonin nxitjen e arsimit në dy ose disa gjuhë.<sup>76</sup> Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) është shprehur me vendim se veçimi i fëmijëve romë në tri shkolla filllore kroate në klasa të veçanta në bazë të gjuhës përbën diskriminim të paligjshëm, që është në shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).<sup>77</sup> Në opinionin më të fundit, të vitit 2015, ACFC konstatonte se “shqetësim mbetet e drejta e barabartë për arsimim [në veçanti për fëmijët romë]” dhe se klasat ku ka vetëm fëmijë romë janë rritur në numër që pas vendimit të GJEDNJ-së.<sup>78</sup>

E drejta për arsimim në gjuhët minoritare është e përfshirë në Kushtetutën e Malit të Zi dhe garantohet më tej në ligjin e përgjithshëm për arsimin<sup>79</sup> dhe në ligjin për pakicat të vitit 2006.<sup>80</sup> Nga këto dispozita rrjedh që mësimi në gjuhë minoritare parashikohet në ato bashki ku pakica kombëtare përbën “shumicën ose një pjesë të konsiderueshme të popullsisë”. Sikurse edhe në rastin e të drejtave gjuhësore, ACFC ka ngritur shqetësime lidhur me sigurinë juridike të këtyre pragjeve minimale dhe ka konstatuar se kjo dispozitë zbatohet në praktikë vetëm për pakicën shqiptare.<sup>81</sup> Ai shprehte edhe shqetësimin për mundësinë e kufizuar të vijimit të arsimit në shqip në nivel të arsimit të mesëm.<sup>82</sup> Numri minimal i nxënësve që kërkohet për hapjen e një klase me mësim në gjuhë minoritare mund të jetë më i ulët se për klasat në gjuhën shtetërore por në asnjë rast nuk duhet të jetë më pak se 50% e numrit të nxënësve që kërkohet me ligj. Kur mësimi bëhet në gjuhë minoritare, gjuha zyrtare dhe alfabeti i saj është i detyrueshëm. Legjislacioni

74 Raporti i katërt shtetëror i Kroacisë në kuadër të KMPK-së, 75–76.

75 COMEX, raporti i katërt për Kroacinë, 2014, konstatimi D.

76 ACFC, opinionin i tretë për Kroacinë, 2010, pika 163–169; opinionin i katërt për Kroacinë, 2015, pika 73–76 dhe 81. Shih edhe COMEX, raporti i katërt për Kroacinë, 2014, konstatimi D.

77 GJEDNJ, “Oršuš dhe të tjerë – Kroaci, Kërkesë-padi Nr. 15766/03, Vendim (i Kolegjit të Bashkuar) datë 16 mars 2010.

78 ACFC, opinionin i katërt për Kroacinë, 2015, pika 68.

79 Neni 11, pika 2, Ligji i Përgjithshëm për Arsimin.

80 Neni 13, Ligji për të Drejtat dhe Liritë e Pakicave.

81 ACFC, opinionin i dytë për Malin e Zi, 2013, pika 170.

82 Po aty.

malazez parashikon gjithashtu që 20% e programit mund t'ua kushtohet nevojave dhe interesave të personave që u përkasin pakicave kombëtare, për shembull për kulturën, historinë dhe gjuhën e tyre. Por, shkollat rrallë e përdorin këtë mundësi.<sup>83</sup> Si ACFC, ashtu edhe COMEX, u kërkonin autoriteteve të sigurojnë që përkthimi i librave shkollorë nga gjuha malazeze në atë shqipe të jetë i një cilësie të mirë dhe, në përgjithësi, që të sigurohen të gjithë librat e nevojshëm shkollorë.<sup>84</sup> Me rëndësi për projektin e zbatuar në Tivat janë komentet e ACFC me të cilat mirëpritën nismat që synojnë mundësimin e regjistrimit të fëmijëve romë në arsimin fillor, por të cilat, në të njëjtën kohë, kërkojnë punë më të qëndrueshme për këtë qëllim.<sup>85</sup> Si çështje të pazgjidhur ende, ACFC përmendte faktin se asistentët arsimorë romë, krahas faktit që janë në numër të pamjaftueshëm, punojnë në kushte të pasigurta, duke qenë se nuk e kanë të përcaktuar statusin ligjor dhe se merren në punë me kontrata të përkohshme.<sup>86</sup> Ai konstatonte nevojën urgjente për punë të qëndrueshme në kohë lidhur me rritjen e numrit të fëmijëve romë që e vijnë arsimimin përtej nivelit të fillorës dhe i mirëpriste nismat e marra për këtë qëllim nga autoritetet malazeze.<sup>87</sup> Të gjitha këto çështje trajtoheshin nga projekti i zbatuar në Tivat. Fakti se gjuha romë nuk është e përfshirë në programin shkollor justifikohet nga autoritetet me faktin se nuk është ende e standardizuar dhe se nuk ka personel mësimor të kualifikuar. COMEX që i mendim të mendim se, edhe pse po përfundon procesi i kodifikimit, mund të përdorëshin variantet lokale të gjuhës romane të paktën në arsimin parashkollor dhe në klasat e para të arsimit fillor dhe se mund të fillohej me formimin e mësuesve.<sup>88</sup>

Në Serbi, e drejta e arsimit në gjuhët minoritare parashikohet me Kushtetutë dhe me ligje të ndryshme.<sup>89</sup> Përshtimisht, arsimi për personat që u përkasin pakicave mund të kryhet në dy gjuhë ose në gjuhën serbe. Në nivel parashkollor, kjo ndodh nëse janë dakord të paktën 50% e prindërve ose kujdestarëve ligjorë të fëmijëve<sup>90</sup>. Në arsim fillor dhe të mesëm, ligjet përkatëse parashikojnë një numër minimal prej 15 nxënësish për të ofruar arsimimin në gjuhën e pakicës ose në dy gjuhë. Ministria e Arsimit mund të tërhiqet nga kjo kërkesë pasi merr mendim nga këshilli përkatës kombëtar i një pakice kombëtare. Në klasat me gjuhë minoritare si mjet komunikimi mësimor, mësimi i serbishtes është i detyrueshëm. Kur fëmijët që u përkasin pakicave e marrin mësimin në serbisht, orët e mësimin në gjuhën dhe alfabetin e pakicës përkatëse së bashku me elemente të kulturës

---

83 ACFC, opinioni i dytë për Malin e Zi, 2013, pika 23 dhe 144. Shih edhe COMEX, raporti i tretë për Malin e Zi, 2014, pika 82.

84 ACFC, opinioni i dytë për Malin e Zi, 2013, pika 145–146, COMEX, raporti i tretë për Malin e Zi, 2014, pika 73–74.

85 Po aty, para 153, 160.

86 Po aty, para 155.

87 Po aty, pika 24–25, 150–152, 156.

88 COMEX, raporti i tretë për Malin e Zi, 2014, 53–54, 133–136.

89 Kushtetuta e Serbisë, neni 79; Ligji për Pakicat Kombëtare, neni 13–15; Ligji për Arsimin Parashkollor, Fletore Zyrtare Nr. 72/2009 dhe 18/2010, neni 5, pika 2; Ligji për Bazën e Sistemit Arsimor, Fletore Zyrtare nr. 72/2009, 52/2011 dhe 55/2013, neni 9, pika 2 (në vitin 2015 janë diskutuar disa shtesa dhe ndryshime në këtë ligj). Ligji për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare, Fletore Zyrtare Nr. 72/2009, neni 11–15.

90 50% e prindërve ose kujdestarëve ligjorë të fëmijëve, supozohet për klasë, por ligji nuk shprehet qartë për këtë.

kombëtare organizohen si lëndë me zgjedhje.<sup>91</sup> Kompetencat e gjera të këshillave kombëtare për pakicat kombëtare në fushën e arsimit parashikohen në nenet 11 deri 15 të Ligjit për Këshillat Kombëtarë për Pakicat Kombëtare, ku përfshihet edhe mundësia për të marrë pjesë në zhvillimin e arsimit minoritar. Në opinionin e tij të tretë, ACFC identifikonte si çështje që kërkojnë veprim të menjëhershëm “eliminimin e veçimit të fëmijëve romë në arsim dhe hartimin pa vonesë të masave për rritjen e efektshme të mundësive që u jepen fëmijëve romë për të marrë pjesë në arsimin normal si edhe për të përmirësuar rezultatet arsimore të fëmijëve romë”.<sup>92</sup> Më tej, ai identifikonte nevojën për të kryer anketa zyrtare për të përcaktuar numrin e nxënësve që dëshirojnë të arsimohen në gjuhë minoritare, mungesën e vullnetit politik për t’i zbatuar ligjet për arsimin fillor dhe të mesëm në nivel vendor në disa raste, “rezistencën e vazhdueshme në këtë aspekt nga disa drejtorë shkollash, organizimin e orëve fakultative mësimor në gjuhë amtare në orare të papërshtatshme dhe në vende të papërshtatshme dhe mungesën e librave shkollorë adekuatë.”<sup>93</sup> COMEX shprehej qartë në vlerësimin e tij se numri prej 15 nxënësish që kërkohet me ligj për të ofruar arsimin në gjuhë amtare ose në dy gjuhë “është tepër i lartë për të qenë në përputhje me kërkesat e Kartës” por vërente se autoritetet e shfrytëzonin sa më shumë mundësinë për tërheqjen nga kjo kërkesë. Në aspektin pozitiv, ai vërente se të gjitha gjuhët e mbuluara nga mbrojtja e Pjesës III janë të pranishme në arsimin fillor.<sup>94</sup>

Në kuadrin kushtetues maqedonas, fusha e arsimit<sup>95</sup> u përket atyre fushave për të cilat miratimi i ligjeve kërkon shumicë të dyfishtë: shumicën e votave të përfaqësuesve të pranishëm, brenda së cilës duhet të ketë një shumicë votash të përfaqësuesve të pranishëm që u përkasin komuniteteve që nuk përbëjnë shumicë të popullsisë së ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë.<sup>96</sup> Sipas Kushtetutës maqedonase, personat që u përkasin komuniteteve minoritare kanë të drejtën të marrin mësim në gjuhën e tyre në arsimin fillor dhe të mesëm. Në shkollat ku arsimi kryhet në gjuhën e një pakice, duhet të studiohet edhe maqedonishtja.<sup>97</sup> Hollësitë e kësaj të drejtëve shtjellohen në ligjin për arsimin fillor,<sup>98</sup> ligjin për arsimin e mesëm<sup>99</sup> dhe ligjin për arsimin e lartë, ku ky i fundit parashikon arsim në gjuhë minoritare vetëm për ato pakica që përbëjnë më shumë se 20% të popullsisë (praktikisht, vetëm për shqiptarët). Sipas mendimit të ACFC-së, “ekziston një sistem i zhvilluar mirë i mësimit të gjuhëve minoritare” në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, përfshirë edhe një sërë shkollash dygjuhëshe.<sup>100</sup> Gjithsesi, ai i nxiste autoritetet “të vlerësojnë nëse kuadri për mësimin e gjuhëve minoritare përkon me nevojat faktike”. Gjithashtu, u bënte thirrje autoriteteve të siguronin furnizim adekuat me tekste shkollorë në gjuhët

91 Ligji për Arsimin Fillor, neni 12; Ligji për Arsimin e Mesëm, neni 5, të dy në Fletoren Zyrtare nr.55/2013. Shih edhe komentet e Serbisë për opinionin e tretë të ACFC-së, 2014, f. 40.

92 ACFC, opinionin i tretë për Serbinë, 2013, 2.

93 Po aty, pika 27, 151–156, 159–162, 172.

94 COMEX, raporti i tretë për Serbinë, 2015, konstatimi E.

95 Pas kulturës, përdorimi i gjuhës, dokumentacioni personal dhe përdorimi i simboleve.

96 Neni 69 i Kushtetutës Maqedonase, e ashtuquajtura “shumicë Badinter”.

97 Kushtetuta e Maqedonisë, neni 48, pika 4.

98 Ligji për Arsimin Fillor i Maqedonisë, Fletorja Zyrtare e RM Nr. 103/08.

99 Ligji për Arsimin e Mesëm i Maqedonisë, Fletorja Zyrtare e RM Nr. 52/2002.

100 ACFC, opinionin i tretë për Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, 2011, pika 154–156.

minoritare.<sup>101</sup> Një çështje për veprim të menjëhershëm mbetet shpërndarja e burimeve adekuate për t'i dhënë zgjidhje situatës së romëve, mes të tjerash në lidhje me arsimin.<sup>102</sup>

Kuadri legjislativ që është miratuar pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës\* dhe marrëveshja e Brukselit ndërmjet Serbisë dhe Kosovës\*<sup>103</sup> i jep mundësi sistemit shkollor serb të mbetet përgjithësisht autonom, pra të jetë i lidhur me Ministrinë e Arsimit të Serbisë, duke i dhënë të drejtën Ministrisë së Arsimit të Kosovës\* të shprehet në lidhje me përdorimin e programeve shkollore dhe librave shkollorë. Sistemi ligjor<sup>104</sup> parashikon të drejtën e të gjithë personave që u përkasin komuniteteve të marrin arsim publik në të gjitha nivelet në njërin prej gjuhëve zyrtare që dëshirojnë, ku këto gjuhë zyrtare janë shqipja dhe serbishtja. Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës\* rregullon më tej se “shkollat të cilat japin mësim në gjuhën serbe mund të përdorin plan programe apo tekste shkollore të hartuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë”.<sup>105</sup> Gjithsesi kjo kërkon njoftimin paraprak të Ministrisë së Arsimit të Republikës së Kosovës\*, e cila mund të paraqesë kundërshtim brenda tre muajve. Në këtë rast, programi mësimor ose libri shkollor duhet t'i dërgohet një komisioni të pavarur.<sup>106</sup> Duke qenë se Ministria e Arsimit e Kosovës\* nuk ka përgatitur, as programe mësimore, as libra shkollorë, në gjuhën serbe, e vetmja mundësi për komunitetin serb është përdorimi i programeve mësimore dhe librave shkollorë të përgatitur në Serbi. Personat që u përkasin komuniteteve minoritare kanë të drejtë për arsimim parashkollor, fillor dhe të mesëm publik në gjuhën e tyre.<sup>107</sup> Në këto raste, “nxënësit do të mësojnë një gjuhë zyrtare sipas zgjedhjes së tyre”.<sup>108</sup> Pragu minimal për hapjen e klasave ose shkollave që funksionojnë në gjuhën e komuniteteve është mirë të jetë më i ulët se pragjet minimale normalisht të vendosura për institucionet arsimore ose klasat. Kur nuk ka numër të mjaftueshëm nxënësish për hapjen e një klase që të përdorë gjuhën e një komuniteti si gjuhë mësimi, “Qeveria e ka për detyrim të ofrojë alternativa, duke përfshirë transportin e subvencionuar deri në zonat ku ofrohet shkollim i tillë, shkollimin në distancë, aranzhimet e ndryshme për mësimdhënie të lëvizshme, apo edhe ofertat për qëndrim në konvikt.”<sup>109</sup> Në

101 Po aty, pika 162.

102 Po aty, Përmbledhje Ekzekutive.

103 Mbështetur në Emma Lantschner, “Protection of Minority Communities in Kosovo: Legally Ahead of European Standards – Practically Still a Long Way to Go” (Mbrotjtja e komuniteteve minoritare në Kosovë: ligjërisht më lart se standardet evropiane – praktikisht mbetet ende shumë për të bërë), 33(4) Review of Central and East European Law, 2008, f. 451–490, në f. 462–465.

104 Neni 59, pika 2, i Kushtetutës; dhe neni 8, pika 1, i Ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës (më poshtë, këtu, quajtur “Ligji për Komunitetet”).

105 Ligji për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, Nr.03/L-068, nënshkruar më 21 maj 2008, neni 12, pika 2.

106 Neni 13 i Ligjit për Arsimin. Ky komision përbëhet nga tre anëtarë të përzgjedhur nga Ministria e Arsimit, tre anëtarë që mbajnë vendet e rezervuara për komunitetin serb të Kosovës\* dhe një anëtar ndërkombëtar i përzgjedhur nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, që edhe përfaqësohet nga ky anëtar. Të gjitha vendimet merren me shumicë vote.

107 Neni 59, pika 3, i Kushtetutës së Kosovës; dhe neni 8, pika 1, i Ligjit për Komunitetet. Fëmijët e komunitetit boshnjak kanë vetëm mundësinë për të studiuar në serbisht sipas programit mësimor të Serbisë, duke qenë se Kosova\* nuk u ofron një alternativë.

108 Neni 8, pika 10, i Ligjit për Komunitetet.

109 Neni 59, pika 3, i Kushtetutës së Kosovës; Neni 8, pika 1 dhe 2, i Ligjit për Komunitetet.

opinionin e tretë për Kosovën\*, ACFC konstatonte se “thuaje nuk ka ndërveprim mes fëmijëve që frekuentojnë sisteme shkollore të ndryshme.”<sup>110</sup> Pra identifikonte si çështje për veprim të menjëhershëm “krijimin e një sistemi arsimor të integruar dhe shumëgjuhësh”. Çështje të tjera të tilla janë përmirësimi i “cilësisë së arsimit në gjuhët e komuniteteve numerikisht më të vogla”, heqja e “pengesave që mbeten për të marrë arsim për fëmijët që u përkasin komuniteteve gorane, rome, ashkali dhe egjiptiane” dhe shqyrtimi i “materialeve dhe metodikës mësimore për t’ia përshtatur një shoqërie shumetnike.”<sup>111</sup>

Për ta përmbledhur, me përjashtim të pragjeve minimale në fuqi në Bosnjë dhe Hercegovinë, Malin e Zi dhe Serbi, situata ligjore në vendet e Ballkanit Perëndimor sa i takon fushës së arsimit më së shumti i pasqyron parimet e parashikuara në KMPK dhe KEGJRM, por zbatimi në praktikë nuk ka qenë i kënaqshëm. Në shumicën e rasteve organet monitoruese u kanë bërë thirrje autoriteteve t’i marrin më seriozisht kërkesat e ngritura nga pakicat. Një problem tjetër është formimi joekzistent ose joadekuat i mësuesve në gjuhë minoritare dhe mungesa ose cilësia e ulët e materialeve mësimore. Në rastin e Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë dhe Kosovës\*, ACFC i nxiste autoritetet të mendonin shkollimin e integruar në kushte dygjuhëshe ose shumëgjuhëshe, një rekomandim i cili do të vlente edhe për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Mundësia e barabartë për arsim për fëmijët romë përbën shqetësim në shumicën e vendeve nën shqyrtim, çka kërkon përpjekje për të qëndrueshme në kohë nga autoritetet në fjalë. Projekti i zbatuar në Tivat mund të shërbente si një shembull i praktikës së mirë që mund të përhapej në të gjithë rajonin.

## Mediat minoritare

---

Neni 9 i KMPK-së parashikon lirinë për të marrë dhe përçarur informacione dhe ide në gjuhë minoritare dhe mbrojtjen e personave që u përkasin pakicave nga diskriminimi në fushën e lirisë së medias. Kështu, ky nen ndërlidhet qartë me nenin 4 dhe 7 të KMPK-së, ku ndalohet diskriminimi për shkak të përkatësisë në një pakicë kombëtare dhe parashikohet respektimi i lirisë së shprehjes, në përgjithësi. Një hallkë me nenin 6 i KMPK-së, i cili u kërkonte palëve të “nxisin një frymë tolerance dhe dialogu ndërkulturor”, ofrohet nga fakti se neni 9 u kërkon shteteve palë të miratojnë masa adekuate “për të nxitur tolerancën dhe lejuar pluralizmin kulturor.” Në monitorimin që u bën vendeve, ACFC ka vlerësuar rast pas rasti minutazhin e lejuar për transmetimin në gjuhët minoritare, duke mbajtur parasysh madhësinë dhe përqendrimin territorial të pakicave, ekzistencën e transmetimit nga mediat private në gjuhët minoritare dhe mundësinë për të parë ose dëgjuar transmetime në gjuhë minoritare nga vendet fqinje. Në bazë të KEGJRM-së, katër vendet që e kanë ratifikuar e kanë pranuar të gjitha angazhimin “për të parashikuar në mënyrë adekuate që transmetuesit [radiotelevizivë] të ofrojnë programe në gjuhë rajonale ose minoritare” në ato terriore ku fliten këto gjuhë. Ato garantojnë edhe lirinë për të parë ose dëgjuar transmetime

110 ACFC, opinionin e tretë për Kosovën\*, 2013, pika 19.

111 Po aty, f. 2, shih edhe pikat 115–117, 123–124.

televizive ose radiofonike nga vendet fqinje, si edhe përfaqësimin e interesave të përdoruesve të gjuhëve minoritare në organet që sigurojnë pluralizmin dhe lirinë e mediave. Angazhimet e tjera ndryshojnë, sipas vendit.

Ligji shqiptar për radiotelevizionin publik dhe privat u garanton personave që u përkasin pakicave kombëtare mundësinë e përdorimit të mediave elektronike në gjuhën amtare. I njëjti ligj ndalon programet që nxisin agresionin, urrejtjen kombëtare dhe racore.<sup>112</sup> Ligji për median garanton lirinë e shprehjes në përgjithësi dhe përmban të drejtën për personat që u përkasin pakicave të krijojnë mediat e tyre të shtypura ose elektronike.<sup>113</sup> Situata ligjore dhe praktike nuk ka ndryshuar ndjeshëm gjatë rrjedhës së tri cikleve monitoruese të kryera nga ACFC deri tani. Në opinionin e fundit, të vitit 2011, ai ritheksonte kërkesën që u drejtonte autoriteteve shqiptare për të mbështetur financiarisht median në gjuhët minoritare për të siguruar botimin e rregullit të këtij shtypi,<sup>114</sup> për të shqyrtuar kuadrin legjislativ në lidhje me mediat e transmetuara për të siguruar mundësi të përshtatshme për përdorim nga personat që u përkasin pakicave kombëtare dhe për t'i zgjeruar përpjekjet e radiotelevizionit publik për përfshirjen e programeve në gjuhët minoritare.<sup>115</sup>

Neni 15 dhe 16 i ligjit për të drejtat e pakicave kombëtare në Bosnjë dhe Hercegovinë hedh bazën për të drejtat e personave që u përkasin pakicave në fushën e medias. Në to parashikohet që “anëtarët e pakicave kombëtare në Bosnjë dhe Hercegovinë kanë të drejtën të hapin stacione radiotelevizive, të nxjerrin gazeta dhe buletine të tjerë informativë të shtypur në gjuhën e pakicës së cilës i përkasin.” Stacionet radiotelevizive publike kanë detyrimin të ofrojnë programe të veçanta për pakicat kombëtare, të cilat “të paktën një herë në javë” të transmetohen në gjuhët minoritare. Por ligji nuk e përcakton kohëzgjatjen minimale të programeve të tilla. Kërkohet nxjerrja e akteve nënligjore në nivel entiteti dhe kantoni për ta përcaktuar më tej këtë të drejtë në bazë të përqindjes së pakicave në popullsinë e entitetit, kantonit, qytetit ose bashkisë. Agjencia Rregullatore e Komunikacionit është shprehur se stacionet radiotelevizive publike lokale duhet të rezervojnë 10% të minutazhit javor për lajme dhe programe edukative mbi çështjet që kanë të bëjnë me personat që u përkasin pakicave kombëtare.<sup>116</sup> Por ACFC vërente se kjo rregull ka ndikuar shumë pak në praktikë dhe, në përgjithësi, “shumë pak programim u kushtohet pakicave kombëtare, qoftë në gjuhët minoritare apo ato madhore”.<sup>117</sup> Prandaj i nxiste autoritetet të kujdeseshin që të zbatoheshin detyrimet ligjore dhe të “marrin masa me vendosmëri për nxitjen e transmetimit në gjuhët minoritare”.<sup>118</sup> Edhe COMEX doli në përfundimin se gjuhët minoritare përdoren nga transmetuesit publikë deri në njëfarë shkalle vetëm (në lidhje me 11 gjuhë jo të gjitha), por për minutazh relativisht të shkurtër dhe në intervale

---

112 Ligji për Radion dhe Televizionin Publik e Privat, nr. 8410, datë 30.09.1998, Fletore Zyrtare nr. 24/1998.

113 Ligji për Shtypin, Nr. 7756, datë 11.10.1993, Fletore Zyrtare nr.13/1997.

114 ACFC, opinioni i tretë për Shqipërinë, 2011, pika 121–123.

115 Po aty, pika 124–129.

116 Rregulla 57/2011 e Agjencisë Rregullatore të Komunikacioneve.

117 ACFC, opinioni i tretë për Bosnjën dhe Hercegovinën, 2013, pika 103–104.

118 Po aty, pika 107.

të çrregullta.<sup>119</sup> Nuk ka stacione radiotelevizive private në gjuhë rajonale ose minoritare, dhe as artikuj në këto gjuhë nëpër gazeta.<sup>120</sup>

LKPK i Kroacisë u siguron pakicave “mundësinë për të përdorur shërbimet e mediave dhe të informimit publik (marrja dhe përhapja e informacionit) në gjuhën dhe alfabetin e tyre”.<sup>121</sup> Masat që mundësojnë përdorimin e mediave nga personat që u përkasin pakicave kombëtare i shërbejnë qëllimit t’i njohin të gjithë qytetarët e Kroacisë me historinë, kulturën dhe fenë e pakicave kombëtare. Transmetuesit radiotelevizivë në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor kanë detyrën të prodhojnë dhe/ose transmetojnë programe në gjuhët minoritare dhe të nxisin mirëkuptimin për anëtarët e pakicave kombëtare. Organizatat minoritare duhet të përfshihen në krijimin e programeve të synuara për pakicat. Buxheti i shtetit dhe buxhetet e njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe rajonale duhet të japin bashkëfinancim për programe të tilla në stacionet radiotelevizive në pronësi të pakicave.<sup>122</sup> Ligji për median përfshin detyrimin e vendosur mbi mediat për të nxitur tolerancën ndëretnike, duke ndaluar përhapjen e përmbajtjes që do të degradonte ose fyente për shkak të etnisë.<sup>123</sup> ACFC i nxiste autoritetet kroate të integronin interesat dhe shqetësimet e personave që u përkasin pakicave kombëtare në programimin e rregullt të stacioneve radiotelevizive publike dhe jo t’i veçonte në programe të shkurtra javore.<sup>124</sup> Por, ACFC dhe COMEX dëshirojnë që programet të fokusohen më shumë te çështjet me interes të përgjithshëm për pakicat dhe jo vetëm te kultura dhe folklori i pakicave. Në veçanti, COMEX qe skeptik lidhur me kohëzgjatjen dhe rregullsinë e duhur të transmetimit në gjuhët minoritare të ndryshme.<sup>125</sup> COMEX e kritikonte ofrimin joadekuat të programeve radiofonike publike për të gjitha gjuhët minoritare.<sup>126</sup> Gjithashtu, ACFC kërkonte rekrutimin aktiv të personave që u përkasin pakicave kombëtare në personelin e mediave publike.<sup>127</sup>

Ligji malazez për të drejtat dhe liritë e pakicave përmban në nenin 12 një dispozitë të gjerësishme për të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare në fushën e medias. Sipas kësaj dispozite, ata kanë të drejtën të krijojnë lirisht media dhe të punojnë pa pengesa në bazë të lirisë së shprehjes si edhe të mbledhin dhe përhapin lirisht informacione. Parashikohet një numër i përshtatshëm orësh transmetimi të lajmeve dhe programeve kulturore, edukative, sportive dhe argëtuese në gjuhët e pakicave, si edhe përmbajtje e programeve duhet të ketë lidhje me jetën, traditën dhe kulturën e pakicave. Gjithashtu, parashikohet që të ketë mjete financiare për financimin e përmbajtjes së programeve të tilla. Programe për jetën, kulturën dhe identitetin e pakicave “transmetohen në gjuhën zyrtare, nëpërmjet shërbimeve publike, të paktën një herë në muaj.” Ligji për

119 COMEX, raporti i parë për Bosnjën dhe Hercegovinën, 2013, pika 169–170.

120 Po aty, pika 172–185.

121 Neni 7, pika 6, i Ligjit Kushtetues për të Drejtat e Pakicave Kombëtare.

122 Neni 17 dhe 18, i Ligjit Kushtetues për të Drejtat e Pakicave Kombëtare.

123 Neni 3, pika 3, dhe 4, i Ligjit për Mediat, Fletore Zyrtare 59/2004.

124 ACFC, opinioni i katërt për Kroacinë, 2015, pika 53.

125 ACFC, opinioni i katërt për Kroacinë, 2015, pika 53; COMEX, raporti i pestë për Kroacinë, 2014, pika 101.

126 COMEX, po aty, pika 101.

127 ACFC, opinioni i katërt për Kroacinë, 2015, pika 55.

median elektronike<sup>128</sup> parashikon në nenin 55 se “përdorimi i gjuhës malazeze nuk duhet të jetë i detyrueshëm në programet e synuara për anëtarët e grupeve minoritare dhe anëtarët e komuniteteve të tjera kombëtare minoritare.” Sipas nenit 74, transmetuesit publikë: “prodhojnë dhe transmetojnë programe të synuara për të gjitha segmentet e shoqërisë, pa asnjë dallim, duke marrë sidomos në konsideratë [mes të tjerash] komunitetet etnike minoritare; [...] 5) prodhojnë dhe transmetojnë programe që shprehin identitetin kulturor të kombeve, kombësive dhe grupeve etnike; 6) prodhojnë dhe transmetojnë programe në gjuhët amtare të grupeve kombëtare dhe etnike në zonat ku banojnë.” Sipas nenit 76 buxheti vjen pjesërisht nga shteti ose nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Media e shtypur financohet më së shumti nëpërmjet Fondit për Kombet Minoritare.<sup>129</sup> ACFC i nxiste autoritetet malazeze të kujdeseshin që mbulimi territorial i programeve të prodhuara në gjuhët minoritare të arrihte të gjitha rajonet ku banojnë pakicat. Gjithashtu u kërkonte të përmirësonin përfshirjen e interesave të pakicave në mediat kryesore.<sup>130</sup> COMEX i nxiste “autoritetet maqedonase të ndjekin një qasje të strukturuar për përdorimin e gjuhës rome në mediat e transmetuara publike dhe private.”<sup>131</sup>

Në bazë të së drejtës për të ruajtur veçantinë, neni 79 i Kushtetutës serbe rendit, mes të tjerash, të drejtën e personave që u përkasin pakicave të krijojnë mjetet e tyre të komunikimit në masë. Këshillat Kombëtare për Pakicat Kombëtare kanë një numër të madh kompetencash në fushën e medias.<sup>132</sup> Për shembull, ato mund të krijojnë media të shtypur dhe transmetues radioteleviziv. Ato marrin pjesë në administrimin institucional, për shembull përmes përcaktimit të kriterëve për përzgjedhjen e kryeredaktorit të medias në të cilin programi transmetohet vetëm në gjuhën minoritare ose përmes dhënies së “një opinioni për procedurën e propozimit të kandidatëve për anëtarët e këshillit drejtues, këshillit të programimit dhe administratorit të Radiotelevizionit të Serbisë [dhe të Radiotelevizionit të Vojvodinës], nëse ky institucion transmeton program në gjuhën e një pakice kombëtare”. Kompetenca të tjera përfshijnë miratimin e një “strategjie për përmirësimin e informacionit të transmetuar në gjuhën e një pakice kombëtare” dhe dhënien e “sugjerimeve lidhur me shpërndarjen e burimeve të shpërndara nëpërmjet tenderëve publikë [në lidhje me] veprimtaritë transmetuese në gjuhën e një pakice kombëtare”. ACFC vërente një “sasi të konsiderueshme” transmetimi në gjuhët minoritare në të gjithë Serbinë. Mirëpo, mungesa e gazetarëve të formuar në gjuhët minoritare vijon të jetë problem.<sup>133</sup> Gjithashtu, COMEX vërente nivelin historikisht të lartë të pranisë së gjuhëve minoritare në median e transmetuar, duke tregues se i kishte lënë sidomos përshtypje prania e gjuhës rome.<sup>134</sup> Situata nuk konsiderohej e kënaqshme në lidhje me programet radiotelevizive në gjuhën çeke dhe gjermane. Sa i takonte hungarishtes, COMEX qe i mendimit se “mund të zbatoheshin angazhime të një

128 Ligji për Median Elektronike, Fletorja Zyrtare e Malit të Zi, nr.46/10.

129 Për më shumë hollësi, shih Raportin e Dytë Shtetëror të Malit të Zi, në kuadër të KMPK-së, f. 70–79.

130 ACFC, opinioni i dytë për Malin e Zi, 2013, pika 120–124.

131 COMEX, raporti i tretë për Malin e Zi, 2014, pika 182.

132 Nenet 21–22 e Ligjit për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare.

133 ACFC, opinioni i tretë për Serbinë, 2013, pika 130

134 COMEX, raporti i tretë për Serbinë, 2013, konstatimi H; raporti i tretë për Serbinë, 2015, konstatimi G.

niveli më të lartë”.<sup>135</sup> Lidhur me median e shtypur ACFC vërente ekzistencën e një larmie mediash të tilla në Vojvodinë, që merrnin edhe mbështetje publike, ndërsa kjo mbështetje që sporadike në pjesën tjetër të Serbisë.<sup>136</sup>

Liria e shprehjes dhe liria e shtypit garantohen nga Kushtetuta maqedonase. Sipas nenit 24 të ligjit maqedonas për transmetimet “Këshilli i Transmetimit siguron që në radhët e tij të ketë përfaqësim të drejtë të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Republikën e Maqedonisë.” Më tej ky ligj parashikon që një program televiziv publik duhet të transmetohet në maqedonisht dhe një program në shqip dhe në gjuhët e komuniteteve të tjera që nuk përbëjnë shumicë.<sup>137</sup> Në përmbushje të interesit publik, transmetuesi publik ka detyrimin të sigurojë që programet të ushqejnë identitetin kulturor të komuniteteve që jetojnë në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe të synojnë fuqizimin e “mirëkuptimit dhe tolerancës reciproke” dhe nxitjen e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve të ndryshme. Gjithashtu, ai ka detyrimin të “promovojë dhe zhvillojë të folurën dhe gjuhën standarde të të gjitha komuniteteve në Republikën e Maqedonisë”.<sup>138</sup> ACFC konstatonte se radiotelevizioni publik transmetonte gjerësisht në gjuhët minoritare por shprehte shqetësimin për faktin se media publike dhe private mbeten fuqimisht të përcara nga dasitë gjuhësore. Në funksion të rritjes së mirëkuptimit reciprok dhe dialogut ndërkulturor, siç e kërkon ligji për transmetimet, ACFC kërkonte përpjekje më të forta për zhvillimin dhe mbështetjen e nismave në këtë drejtim.<sup>139</sup>

Kushtetuta e Kosovës\* u garanton personave që u përkasin komuniteteve jo shumicë “të kenë qasje dhe përfaqësim të veçantë në mediet transmetuese publike si dhe programet në gjuhën e tyre”.<sup>140</sup> Ligji për përdorimin e gjuhëve parashikon se “Çdo person ka të drejtë të themelojë medie në gjuhën të cilën ai/ajo e zgjedh” dhe se “Komunitetet kanë të drejtë të kenë kohën për transmetim të programeve në gjuhën e tyre në Transmetues publik, në pajtim me ligjin në fuqi.”<sup>141</sup> Ky ligj në fuqi është ligji për radiotelevizionin e Kosovës, i cili parashikon se dy kanalet e RTK-së<sup>142</sup> janë të detyruara të ndajnë 15% për qind të skemës së tyre programore për gjuhët e komuniteteve tjera të Kosovës.<sup>143</sup> Përgjegjësitë parësore të RTK-së përfshijnë “kultivimin e gjuhëve zyrtare dhe të gjuhëve të komuniteteve të tjera në Kosovë.”<sup>144</sup> RTK nuk duhet të transmetojë asnjë përmbajtje që nxit diskriminim, ndërmjet të tjerash, në bazë të lidhjes me ndonjë komunitet.<sup>145</sup> Përbërja e Bordit

135 Po aty, konstatimet M-O.

136 ACFC, opinioni i tretë për Serbinë, 2013, pika 130–135.

137 Neni 117 i Ligjit Maqedonas për Transmetimet.

138 Po aty, neni 121.

139 Po aty, pika 28, 103 dhe 112.

140 Neni 59, pika 10, i Kushtetutës së Kosovës.

141 Neni 25–26 i Ligjit për Gjuhët.

142 Dy kanale televizive, njëri që transmeton në shqip dhe tjetri në serbisht, dhe dy kanale radiofonike.

143 Neni 8, pika 3, i Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, nr.04/L-046, miratuar më 29 mars 2012. Sipas raportit më të fundit të vlerësimit të të drejtave të komuniteteve i paraqitur në kuadër të KMPK-së (2015), kjo përqindje respektohet nga kanali që transmeton në serbisht, i cili filloi funksionimin në qershor 2013. Raporti i katërt i vlerësimit të të drejtave të komuniteteve, nxjerrë nga Misioni i OSBE-së në Kosovë (2015), f. 34.

144 Po aty, neni 18, pika 1.8.

145 Po aty, neni 18, pika 4.

të RTK-së duhet të pasqyrojë karakterin shumetnik dhe gjinor të Kosovës\*.<sup>146</sup> ACFC vërente ekzistencën e një kuadri legjislativ të favorshëm, por zbatim të paplotë. Bashkësitë e vogla raportojnë se përdorimi i medias së shtypur dhe të transmetuar në gjuhët e tyre mbetet shumë i vështirë. Bashkësitë minoritare nuk mendojnë se pasqyrohen sa duhet në median kryesore. ACFC i nxit autoritetet t'i kushtojnë më shumë vëmendje kontributit që japin mediat dygjuhëshe dhe shumëgjuhëshe në nxitjen e mirëkuptimit dhe tolerancës ndëretnike.<sup>147</sup> Raporti i mëpasshëm i paraqitur nga OSBE konfirmon se vijojnë paragjykimet etnike në raportimet në media dhe se është bërë progres i pamjaftueshëm në ngritjen e mediave dygjuhëshe.<sup>148</sup>

Pikat e kritikuara nga organet monitoruese kishin të bënin me çështjen e financimit dhe shpërndarjes me drejtësi të fondeve, sidomos për median e shtypur,<sup>149</sup> integritimin e interesave dhe shqetësimeve të pakicave në programimin e përgjithshëm dhe rekrutimin e më shumë përfaqësuesve të pakicave,<sup>150</sup> nevojën për rishikimin e kuadrit legjislativ për median e transmetuar për të siguruar mbulim të përshtatshëm për secilën pakicë dhe shpërndarje të minutazhit të mjaftueshëm të transmetimit,<sup>151</sup> si edhe mbështetjen për nismat që kërkojnë rritjen e mirëkuptimit reciprok dhe dialogut ndërkulturor.<sup>152</sup>

## Pjesëmarrje e efektshme në jetën publike

---

Në vijim, do të trajtohet pjesëmarrja politike në formën e përfaqësimit të personave që u përkasin pakicave kombëtare në organet e zgjedhura në nivel vendor, rajonal ose qendror, dhe në formën e konsultimeve ndërmjet pushtetit dhe pakicave. Më tej, prezantohen dispozitat përkatëse për përfshirjen e personave që u përkasin pakicave kombëtare në administratën publike, gjyqësor ose polici. Ndërkohë që të gjitha këto çështje mbulohen nga neni 15 i KMPK-së, KEGJRM nuk përmban një dispozitë të veçantë për to në Pjesën III të saj. Gjithashtu, mundësia fakultative sipas së cilës palët angazhohen të rekrutojnë dhe trajnojnë zyrtarë me qëllim vënie në jetë të angazhimeve të përzgjedhura sipas pikave 1 deri 3 të nenit 10 jo medoemos nënkupton se për këtë qëllim duhet të merren në punë persona që i përkasin pakicave gjuhësore. Gjithsesi, krijimi i organeve këshillimore është një masë që zbatohet “nëse është e nevojshme” sipas nenit 7 të Pjesës III të KEGJRM-së. Kjo pjesë, pra, fokusohet më shumë te përputhshmëria e legjislacionit të brendshëm me kërkesat KMPK-së.

---

146 Po aty, neni 25, pika 6.

147 ACFC, opinioni i tretë për Kosovën\*, 2013, pika 96–97.

148 Raporti i katërt i vlerësimit të të drejtave të komuniteteve, nxjerrë nga Misioni i OSBE-së në Kosovë (2015), f. 34.

149 Për shembull, në lidhje me Shqipërinë, Kroacinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, dhe Kosovën\*.

150 Shih, për shembull, në lidhje me Kroacinë, Malin e Zi dhe Serbinë.

151 Shih, për shembull, në lidhje me Shqipërinë dhe Kosovën\*.

152 Shih, për shembull, në lidhje me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

## *Përfaqësimi në organet e zgjedhura*

Kushtetutat dhe aktet e tjera ligjore të shumicës së vendeve përfituese parashikojnë mjete të ndryshme nëpërmjet të cilave mund të garantohet ose, të paktën, të ndihmohet përfaqësimi i pakicave kombëtare në organet e zgjedhura. Vetëm sistemet e Shqipërisë dhe të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë nuk parashikojnë mekanizma të posaçme. Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, komuniteti minoritar shqiptar është aq i madh sa për të arritur lehtësisht përfaqësim edhe pa masa të posaçme, ndërkohë që edhe pakicat e tjera kanë fituar vende si në zgjedhjet kombëtare (zakonisht jo si lista të veçanta) dhe në nivel vendor.<sup>153</sup> Në Shqipëri, vetëm disa deputetë në Kuvend përfaqësojnë pakicat kombëtare. Në nivel vendor, një sërë personash që i përkasin pakicës greke ose asaj maqedonase janë zgjedhur në zonat ku banojnë në numër të konsiderueshëm. Pakicat e vogla, sidomos romët dhe egjiptianët, janë në kushte sidomos të pafavorshme në këtë aspekt.<sup>154</sup> Pra, është interesante të vërehet që projekti i zbatuar në Shqipëri, i analizuar me hollësi më poshtë në këtë dokument ka sjellë si rezultat përfaqësimin e një personi që i përket komunitetit egjiptian në këshillin bashkiak të Përmetit.

Përfaqësimi i garantuar në parlament parashikohet në Kroaci<sup>155</sup> dhe në Kosovë\*.<sup>156</sup> Pakicat kombëtare në Kroaci zgjedhin në një njësi të posaçme zgjedhore 8 deputetë. Anëtarët e pakicave kombëtare që përbëjnë më shumë se 1,5% të numrit të popullsisë gjithsej (domethënë, serbët) kanë të garantuar 3 vende në parlament, ndërsa anëtarët e pakicave kombëtare që përbëjnë më pak se 1,5% të numrit të popullsisë gjithsej kanë të drejtën të zgjedhin 5 përfaqësues të pakicave të marra së bashku. Futja e të drejtës së dyfishtë të votimit për pakicat kombëtare në vitin 2010 është anuluar me vendim të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2011, kështu që anëtarët e pakicave kombëtare mund të votojnë, ose për kandidatët e pakicave kombëtare, ose për listat e përgjithshme partiake në zonën zgjedhore të tyre.<sup>157</sup> Në Kosovë\*, nga 120 vende, minimumi 20 vende u garantohen përfaqësuesve të komuniteteve minoritare. Dhjetë prej këtyre vendeve i rezervohen komunitetit serb, ky komunitet mund të ketë më shumë se 10 vende nëse arrin të fitojë më shumë përmes zgjedhjeve të hapura. Komuniteteve të tjera minoritare u garantohet një numër i caktuar minimal vendesh me Kushtetutë.<sup>158</sup> Pavarësisht nga fakti që komunitetet kroate dhe malazeze në Kosovë\* janë njohur zyrtarisht si pakica në vitin 2011, dhe pavarësisht që Komiteti i Ministrave e konsideronte si çështje për

153 ACFC, opinion i tretë për Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, 2011, pika 167.

154 ACFC, opinion i tretë për Shqipërinë, 2011, pika 174–175.

155 Neni 19 i Ligjit Kushtetues për të Drejtat e Pakicave Kombëtare dhe neni 16 i Ligjit për Zgjedhjen e Përfaqësuesve në Parlamentin Kombëtar.

156 Neni 64, pika 2, i Kushtetutës së Kosovës.

157 Për arsyet, shih Vendimin U-I-3597–2010-CC, pika 61.

158 Ky minimum për komunitetin boshnjak është tri vende, për komunitetin turk dy vende dhe për komunitetet gorane, rome, ashkali dhe egjiptiane nga një vend secili. Një vend tjetër i jepet komunitetit rom, ashkali ose egjiptian, në varësi të faktit se cili komunitet ka fituar numrin më të madh të votave gjithsej. Për më shumë hollësi, shih Emma Lantschner, "Protection of Minority Communities in Kosovo: Legally Ahead of European Standards – Practically Still a Long Way to Go" (Mbrotjtja e komuniteteve minoritare në Kosovë: ligjërisht më lart se standardet evropiane – praktikisht mbetet ende shumë për të bërë), 33(4) Review of Central and East European Law, 2008, f. 451–490, në f. 474 ff.

veprim të menjëhershëm për t'u dhënë këtyre pakicave vende të rezervuara, ende nuk janë bërë ndryshimet e nevojshme në Kushtetutë për këtë qëllim.<sup>159</sup>

Në Bosnjë dhe Hercegovinë, fokusi kushtetues nuk është te pakicat, por te tre popujt themelues. Shtëpia e Popullit (si edhe Presidenca) përbëhet nga një numër i barabartë përfaqësuesish të tre popujve themelues. Vendimi "Sejdić dhe Finci" i GJEDNJ-së<sup>160</sup> kërkonte ndryshimin e Kushtetutës për të eliminuar këtë diskriminim të personave që nuk deklarojnë se i përkasin njërit prej këtyre tri grupeve, por ende nuk janë bërë këto ndryshime.<sup>161</sup>

Përfaqësimi i garantuar në nivel vendor dhe rajonal parashikohet me sistemin kushtetues dhe ligjor të Kroacisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës. Neni 20 i LKPK-së në Kroaci mbulon rastet kur asnjë anëtar i një pakice kombëtare të caktuar nuk është zgjedhur në një organ përfaqësues të vetëqeverisjes vendore në bazë të drejtave të përgjithshme të votimit dhe kjo pakicë përbën 5 deri 15% të popullsisë së njësisë vendore të vetëqeverisjes. Në këtë rast, organit përfaqësues i shtohet një anëtar dhe anëtari i parë i një pakice kombëtare jo i zgjedhur do të konsiderohet si i zgjedhur. Në njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku pakica përbën më shumë se 15% të popullsisë, dhe në njësitë e vetëqeverisjes rajonale, ku pakica përbën më shumë se 5% të popullsisë, kjo pakicë ka të drejtën e përfaqësimit proporcional në organin e zgjedhur vetëqeverisës. Nëse rezultatet e zgjedhjeve të rregullta nuk e kanë sjellë këtë nivel përfaqësimi për një pakicë të tillë, numri i anëtarëve të këtij organi përfaqësues do të rritet aq sa duhet për të arritur përfaqësimin proporcional.

Në rastin e Bosnjës dhe Hercegovinës, shtesat dhe ndryshimet e bëra në ligjin zgjedhor në vitin 2004 parashikonin një vend të rezervuar në një këshill bashkiak për pakicat që janë më të vogla se 3% dhe një deri në dy vende nëse përbëjnë më shumë se 3%. Gjithsesi, një ndryshim tjetër i vitit 2008 parashikon përfaqësim proporcional (me të paktën një vend) nëse popullsia minoritare është mbi 3%, nëse këshilli bashkiak nuk vendos që vullnetarisht të rezervojë një vend edhe kur nuk arrihet ky prag minimal. ACFC shprehu shqetësim që mundësitë për përfaqësim për pakicat janë ulur në këtë mënyrë, duke qenë se shumë pak bashki e përmbushin këtë kërkesë. Krahas kësaj, ACFC që skeptik për përdorimin vetëm të informacionit të censit të vitit 1991, për shkak të ndryshimeve demografike që kanë ndodhur gjatë dy dekadave të fundit, dhe kërkonte rillogaritjen e numrit të vendeve të rezervuara me t'u bërë zyrtare rezultatet e censit të vitit 2013. Nga ana tjetër, ai e mirëpriste lajmin për dy vendet e rezervuara për pakicat në Asamblenë e Qarkut të Bërçkos.<sup>162</sup>

159 Rezoluta e Tretë e Komitetit të Ministrave për zbatimin e KMPK-së në Kosovë\*, 2014; Raporti i katërt i vlerësimit të të drejtave të komuniteteve, nxjerrë nga Misioni i OSBE-së në Kosovë (2015), f. 20.

160 GJEDNJ, "Sejdić and Finci – Bosnjë dhe Hercegovinë", Kërkesë-padi nr. 15766/03, vendim i datës 22 dhjetor 2009.

161 Shih për këtë, Raport-Progressin e KE-së, 2015, f. 4, 7, 21, 24.

162 ACFC, opinioni i dytë për Bosnjën dhe Hercegovinën, 2008, pika 193–197; ACFC, opinioni i tretë për Bosnjën dhe Hercegovinën, 2013, pika 148–150.

Përfaqësimi i garantuar, si në nivel qendror, ashtu edhe në nivel vendor, parashikohej edhe nga legjislacioni malazez, por u shfuqizua nga Gjykata Kushtetuese në vitin 2006 me arsyetimin se përfaqësimi i garantuar nuk mbulohej nga kushtetuta në fuqi asokohe.<sup>163</sup> Ligji i vitit 2012 për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve, mbështetur në nenin 79, pika 9, të Kushtetutës së vitit 2007, i cili tani parashikon “përfaqësim autentik” në Parlament “në përputhje me parimin e diskriminimit pozitiv”, parashikon atë që mund të përshkruhet si përfaqësim i garantuar me kusht. Nëse asnjë listë minoritare nuk arrin pragun minimal prej 3%, por veçmas fiton të paktën 0,7% të votave të vlefshme, listat e partive minoritare fitojnë të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e vendeve në grup. Numri progresiv i votave të vlefshme të marra përbën bazën për shpërndarjen deri në tri vende. Kjo vlen vetëm për ato pakica që përbëjnë jo më shumë se 15% të popullsisë së zonës zgjedhore përkatëse.<sup>164</sup> Një rregull edhe më i favorshëm është futur në zbatim për pakicën kroate, e cila, me 0,9% të popullsisë sipas censit të vitit 2011, përbën pakicën më të vogël. Por ACFC vërente një dallim të panevojshëm midis pakicës kroate dhe asaj rome, që përbën 1% të popullsisë, dhe arrinte në përfundimin se kjo mund të përbente diskriminim që bie ndesh me nenin 4 dhe 15 të KMPK-së.<sup>165</sup>

Një strategji për mundësimin e përfaqësimit të pakicave, e zbatuar nga Serbia, është përmes përjashtimit të listave të partive minoritare nga kërkesat për pragun minimal. Neni 100 i Kushtetutës thotë se pakicat duhet të përfaqësohen në Parlament në përputhje me ligjin. Prej vitit 2004, ligji për zgjedhjen e përfaqësuesve parashikon se partitë e pakicave kombëtare përjashtohen nga pragu përgjithësisht i zbatueshëm prej 5%. Kështu, partitë e pakicave përfaqësohen me të arritur numrin e nevojshëm të votave të nevojshme për të paktën një vend (nga 250 vende gjithsej) në parlament.<sup>166</sup> Për krahinat autonome dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore me popullsi etnikisht të përzier, Kushtetuta serbe parashikon që të parashikohet përfaqësim proporcional i pakicave kombëtare në asamble, në përputhje me ligjin.<sup>167</sup> ACFC i mirëpriste këto dispozita, por i nxiste autoritetet të mendonin shqyrtimin e tyre nën dritën e abuzimeve që, sipas raportimeve, i bënin persona që nuk u përkisnin ose nuk përfaqësonin pakicat, dhe me qëllim nxitjen e një pjesëmarrjeje më të efektshme të pakicave numerikisht më të vogla në nivel kombëtar.<sup>168</sup>

Mund të arrihet në përfundimin se sistemet ligjore të vendeve të Ballkanit Perëndimor parashikojnë një larmi mënyrash për të mundësuar përfaqësimin e

163 Vendimin i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Malit të Zi, nr. 53/06, datë 11 korrik 2006.

164 Ligji për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve. Lehtësime të tjera përfshijnë kërkesën për një numër më të vogël kandidatësh në listat minoritare, si edhe një numër më të vogël nënshkrimesh të nevojshme për paraqitjen e një liste. Për më shumë hollësi, shih Raportin e Dytë Shtetëror të Malit të Zi, në kuadër të KMPK-së, 2012, f. 89–90.

165 ACFC, opinioni i dytë për Malin e Zi, 2013, pika 175–180.

166 Neni 81, pika 2 dhe 3, i Ligjit për Zgjedhjen e Përfaqësuesve, nr.10/2003, i ndryshuar më 25 shkurt 2004, 12/2004.

167 Neni 180, pika 4, i Kushtetutës së Serbisë, neni 35 i Statutit të Provincës Autonome të Vojvodinës, neni 40 i Ligjit për Zgjedhjet Vendore.

168 ACFC, opinioni i tretë për Serbinë, 2013, pika 177–180.

pakicave në organet e zgjedhura. Në përgjithësi, kjo është mirëpritur nga ACFC, por Komiteti ka qenë kritik kundrejt uljes së standardit që ekzistonte më parë dhe shpreh shqetësim lidhur me përfaqësimin e pakicave numerikisht më të vogla. Sidomos në rastin e Bosnjës dhe Hercegovinës, është i shqetësuar për përjashtimin në përgjithësi të pakicave nga mundësia për t'u zgjedhur në disa poste.

### *Organet konsultative*

Sidomos për pakicat më të vogla, të cilat nuk mund të arrijnë përfaqësimin në organet e zgjedhura, ekzistenca e organeve konsultative mund të jetë jetike. Në të gjitha vendet përfituese ekzistojnë organe këshillimore të një lloji ose një tjetër. Për shembull, në Serbi, Këshillat Kombëtarë për Pakicat Kombëtare<sup>169</sup> kanë kompetencë në fushat e kulturës, arsimit, informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe alfabetit. Këshillat mund të ndikojnë në vendimet për personelin dhe drejtuesit e institucioneve që tërësisht ose pjesërisht i shërbejnë përmbushjes së të drejtave të pakicave në shkolla, media dhe institucionet kulturore. Ligji rregullon me hollësi procedurën e zgjedhjes në këshilla, financimin e tyre dhe marrëdhëniet me autoritetet shtetërore.<sup>170</sup> ACFC vëren se këta këshilla janë kthyer, në fakt, në kanal in kryesor të pjesëmarrjes për pakicat kombëtare në Serbi, por shpreh shqetësimin për faktin se këshillat punojnë të veçuar dhe bashkëpunimi mes tyre është shumë i kufizuar. Ai vëren gjithashtu, nga njëra anë, "kompetencat në një gamë shumë të gjerë", por, nga ana tjetër, edhe konfliktin me dispozitat e ligjeve të tjera në fushat e arsimit dhe kulturës, çka sjell probleme të rënda për zbatimin në praktikë të ligjit. Një pikë tjetër shqetësuese qenë "dallimet e konsiderueshme në shumatat e financimit", në varësi të faktit nëse një këshill ndodhet në Vojvodinë (ku mund të marrë mbështetje nga krahina) ose diku gjetkë në Serbi.<sup>171</sup> Krahas kësaj, Gjykata Kushtetuese kanë konstatuar kohët e fundit se disa nga dispozitat e ligjit nuk janë kushtetuese, kështu që pritet bërja e shtesa dhe ndryshimeve në ligj.<sup>172</sup>

Në Kosovë\*, Këshilli Konsultativ për Komunitete<sup>173</sup> vepron nën autoritetin e Presidentit, ndërsa në Kuvend është krijuar Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Organe të tjera këshillimore ekzistojnë në Kryeministri dhe në ministri të ndryshme. Megjithatë, është për t'u lëvdur që Kosova\* u kushton shumë vëmendje çështjeve të lidhura me pakicat, gjithsesi ekziston një "rrezik copëzimi

169 Ligji për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare, Fletore Zyrtare e Republikës së Serbisë Nr. 72/2009. Baza kushtetuese në nenin 75, pika 3.

170 Për hollësitë shih Tamás Korhecz, "National Minority Councils in Serbia" (Këshillat e pakicave kombëtare në Serbi", në Tove H. Malloy e të tjerë (red.), *Managing Diversity through Non-Territorial Autonomy. Assessing Advantages, Deficiencies, and Risks* (Menaxhimi i diversitetit nëpërmjet autonomisë joterritoriale. Analizë e avantazheve, mangësive dhe risqeve), Oxford University Press (2015), f. 69–91.

171 ACFC, opinioni i tretë për Serbinë, 2013, pika 190 dhe 194–196.

172 Shih Tamás Korhecz, "National Minority Councils in Serbia" (Këshillat e pakicave kombëtare në Serbi", në Tove H. Malloy e të tjerë (red.), *Managing Diversity through Non-Territorial Autonomy. Assessing Advantages, Deficiencies, and Risks* (Menaxhimi i diversitetit nëpërmjet autonomisë joterritoriale. Analizë e avantazheve, mangësive dhe risqeve), Oxford University Press (2015), f. 69–91, në f. 90.

173 Neni 60 i Kushtetutës, neni 12 i Ligjit për Komunitetet (i cili është ndryshuar në vitin 2011 për të përfshirë edhe komunitetet malazeze dhe kroate në Këshill), Statuti për themelimin e Këshillit Konsultativ për Komunitete në Kosovë\*, datë 15 shtator 2008, ndryshuar në 2012.

të tepruar të kompetencave në këtë fushë që mund ta dobësojë mbrojtjen e pakicave<sup>174</sup>. Në opinionin më të fundit, ACFC vërente se një mungesë e përgjithshme e bashkërendimit qendror e ulte efektivitetin e konsultimeve.<sup>175</sup> Në raportin e katërt në kuadër të KMPK-së, OSBE raportonte se mungonin ende konsultimet sistematike dhe se roli i Këshillit Konsultativ për Komunitetet mbetej i kufizuar.<sup>176</sup>

Këshilla Kombëtare për Pakicat Kombëtare ekzistojnë edhe në Kroaci,<sup>177</sup> Mal të Zi<sup>178</sup> dhe Bosnjë dhe Hercegovinë.<sup>179</sup> Këshilli kroat për Pakicat Kombëtare përbëhet nga 20 anëtarë të emëruar nga qeveria, 8 syresh janë deputetë minoritarë, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga përfaqësues të shoqatave minoritare “disi të dalluara”.<sup>180</sup> ACFC shprehte kritika për mungesën e kompetencave më të gjera dhe se për shkak të mungesës së ndikimit mbi vendimmarrjen, personat që u përkasin pakicave kombëtare kërkojnë kanale të tjera për të marrë pjesë në vendimmarrje.<sup>181</sup> Sa i takon Malit të Zi, ACFC ka marrë raportime se diskutimet në Këshillat e Pakicave ndikoheshin nga shqetësimet partiake të disa prej anëtarëve. Ai shprehte shqetësim që ligji nuk parashikonte një drejtpeshim gjinor në përbërjen e Këshillave. Statusi ligjor i pacaktuar qartë dhe fakti se Këshillat perceptohen më shumë si OJQ pa kompetenca vendimmarrëse janë të tjera sfida serioze me të cilat përballen këta këshilla. Prandaj ACFC i nxiste autoritetet t’i shqyrtonin dispozitat ligjore përkatëse.<sup>182</sup> Lidhur me Këshillat e Pakicave Kombëtare në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Federatë, ACFC shprehte shqetësim lidhur me raportimet mbi emërimet e politizuara dhe mbi mungesën përkatëse të besimit të anëtarët, në rastin e parë, dhe problemet e lidhura me madhësinë e organizmit, në rastin e dytë. Prandaj, ai rekomandonte fuqimisht shqyrtimin e dispozitave lidhur me anëtarësinë në të dy organizmat. Ai gjithashtu i nxiste autoritetet të ndiqnin propozimet e bëra nga Këshillat dhe të justifikonin vendimet e pazbatuara.<sup>183</sup>

Komisioni parlamentar maqedonas për marrëdhëniet ndërkomunitare<sup>184</sup> përbëhet nga 19 anëtarë deputetë, të zgjedhur nga Parlamenti: nga shtatë anëtarë janë nga komuniteti maqedonas dhe ai shqiptar, dhe nga një anëtar nga komunitetet turke, vllahë, rome, serbe dhe boshnjake. Në detyrat e Komisionit përfshihen shqyrtimi

174 ACFC, opinionin i dytë për Kosovën\*, 2009, pika 236.

175 ACFC, opinionin i tretë për Kosovën\*, 2013, 143.

176 Raporti i katërt i vlerësimit të të drejtave të komuniteteve, nxjerrë nga Misioni i OSBE-së në Kosovë (2015), f.21 dhe 23.

177 Neni 35 dhe 36, i Ligjit Kushtetues për të Drejtat e Pakicave Kombëtare. Për hollësi, shih Antonija Petričušić, “Non-Territorial Autonomy in Croatia” (Autonomia joterritoriale në Kroaci), në Tove H. Malloy e të tjerë (red.), *Managing Diversity through Non-Territorial Autonomy. Assessing Advantages, Deficiencies, and Risks* (Menaxhimi i diversitetit nëpërmjet autonomisë joterritoriale. Analizë e avantazheve, mangësive dhe risqeve), Oxford University Press (2015), f. 53–68.

178 Nenet 33–35 e Ligjit për Pakicat, i vitit 2006.

179 Këshilli i Pakicave Kombëtare i krijuar pranë Asamblesë Parlamentare të Bosnjës dhe Hercegovinës, nenet 21 dhe 22 i Ligjit Kushtetues për të Drejtat e Pakicave Kombëtare.

180 Neni 36 i LKPK-së.

181 ACFC, opinionin i katërt për Kroacinë, 2015, pika 82, 85.

182 ACFC, opinionin i dytë për Malin e Zi, pika 191–195.

183 ACFC, opinionin i tretë për Bosnjën dhe Hercegovinën, 2013, pika 159, 161–162.

184 Krijuar në bazë të Amendamentit XII të Kushtetutës, i cili i referohet nenit 78.

i çështjeve të marrëdhënieve ndërkomunitare dhe bërja e vlerësimeve dhe sugjerimeve për zgjidhjen e tyre. Parlamenti maqedonas ka detyrimin t'i marrë në konsideratë mendimet e këtij Komisioni.<sup>185</sup> Komiteti Shtetëror i Minoriteteve i Shqipërisë<sup>186</sup> "nga njëra anë, është një organ shtetëror që përgjigjet drejtpërdrejt te Kryeministri, nga ana tjetër, anëtarësia në të, e përbërë nga persona që u përkasin pakicave kombëtare, e bën të jetë një organ thujse përfaqësues që në dukej flet në emër të disa pakicave kombëtare."<sup>187</sup> Në këtë kuadër, ACFC e kritikonte faktin që jo të gjitha grupet minoritare janë të përfaqësuara në këtë Komitet, që "përbërja në të është arbitrare" dhe që atij i mungon pavarësia nëse kemi parasysh që anëtarët zgjidhen nga autoritetet pa u konsultuar me grupet minoritare të interesuara. Si i tillë, ai nuk mund të konsiderohet si një "organ vërtet përfaqësues".<sup>188</sup> Grupi i punës për reformimin e legjislacionit shqiptar për pakicat kombëtare ka sugjeruar, mes të tjerash, rritjen e përfaqësimit dhe të rolit konsultativ të këtij Komiteti.<sup>189</sup>

Këshilla të pakicave kombëtare apo të marrëdhënieve ndëretnike në nivel vendor dhe rajonal ekzistojnë në Bosnjë dhe Hercegovinë (Këshillat e Pakicave Kombëtare në nivel entiteti dhe pjesërisht edhe në nivel kantoni),<sup>190</sup> Kroaci<sup>191</sup> dhe Serbi<sup>192</sup>. Pjesëmarrja në zgjedhjet për organet konsultative në Kroaci, të cilat kanë detyrën të këshillojnë autoritetet vendore dhe rajonale për çështjet e pakicave, është shumë e ulët. Arsyet për këtë mund të gjenden në numrin shumë të vogël të kompetencave, buxhetin e vogël që shpesh jepet me vonesë duke e bërë të vështirë kështu realizimin e projekteve të kuptimita dhe në organizimin e zgjedhjeve veçmas nga zgjedhjet e përgjithshme vendore. ACFC nxiste edhe miratimin e një kuadri ligjor të përshtatshëm për zgjedhjen e këtyre organeve.<sup>193</sup> Këshillat serbë për marrëdhëniet ndëretnike kanë kompetencën për të diskutuar për çështje që kanë të bëjnë me realizimin, mbrojtjen dhe nxitjen e barazisë në komunitetet vendore dhe mund të çelin proces përpara Gjykatës Kushtetuese nëse mendojnë se aktet nënligjore bashkiake shkelin drejtpërdrejt të drejtat e komuniteteve kombëtare dhe etnike. Por ACFC konstatonte se janë krijuar shumë pak këshilla të tillë dhe se shumica e tyre nuk janë plotësisht funksionale. Prandaj i nxiste autoritetet të promovonin krijimin dhe funksionimin e efektshëm të tyre.<sup>194</sup>

Legjislacioni maqedonas parashikon që në bashkitë me të paktën 20% popullsi minoritare të ngrihen komisione për marrëdhëniet me komunitetet.

185 Ligji për Komitetin për Marrëdhënie Ndërkomunitare, Fletore Zyrtare e RM, nr.150/ 2007.

186 Vendim i Këshillit të Ministrave, nr.127, datë 11 mars 2004, për krijimin e Komitetit Shtetëror të Pakicave, i ndryshuar.

187 ACFC, opinioni i tretë për Shqipërinë, 2011, pika 169.

188 Po aty, pika 169–171.

189 Komisioni Evropian, Raporti 2015 për Shqipërinë, 60.

190 Nenet 21–23 i Ligjit (shtetëror) për të Drejtat e Pakicave Kombëtare, Ligji për mbrojtjen e personave që u përkasin pakicave kombëtare në Republikën Srpska, Ligji për mbrojtjen e personave që u përkasin pakicave kombëtare në Federatë. Shih komentet e ACFC-së të përmbledhura më lart në poshtëshënimin 184.

191 Neni 23 dhe 34 i Ligjit Kushtetues për të Drejtat e Pakicave Kombëtare.

192 Neni 98 i Ligjit të Vetëqeverisjes Vendore, Fletorja Zyrtare e Republikës së Serbisë, nr.129/07.

193 ACFC, opinioni i katërt për Kroacinë, 2015, pika 84 dhe 87.

194 ACFC, opinioni i tretë për Serbinë, 2013, pika 197 dhe 202.

Këto komisione kanë mandatin të shqyrtojnë probleme që kanë të bëjnë me marrëdhëniet midis komuniteteve që jetojnë në bashki dhe të japin opinione dhe propozime për zgjidhjen e këtyre problemeve. Sipas raportit më të fundit për situatën në bazë të KMPK-së (por që, në fakt, është paraqitur në korrik 2014) këto komisione nuk janë ende plotësisht funksionale.<sup>195</sup>

Në opinionin e fundit për Kosovën\*, ACFC u bënte thirrje autoriteteve të "ngrenë mekanizma të efektshëm dhe të institucionalizuar konsultimi në nivel vendor për të siguruar që mendimet dhe shqetësimet e komuniteteve të diskutohen rregullisht dhe të marren sa duhet në konsideratë."<sup>196</sup> Edhe pse raporti i OSBE-së për zbatimin e KMPK-së në Kosovë\* nuk mund të raportonte përmirësime të konsiderueshme në këtë aspekt, është interesante të thuhet se projekti i zbatuar në Vushtrri ka ndjekur një qasje me pjesëmarrje në hartimin e një dokumenti strategjik për integrimin e komuniteteve jo shumicë.

Legjislacioni shqiptar nuk parashikon organe konsultative në nivel vendor. Projekti i zbatuar në Përmet, që përfshinte, ndër aktivitetet e tjera, krijimin e një komisioni civil për pakicat, si një organ këshillimor për t'u marrë me shqetësimet e personave që u përkasin pakicave kombëtare, është pra një praktikë e mirë sa i takon rritjes së pjesëmarrjes së pakicave në vendimmarrjen në nivel vendor.

Në përgjithësi ACFC e ka mirëpritur krijimin e organeve konsultative. Më së shumti, ai ka shprehur kritika kur përbërja e këshillave nuk ka qenë përfaqësuese për pakicat që jetojnë në një vend të caktuar ose kur pakicat nuk angazhohen sa duhet në emërimin e anëtarëve duke qenë se kjo mund të shkaktojë mungesë të pavarësisë nga qeveria. Problemet e tjera kanë pasur të bëjnë me financimin e këshillave apo me bashkërendimin mes organeve të ndryshme përgjegjëse për çështjet e lidhura me pakicat. Një çështje e përgjithshme që përbën shqetësim ka qenë edhe fakti se për shkak të ndikimit të kufizuar në vendimmarrjen e këtyre organeve, personat që u përkasin pakicave kombëtare shpesh përdorin kanalet joformale për t'u dhënë zgjidhje shqetësimeve të tyre, dhe jo mekanizmat institucionale të organit këshillimor.

### *Pjesëmarrja në administratën publike*

Shqipëria është e vetmja nga vendet përfituese e cila nuk ka dispozita që nxisin rritjen e numrit të përfaqësuesve të pakicave të punësuar në sektorin publik. Sistemi ligjor shqiptar parashikon vetëm mosdiskriminimin për shkak të kombësisë në marrëdhëniet e punës. Duke qenë se nuk ka të dhëna për numrin e personave që u përkasin pakicave kombëtare të punësuar në administratën publike, është e pamundur të krijohet një pamje e qartë për situatën. Punësimi i dy personave me prejardhje egjiptiane, si rezultat i projektit të zbatuar në Përmet, është për t'u mirëpritur, por duke qenë se në përgjithësi nuk ekziston asnjë detyrim ligjor në këtë drejtim, aktivitete të tilla do të mbeten në dorë të vullnetit të mirë të pushtetit vendor.

<sup>195</sup> Raporti i katërt i ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë në kuadër të KMPK-së, 2014, 32.

<sup>196</sup> ACFC, opinionin i tretë për Kosovën\*, 2013, pika 145.

Të gjitha vendet e tjera përfituese kanë dispozita të veçanta kushtetuese ose dispozita të tjera në këtë fushë. Në Kroaci, pakicat kanë të drejtë për përfaqësim proporcional në administratën publike.<sup>197</sup> Megjithëse përfaqësimi që synohet të arrihet në bazë të Planit për Rekrutimin e Anëtarëve të Pakicave Kombëtare në Organet e Administratës Shtetërore 2011–2014 që 5,5%, deri në fund të vitit 2014 që e mundur të arrihej vetëm rreth 3,6%. Paragjykimet etnike dhe problemet gjatë procesi të marrjes në punë mbeten problem, si edhe fakti se shumë pak nëpunës civilë nga një komunitet minoritar mbajnë poste të larta.<sup>198</sup> Legjislacioni maqedonas përcakton “përfaqësim me drejtësi” për të gjitha pakicat, edhe për ato që janë më pak se 20%.<sup>199</sup> ACFC shprehte shqetësim sidomos për përfaqësimin ndjeshëm në nivel të pakicave numerikisht më të vogla dhe për aktin se shumë punonjës të rinj merren në punë thjesht për të rritur kuotën e pakicave por nuk u ngarkohet asnjë detyrë apo vend pune. Kjo, jo vetëm që ua ul mundësinë për të marrë pjesë në mënyrë të efektshme në jetën ekonomike dhe publike, por nxit edhe mëritë brenda shoqërisë.<sup>200</sup> Parimin e proporcionalitetit e përdor edhe Mali i Zi, në funksion të punësimit në administratë.<sup>201</sup> Kushtetuta serbe parashikon që të merret në konsideratë “struktura etnike e popullsisë dhe përfaqësimi i duhur i personave që u përkasin pakicave kombëtare” gjatë punësimit në administratën publike në nivel qendror, krahinor dhe vendor.<sup>202</sup> Në Kosovë\* Kushtetuta u siguron komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre “përfaqësim të barabartë në punësim në organet publike dhe ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet”.<sup>203</sup> Në Bosnjë dhe Hercegovinë, duhet të sigurohet përfaqësimi proporcional i personave që u përkasin pakicave në të gjitha nivelet.<sup>204</sup>

Në këtë kuadër, ACFC shprehte kritika më së shumti për zbatimin e legjislacionit. Ai që skeptik për mbështetjen në të dhënat e censit, sidomos ngaqë këto janë kundërshtuar ose nuk pasqyrojnë ndryshimet demografike që kanë ndodhur gjatë dekadave të shkuara. ACFC është në përgjithësi i mendimit se përfaqësimi “proporcional” ose “me drejtësi” ose i përshkruar në mënyra të tjera të ngjashme është mirë të mos “synojë arritjen e një barazie rigide dhe matematikore në përfaqësimin e grupeve të ndryshme, [duke qenë se kjo] shpesh nënkupton një shumëfishim të panevojshëm të posteve [...]. [Masa të tilla] rezikojnë ta komprometojnë funksionin e efektshëm të strukturave shtetërore dhe mund të çojnë në krijimin e strukturave të veçuara në shoqëri”.<sup>205</sup>

197 Neni 22 i Ligjit Kushtetues për të Drejtat e Pakicave Kombëtare.

198 ACFC, opinioni i katërt për Kroacinë, 2015, pika. 88–90.

199 Marrëveshja Kuadër e Ohrit, neni 4, pika 2; Ligji i vitit 2008 për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave që u përkasin komuniteteve që përbëjnë më pak se 20% të popullsisë, Ligji për Nëpunësit Civilë.

200 ACFC, opinion i tretë për Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, 2011, pika. 171–172.

201 Neni 79, pika 10, i Kushtetutës dhe neni 25 i Ligjit për të Drejtat dhe Liritë e Pakicave. Sipas raportit të dytë shtetëror të Malit të Zi në kuadër të KMPK-së, rezultati i një ankete jo përfaqësuese tregonte këto përqindje: malazezë: 79,03%; serbë: 8,59%; shqiptarë: 2,80%; boshnjakë: 4,14%; 2,39%; 0,01%; 0,89%; 0,42%.

202 Neni 77, pika 2, i Kushtetutës së Serbisë.

203 Neni 61 i Kushtetutës së Kosovës.

204 Neni 19 i Ligjit të Bosnjës dhe Hercegovinës për Pakicat Kombëtare.

205 ACFC, Shpjegues Tematik për Pjesëmarrjen, pika 123.

## Përfundime

---

Situata e të drejtave të pakicave në rajon karakterizohet nga një ndryshueshmëri e lartë e nivelit të mbrojtjes ligjore, që shkon nga dispozita shumë të pakta ligjore, siç është rasti i Shqipërisë, deri në një rrjet të sofistikuar dhe ambicioz ligjesh në Kosovë\*. Në disa raste, si në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci dhe Malin e Zi, organet monitoruese të Këshillit të Evropës nuk kanë qenë tërësisht të kënaqura me dispozitat ligjore që fusin në zbatim pragje minimale të caktuara për popullsinë minoritare në mënyrë që kësaj popullsie t'i jepet mundësia për të përfituar të drejta gjuhësore apo arsimore. Gjithsesi, disa prej këtyre dispozitave lënë hapësirë për vendime diskrecionare në nivel vendor në favor të dhënies së këtyre të drejtave. Megjithëse, edhe ACFC, edhe COMEX, preferojnë norma ligjore të qarta në dallim nga akte nënligjore zbatimi i të cilave varet nga vullneti i mirë i autoriteteve, ata i nxisin autoritetet t'i shfrytëzojnë sa më shumë mundësitë e tyre. Sikurse e tregon, për shembull, rasti i Kroacisë, përdorimi i këtyre mundësive nga autoritetet vendore jo vetëm që varet nga madhësia e një pakice, nevojat dhe kërkesat e tyre, por në një shkallë të madhe edhe nga niveli i kohezionit ekzistues në shoqëri.<sup>206</sup> E njëjta gjë mund të thuhet për zbatimin në praktikë të dispozitave ligjore në përgjithësi, i cili në shumë raste nuk është i kënaqshëm në mendimin e organeve monitoruese të Këshillit të Evropës.

Projektet e zbatuara në kuadër të projektit të përbashkët BE-KiE "Nxitja e të drejtave të njeriut dhe e mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore" janë, pra, të rëndësishme maksimale, duke qenë se kanë kontribuar në rritjen e zbatimit në praktikë të standardeve ligjore ekzistuese. Projektet e përzgjedhura për këtë botim të praktikës së mirë e mbulojnë të gjithë spektrin e fushave të diskutuara në këtë prezantim të përgjithshëm mbi të drejtat e pakicave kombëtare në Evropën Juglindore.

Projekti i Zbatuar në Staro Nagoriçane (në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë) kishte në fokus mbrojtjen dhe nxitjen e kulturës minoritare. Në objektivin e synuar kishte një komunitet minoritar numerikisht më të vogël, serbët, e cila shpesh në skemat kombëtare të financimit është në pozita të pafavorshme. Për pakica të tilla, një punë e qëndrueshme nga niveli vendor është edhe më e rëndësishme. Një element i praktikës së mirë për t'u nënvizuar për projektin e zbatuar në Staro Nagoriçane është, gjithsesi, fakti se ai e ka nxitur kulturën serbe jo si të izoluar por ka punuar për t'i bashkuar dhe integruar serbët, maqedonasit dhe romët që jetën në këtë bashki.

Në fushën e të drejtave gjuhësore, qyteti i Pulës është përmendur më parë si shembull i praktikës së mirë nga COMEX. Identifikimi i elementeve që mund të përsëriteshin në kontekste të tjera në të gjithë rajonin është, pra, një kontribut i rëndësishëm për një proces të mundshëm mësimi kolektiv. Ndërkohë që aktivitetet e zhvilluara në Pulë fokusohen më shumë në vizibilitetin e jashtëm të gjuhës minoritare dhe formimin gjuhësor të personelit, aktivitetet e projektit të zhvilluara në qytetin e Suboticës (Serbi) kanë në fokus ngritjen e kapaciteteve

---

206 ACFC, opinioni i katërt për Kroacinë, 2015, pika 62.

teknike për një zbatim pa probleme të të drejtave gjuhësore. Pra, mund të shihen si plotësuese të njëra-tjetrës. Projekti i tretë që merret me të drejtat gjuhësore zbatohet në kushtet ligjore më të pafavorshme por që ka rëndësinë më të lartë për kontekstin përkatës. Bashkia e Gradishkës (Bosnjë dhe Hercegovinë) është identifikuar nga COMEX si një prej bashkive që është veçanërisht e rëndësishme për zbatimin e angazhimeve në kuadër të nenit 10 të KEGJRM-së, duke qenë se pjesë të rëndësishme të zonave ku kanë banuar tradicionalisht folësit e një numri gjuhësh minoritare ndodhen në territorin e kësaj bashkie. Projekti ka në objektivin e synuar pesë syresh: gjuha rome, ukrainase, polake, malazeze dhe gjermane. Aktivitetet e zhvilluara gjatë projektit janë përmendur nga COMEX si mënyra të zbatimit të angazhimeve të përzgjedhura nga Bosnja dhe Hercegovina lidhur me këtë nen, mes të tjerash, përkthimi i faqeve zyrtare në internet të bashkisë apo afishimi i toponimeve në gjuhën minoritare në tabelat publike turistike.

Projekti në Tivat (Mali i Zi) fokusohet te përfshirja e fëmijëve romë dhe egjiptianë në sistemin arsimor. Duke pasur parasysh përshkrimin e mësipërm të kuadrit ligjor dhe komentet e organeve monitoruese të Këshillit të Evropës, ky projekt ka rëndësi për të gjitha vendet përfituese. Aktivitetet projektit mbulojnë aspektet e mundësive për arsimim, mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe integritimit social. Në opinionin për Malin e Zi, ACFC përdorte gjuhë të fortë në kuptimin që i nxiste fuqimisht autoritetet t'i rrisnin përpjekjet për t'u dhënë zgjidhje vështirësive me të cilat përballen nxënësit romë në të gjitha nivelet e arsimit. Si çështje të pazgjidhur ende, ACFC përmendte faktin se asistentët arsimorë romë, krahas faktit që janë në numër të pamjaftueshëm, punojnë në kushte të pasigurta, duke qenë se nuk e kanë të përcaktuar statusin ligjor dhe se merren në punë me kontrata të përkohshme. Më poshtë përshkruhet se si është trajtuar ky konstatim nëpërmjet projektin.

Dy projekte kanë pasur në fokus pjesëmarrjen në jetën publike. Projekti në Përmet (Shqipëri) është interesant, duke qenë se është zbatuar në një mjedis ku mungon plotësisht kuadri ligjor, dhe përvoja e tij mund të jepte kontribut në procesin e hartimit të një ligji të gjithanshëm për pakicat, sidomos në lidhje me krijimin e organeve këshillimore në nivel vendor. Ky projekt, si edhe ai i zbatuar në Vushtrri (Kosovë\*), fokusohet te ngritja e kapaciteteve dhe fuqizimi i përfaqësuesve të pakicave, në mënyrë që të përmirësohet pjesëmarrja e kuptimtë e tyre në hartimin e dokumenteve strategjike për komunitetet minoritare në nivel bashkiak. Nëpërmjet fuqizimit dhe qasjes gjithëpërfshirëse, këto projekte mund të shërbejnë si shembuj për "pjesëmarrjen e efektshme" në nivel vendor, siç e kërkon neni 15 i KMPK-së.

Siç e tregon kapitulli në vijim, të gjitha këto projekte përmbajnë elemente që mund të përsëriten në vende të tjera, të cilët do të kontribuonin në një zbatim më të mirë të dispozitave ligjore ekzistuese dhe do t'u jepnin kështu zgjidhje disa prej shqetësimeve të ngritura nga organet monitoruese të Këshillit të Evropës.

## II. Praktikave të mira në kuadër të Projektit të Përbashkët të BE/KiE “Nxitja e të drejtave të njeriut dhe e mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore”

---

**S**a më poshtë, jepet një analizë e vënies në zbatim të shtatë rasteve studimore për mbrojtjen e pakicave kombëtare në njësitë e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Malin e Zi, Serbi, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovë\*. Në secilin rast studimor, analizohen aspektet që i kanë bërë të suksesshëm dhe kushtet në të cilat aktivitetet e tyre mund të përsëriteshin edhe në vende të tjera. Rastet studimore janë parapërzgjedhur nga anëtarët e Komitetit Drejtues të Projektit në nivel të çdo vendi përfitues, me asistencën e Ekipit të Projektit të Këshillit të Evropës si projektet më të mira të zbatuara gjatë periudhës 2014–2016 në kuadër të Projektit të përbashkët BE/KiE “Nxitja e të drejtave të njeriut dhe e mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore”. Kjo nismë përfshinte 36 projekte në mbarë rajonin, të cilët trajtonin nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave. Zbatimi i projekteve është bërë në bashkëpunim me bashkitë dhe, kur duhej ose mundej, me organizata vendore të shoqërisë civile dhe me përfshirjen aktive të komuniteteve vendore.

Analiza e praktikave më të mira mbështetet në vizita studimore në njësitë e parapërzgjedhura të vetëqeverisjes vendore nga ekipi i CSEES në periudhën maj-korrik 2016. Gjatë vizitave studimore, janë intervistuar 53 persona gjithsej, për t’u marrë mendim mbi rezultatet, qëndrueshmërinë në kohë dhe elementet e përsëritshme të projekteve të kryera. Nga kjo shifër, 19 qenë palë interesi të vetëqeverisjes vendore, 11 anëtarë të komuniteteve minoritare dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile (OSHC) të përfshira në zbatimin e projekteve dhe 23 përfitues jo të përfshirë në zbatimin e projekteve.<sup>207</sup>

Për të analizuar efektivitetin dhe përfitimet e projektit, si edhe mundësinë për përsëritje të projektit në kushte dhe vende të tjera, secili prej rasteve studimore është i strukturuar në katër pjesë: 1. Qëndrueshmëria në kohë: analizë e burimeve

---

<sup>207</sup> Me qëllim marrjen e përgjigjeve precize dhe të krahasueshme nga pjesëmarrësit në studim, u hartuan dy pyetësorë, njëri prej të cilëve për anëtarët e grupit të punës të projektit të cilët qenë të rëndësishëm për zbatimin e projektit dhe qenë më shumë të njohur me të, dhe tjetri për përfituesit e projektit, për të analizuar mendimet e tyre për projektin.

njerëzore dhe financiare dhe e potencialit për zbatim të vazhdueshëm dhe përsëritshmëri të projektit; 2. Roli udhëheqës: analizë se cilët aktorë e ndiejnë projektin si të tyrin dhe se si ka rëndësi kjo për suksesin e projektit; 3. Elementet kryesore të përsëritshme: analizë brenda projektit se cilët komponentë e kanë mundësinë për t'u përsëritur gjatë; 4. Përfitimi: cili është përfitimi kryesor për komunitetin, si sa i takon komunitetit të bashkisë në përgjithësi, dhe në veçanti për komunitetet e pakicave. Duke e strukturuar vlerësimin e projektit në mënyrë kaq të gjithanshme, shpresojmë se do të jemi në gjendje të përcaktojmë qartë ata komponentë që mund të përsëriten në kontekste të tjera në të ardhmen.

# Vlerësimi i praktikave më të mira në Shqipëri

---

**Të investosh në barazi: nxitja dhe promovimi i pjesëmarrjes së pakicave në pushtetin vendor dhe përmirësimi i realizimit të shërbimeve për komunitetet minoritare**

## **Bashkia Përmet**

*Tema: Pjesëmarrja në sferën publike dhe politike*

*Pakica e prekur: Egjiptiane, rome dhe vllahe arumune*

## **Hyrje**

---

*Konteksti vendor: pakicat dhe bashkësia e tyre*

**S**ikurse përshkruhet në hyrjen e këtij botimi, Shqipëria ka numrin më të vogël të dispozitave për mbrojtjen e pakicave. Megjithatë, marrëdhëniet ndëretnike në Shqipëri janë përgjithësisht të mira, duke qenë se ka tolerancë dhe mirëkuptim për komunitetet minoritare.<sup>208</sup> Pavarësisht nga kjo klimë e përgjithshme tolerance, komuniteti egjiptian dhe pakica rome në Shqipëri vuajnë nga diskriminimi dhe përjashtimi nga disa shërbime, si strehimi (shpesh të pambrojtur nga dëbimet me forcë), arsimit dhe kujdesi shëndetësor.<sup>209</sup> Gjithashtu, të dyja grupet vuajnë nga përjashtimi nga tregu formal i punës, për shkak të diskriminimit, duke u detyruar kështu t'u drejtohen punëve joformale, të cilat nuk i ndihmojnë të sigurojnë të ardhura të mjaftueshme për familjen.<sup>210</sup> Në zgjedhjet e fundit, sipas organizatës "Freedom House", pakicat qenë në gjendje të bënë fushatë dhe të votonin me fletë votimi në gjuhën e tyre, por pakica rome qe e pambrojtur nga "skemat e blerjes së votës".<sup>211</sup> Pakica greke është ankuar se qeveria nuk i njez disa qytete etnike greke dhe ka kërkuar një nivel më të lartë përfaqësimi në administratën publike.<sup>212</sup>

---

208 Informacion dhe udhëzues për vendin. Shqipëria: Grupet etnike minoritare, f. 4.

209 Po aty, f. 4 dhe f. 16.

210 Po aty, f. 11.

211 Raporti "Freedom House Report, Freedom in the World", Shqipëria, 2014.

212 Raportet e Departamentit të Shtetit të SHBA-së për të drejtat e njeriut. Raporti për Shqipërinë.

Në përgjithësi, pakicat greke dhe maqedonase janë të organizuara më mirë dhe të përfaqësuara mirë në nivel vendor, ndërsa pakica rome dhe komuniteti egjiptian janë ato që hasin më së shumti në vështirësi. Komuniteti egjiptian, në veçanti, është i pambrojtur duke qenë se nuk njihet si grup minoritar (kombëtar apo etnogjuhësor), por vetëm si komunitet, prandaj të drejtat që u jepen grupeve minoritare nuk zbatohen për këtë komunitet. Sipas institucioneve shqiptare, komuniteti egjiptian nuk i përmbush kriteret për t'u konsideruar si grup minoritar duke qenë se, sipas tyre, ky komunitet nuk ka një gjuhë të vetën (krahas shqipes) dhe një traditë të vetën.<sup>213</sup>

Bashkia Përmet, e cila bën pjesë në Qarkun e Gjirokastrës, ka tri grupe dhe komunitete minoritare: grekët, vllahët dhe egjiptianët. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, 17,42% e popullsisë në nivel bashkie i përkiste një pakice. Në Qarkun Gjirokastrë, 7,4% e popullsisë janë grekë, 0,95% janë arumunë, 0,13% romë dhe 0,3% janë egjiptianë, ndërsa 12,09% nuk pranoinin t'i përgjigjeshin kësaj pyetjeje.<sup>214</sup> Komuniteti egjiptian është më i pambrojturi, duke qenë se personat që u përkasin pakicave greke dhe vllahe janë të integruar më mirë në shoqëri. Komuniteti egjiptian është veçanërisht i prekur nga kushtet e dobëta shoqëro-ekonomike, mungesa e arsimimit, ndërsa gratë dhe fëmijët janë objekt i trafikantëve të qenieve njerëzore.<sup>215</sup>

### *Projekti: përgjigjja ndaj nevojave vendore*

Projekti fokusohet më shumë te komuniteti egjiptian; megjithatë, nga ky projekt kanë përfituar edhe pakicat vllahe dhe rome. Komuniteti egjiptian që fokusi kryesor i këtij projekti, meqë egjiptianët kishin më shumë nevojë si bashkësia në pozita më të pambrojtura që jeton në Përmet. Projekti synonte rritjen e pjesëmarrjes së pakicave në vendimmarrje dhe ndërgjegjësimin e tyre për të drejtat e tyre.

Një risk i mundshëm, i identifikuar në fillim të projektit, qenë vështirësitë e mundshme të angazhimit të bashkësisë vendore për shkak të nivelit të ulët të organizimit.<sup>216</sup> Në fakt, niveli i organizimit i komunitetit egjiptian përpara zbatimit të projektit që i kufizuar, çka tregonte rëndësinë e projektit, si edhe efektin e mundshëm të tij.<sup>217</sup> Projekti kishte dy komponentë, ku njëri ofronte formim dhe ndërgjegjësim për anëtarët e bashkësisë në lidhje me të drejtat e tyre dhe mënyrat si t'i marrin këto të drejta, ndërsa komponenti i dytë ofronte asistencë financiare që iu shpërnda vetë bashkësisë. Projekti vinte në objektiv problemin e organizimit të ulët të komunitetit egjiptian, nëpërmjet organizimit të trajnimeve për marrjen e shërbimeve shëndetësore dhe të ndihmës sociale, mbledhjeve dhe fushatave

213 Adresari i Pakicave: Shqipëria, egjiptianët <http://minorityrights.org/minorities/egyptians/>.

214 INSTAT, <http://www.instat.gov.al/al/census/census-2011/të-dhënat-sipas-qarqeve.aspx>

215 Informacion dhe udhëzues për vendin. Shqipëria: Grupet etnike minoritare, f. 5

216 "Nxitja e të drejtave të njeriut dhe e mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore": Raport për vlerësimin e projektit, f. 21

217 Po aty.

të ndërgjegjësimit në lidhje me votimin dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Pjesëmarrësit në pyetësor, të cilët kishin marrë pjesë edhe në trajnime, vërejtën se kjo kishte qenë hera e parë që u jepej mundësi të frekuentonin aktivitetet të tilla dhe se kishin mësuar shumë nga kjo përvojë. Është e rëndësishme të vërehet rëndësia e të gjitha trajnimeve dhe fushatave, duke qenë se e kishin të përcaktuar qartë grupin e synuar dhe qenë zhvilluar për komunitetin egjiptian që jeton në Përmet. Lidhja me aktualitetin e këtyre aktiviteteve ka kontribuar shumë në drejtim të suksesit të projektit.

Projekti kërkonte t'i jepte zgjidhje edhe problemit të strehimit për komunitetin egjiptian.<sup>218</sup> Një pjesë e fondeve të projektit u përdor për blerjen e 20 dritareve për shtëpitë e familjeve egjiptiane që kishin më shumë nevojë. Komiteti Civil, një komitet i përbërë nga pesë anëtarë, ku përfshiheshin edhe përfaqësues të komunitetit egjiptian, dhe i krijuar në kuadër të projektit, duhej të merrte vendim me konsensus për çdo dhurim fondesh. Ata i mbështetnin vendimet e tyre mbi një bazë të dhënash të hartuar nga stafi i projektit, ku përshkruheshin familjet egjiptiane dhe qenë kategorizuar nevoja e tyre. Kështu, Komiteti Civil mund të merrte vendime të bazuara në informacione, dhe, më e rëndësishmja, qenë anëtarët e komunitetit egjiptian ata që ndihmuan në gjetjen e zgjidhjeve për problemet e bashkësisë. Komiteti Civil është konsultuar gjatë gjithë projektit për zbatimin e aktiviteteve dhe kapacitetet e anëtarëve të tij janë rritur në mënyrë të konsiderueshme nëpërmjet trajnimeve.

### *Aktivitetet: krijimi i një hapësire gjithëpërfshirëse*

Ky projekt ka përfshirë disa aktivitete të cilat kanë pasur në objektiv të synuar rritjen e pjesëmarrjes së pakicave në qeverisjen vendore. Fillimisht, projekti kreu një ditë informuese në komunitet për të nxitur krijimin e OSHC-ve. Kjo shërbeu për krijimin e Komitetit Civil, një organ i krijuar nga vetë anëtarët e pakicës të cilët do të drejtonin zbatimin e projektit. Komiteti Civil u zgjodh nga vetë bashkësia dhe kishte kompetencë vendimmarrëse për shpërndarjen e fondeve që u përdorën për t'i ndihmuar anëtarët e komunitetit nëpërmjet blerjes së dritareve për shtëpitë dhe, në një rast, për të ndihmuar një anëtare të komunitetit për të marrë ndihmë mjekësore.

Në mënyrë që të rritej ndërgjegjësimi i zyrtarëve të bashkisë dhe i vetë anëtarëve të komunitetit për të drejtat e tyre dhe për institucionet dhe mekanizmat e disponueshme për mbrojtjen e tyre, projekti zhvilloi një seancë informuese për të drejtat dhe mekanizmat, tri trajnime (një për OSHC-të për Komitetin Civil, një për të drejtat e grave dhe luftën kundër trafikimit, dhe një për personelin bashkiak për parashikimin në buxhet të financave në veçanti për komunitetet minoritare) dhe një program edukativ ligjor. Projekti ka organizuar dhe udhëhequr edhe dy fushata informimi, një për ndërgjegjësimin e votuesve në lidhje me zgjedhjet e ardhshme vendore, ku theks i veçantë është vendosur mbi gratë votuese, dhe

218 "Nxitja e të drejtave të njeriut dhe e mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore": Raport i dytë për vlerësimin e ndërgjegjësimit, f. 69.

një për dokumentimin e duhur dhe procedurat për vlerësimin e shërbimeve shëndetësore për të gjitha kategoritë e ndihmës financiare sociale, si edhe për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Çështja e trafikimit është trajtuar edhe në një takim të përbashkët me komunitetin egjiptian dhe policinë lokale. Si rezultat i rritjes së ndërgjegjësimit, nëpërmjet aktiviteteve të organizuara nga projekti, për herë të parë qytetarët zgjodhën një grua egjiptiane si anëtare të Këshillit Bashkiak.

Projekti krijoi pozicionin e një koordinatori për pakicat, i cili vjen nga pakica egjiptiane dhe u punësua pranë bashkisë në një periudhë 6 mujore. Koordinatori për pakicat ka qenë pika e referimit për komunitetin egjiptian dhe ka shërbyer për t'u qëndruar pranë dhe për t'i informuar anëtarët e kësaj bashkësie lidhur me të drejtat e tyre dhe mekanizmat për t'i arritur ato. Koordinatori për pakicat përgatiti edhe një bazë të dhënash për të gjithë personat që i përkasin komunitetit egjiptian që kanë nevojë për ndihmë.

Në fund, është përgatitur një broshurë me histori pozitive, në të cilën janë përfshirë historitë e individëve të shquar të pakicave. Kjo shërbeu si një shenjë vlerësimi për pakicat, në mënyrë që të rritej mendimi pozitiv për pakicat dhe të luftoheshin paragjykimet.

## Metodika

---

Për këtë analizë, janë intervistuar shtatë individë, nga të cilët njëri qe zyrtar bashkiak; dy vetë qenë punonjës të projektit (koordinatori i projektit dhe koordinatori për pakicat), tre anëtarë të pakicave të synuara dhe konsulenti që mbikëqyri projektin gjatë zbatimit. Gjashtë prej personave të intervistuar qenë femra, njëri qe mashkull. Shumica e intervistave u zhvilluan nga afër në Bashkinë Përmet, në muajin maj 2016. Intervistat me dy anëtarët e pakicave të synuara u kryen me telefon, ndërsa intervista me konsulentin u krye me postë elektronike.

## Vlerësimi i projektit

---

Projekti qe i suksesshëm sepse hodhi një themel të fortë për përfshirjen e pakicës egjiptiane në vendimmarrjen e Bashkisë Përmet. Përmes koordinatorit për pakicat i cili punonte pranë bashkisë, komunitetet kishin një person kontakti të cilit mund t'i drejtoheshin në lidhje me ofrimin e shërbimeve pranë bashkisë. Komiteti Civil, anëtarët e të cilit përfshinin anëtarë të komunitetit egjiptian, qe një hap kyç drejt përfshirjes së personave që i përkasin këtij komuniteti në vendimmarrje, sidomos në fushat që i prekin më shumë. Projekti ia doli mbanë të rriste ndërgjegjësimin e pakicave përmes trajnimeve për të drejtat e tyre, ku të drejtoheshin për t'i zgjidhur ato, si edhe për rëndësinë e ushtrimit të së drejtës së votës.

## Qëndrueshmëria në kohë

### ► Rritja e pjesëmarrjes në vendimmarrje

Ky projekt e rriti pjesëmarrjes e komunitetit egjiptian në vendimmarrje nëpërmjet krijimit të Komitetit Civil. Komiteti qe një organ shumë funksional dhe i efektshëm, i cili mbajti mbledhje të rregullta dhe drejtoi bashkërisht projektin. Krahas përzgjedhjes së përfituesve që do të merrnin ndihmë financiare në formën e vendosjes së dritareve dhe në një rast në formën e ndihmës që iu dha një anëtareje të komunitetit egjiptian për të marrë shërbime mjekësore, Komiteti ka zhvilluar mbledhje edhe për të diskutuar për çështjet e komunitetit dhe drejtimin e projektit. Të gjitha vendimet janë marrë me konsensus dhe ekipi ka ruajtur bashkëpunimin nga afër me punonjësit e projektit gjatë të gjithë projektit.

Projekti ka siguruar edhe një pjesëmarrje më të efektshme dhe më afatgjatë të komunitetit egjiptian në vendimmarrje nëpërmjet organizimit të seminareve lidhur me rëndësinë që kanë votimi dhe pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse në nivel vendor. Krahas kësaj, gjatë përgatitjeve për zgjedhjet bashkiake, punonjësit e projektit iu afruan të gjitha palëve vendore për të bërë lobim për përfshirjen e një anëtari egjiptian në listat e kandidatëve dhe morën miratimin e një partie, me kusht që të ishte kandidate femër. Mbështetja për kandidaten u siguruar përmes ndërgjegjësimit të grave egjiptiane për të drejtën e votës dhe përse çdo votë është e rëndësishme. Megjithëse ky aktivitet nuk qe një fushatë e drejtpërdrejtë për kandidaten, ai rriti edhe ndërgjegjësimin për procedurat e votimit si edhe për gjërat që duhen mbajtur parasysh në zgjedhjen e një kandidati. Motoja e kësaj fushate informimi qe “Mos e shit votën”. Duke pasur parasysh faktin se në Shqipëri nuk ka legjislacion që lehtëson zgjedhjen e përfaqësuesve të pakicave në këshillat vendorë, dilte edhe më shumë nevoja për një ndërgjegjësim dhe mbështetje të tillë. Fushata mund të konsiderohet se doli me sukses, sepse përfaqësuesja e komunitetit egjiptian i fitoi zgjedhjet për në Këshillin Bashkiak.

### ► Ndërgjegjësimi i komunitetit egjiptian për të drejtat e tyre

Komuniteti egjiptian që jeton në Përmet pati mundësinë të merrte pjesë në disa trajnime ndërgjegjësimi për të drejtat që u takojnë sipas ligjeve shqiptare dhe standardeve evropiane. Trajnimet u frekuentuan mirë, si nga burrat, edhe nga gratë, dhe qenë të parat që frekuentonte komuniteti egjiptian në Bashkinë Përmet.

Trajnimet dhe 30 aktivitetet e fushatës së informimit qenë të efektshme sepse u përgjigjeshin nevojave lokale dhe çështjeve aktuale që preknin komunitetet. Komuniteti egjiptian në Përmet ka vështirësi me paraqitjen e kërkesave për mbështetje financiare nga shteti, prandaj një prej trajnimeve merrej enkas me këtë çështje. Fushata dhe trajnimi kundër trafikimit të qenieve njerëzore qenë gjithashtu me rëndësi, duke qenë se ka pasur dy raste trafikimi kohët e fundit në Përmet. Fushatat e ndërgjegjësimit janë zhvilluar në të gjitha zonat e ndryshme

të banuara të Bashkisë Përmet, me qëllim përfshirjen e anëtarëve të komunitetit egjiptian që jetojnë territorin e gjerë të bashkisë.

- ▶ Përmirësimi i rrugëve të zgjidhjes dhe përgjigjes ndaj çështjeve të bashkësisë

Pozicioni i koordinatorit për pakicat pranë bashkisë i ka rritur ndjeshëm mundësitë për zgjidhjen dhe përgjigjen ndaj çështjeve të pakicave. Koordinatori ka shërbyer si një urë komunikimi ndërmjet komunitetit egjiptian dhe bashkisë. Duke qenë se edhe koordinatori ishte nga komuniteti egjiptian, kjo ndihmoi në krijimin e besimit si edhe të një ndjesie përgjegjësie brendapërbrenda bashkisë. Koordinatori krijoi edhe një bazë të dhënash ku renditeshin nevojat e anëtarëve të ndryshëm të komuniteteve egjiptiane, me një përshkrim të ndihmës për të cilën kishin nevojë dhe të situatës së tyre shoqëro-ekonomike. Pra, ky është një shembull i rëndësishëm së mbledhjes së të dhënave të besueshme në të gjitha nivelet, në mënyrë që të krijohet mundësia për t'i trajtuar si duhet nevojat e komuniteteve minoritare. Kjo domosdoshmëri është theksuar në mënyrë të përsëritur nga ACFC, sidomos në komentet e bëra në bazë të nenit 4 të KMPK-së.

Duke pasur një zyrë të tillë brenda bashkisë, ishte më e lehtë të trajtoheshin nevojat imediate të komunitetit egjiptian dhe t'u jepej më shumë legjitimitet të gjitha aktiviteteve. Anëtarja e sapozgjedhur në Këshillin Bashkiak siguron edhe që nevojat e komunitetit të marrin zgjidhje në nivele më të larta se strukturat bashkiake. Mirëpo, bashkia nuk ka dhënë asnjë angazhim për ta mbajtur postin e koordinatorit edhe pasi të mbarojë projekti, çka tregon se ky post varet nga vullneti politik.

- ▶ Fuqizimi i grave që u përkasin komuniteteve minoritare

Ky projekt ka kontribuar në drejtim të fuqizimit të grave egjiptiane në Përmet duke i informuar për të drejtat e tyre dhe duke nxitur pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje, sërish në përgjigje të një kërkesë të parashikuar në nenin 15 të KMPK-së. Në Komitetin Civil, nga pesë anëtarët, dy qenë gra. Gjithashtu, përfaqësuesja egjiptiane e zgjedhur në Këshillin Bashkiak është grua.

Me rëndësi që edhe fokusi te gratë në aktivitetin e ndërgjegjësimit për të drejtat e votuesve, meqë shpesh gratë janë objekt i roleve tradicionale, dhe prej tyre pritet të votojnë në përputhje me bashkëshortin ose babanë. Duke ua rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e votimit, projekti synonte t'i njëhte gratë me procesin e votimit dhe me efektin që ka në jetën e tyre. Gjithashtu, trajnimi për të drejtat gjinore dhe fushata kundër trafikimit të qenieve njerëzore janë sidomos të rëndësishme duke qenë se gratë janë viktimat më të shpeshta të trafikimit të qenieve njerëzore. Përmes vendosjes së një kontakti të ngushtë me policinë lokale, efektivë të së cilës morën pjesë në aktivitet, gratë u informuan si duhet se ku të drejtohen dhe për shenjat e rrezikut për të parandaluar trafikimin. Kështu, gratë patën mundësi të krijonin një marrëdhënie besimi me policinë lokale.

## Faktori udhëheqës

Faktori udhëheqës për projektin gjendej te punonjësit e projektit, të cilët qenë shumë të angazhuar dhe të motivuar, dhe te Komiteti Civil. Falë angazhimit të punonjësve të projektit, projekti iu përgjigj në nivelin më të lartë nevojave të komuniteteve të synuara, duke ofruar trajnime dhe fushata për çështje të cilat qenë aktuale për kushtet lokale, si votimit, trafikimi i qenieve njerëzore dhe regjistrimi në gjendjen civile. Edhe bashkësia u përfshi nga afër në zbatimin e projektit dhe u ndie e angazhuar në të. Përmes aktiviteteve të ndryshme, sidomos përmes Komitetit Civil, komunitetet minoritare patën mundësinë t'u jepnin zë shqetësimeve dhe ta orientonin projektin drejt gjetjes së zgjidhjeve.

## Elementet kryesore të përsëritshme

Ky projekt ka disa komponentë që mund të përsëriten në bashki të ndryshme, për të trajtuar në mënyrë të efektshme çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet minoritare dhe për ta çuar përpara pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje.

### ► Koordinatorit për pakicat

Roli i koordinatorit për pakicat është një post i dobishëm që shërben për ndërtimin e një marrëdhënieje më të afërt me komunitetet vendore. Ky rol përmbush edhe nevojën për të pasur një përfaqësues i cili e njeh dhe e kupton komunitetin brenda bashkisë. Koordinatorit për pakicat jep kontribut të madh në drejtim të përmirësimit të përgjigjes që bashkia u jep nevojave të komunitetit dhe në drejtim të rritjes së besimit që komuniteti ka te institucionet bashkiake. Ky mund të jetë një post i vetëm, si në rastin e Përmetit (megjithëse koordinatori në këtë rast kishte ndihmën e një koordinatori projekti shumë të përkushtuar) ose mund të jetë si një zyrë e plotë, si në rastin e zyrave komunale për komunitetet dhe kthimet në Kosovë\*. Për hir të zgjatjes sa më shumë në kohë, rëndësi ka që ky rol të mos jetë i përkohshëm, por një post i mbështetur në ligj. Kjo do ta bënte më pak të varur nga vullneti politik, që është problem në rastin e Përmetit. Me ndryshimin e kryetarit të bashkisë, punonjësit e projektit vijuan të punonin në mënyrë vullnetare, falë përkushtimit ndaj projektit, që do të thotë se punuan pa kontratë në mënyrë që ta çonin projektin deri në fund. Janë angazhuar persona të tjerë për pjesën tjetër të projektit, ndërsa roli i koordinatorit u hoq fare, bashkë me përfaqësuesin egjiptian që punonte në të.

Çështje që duhen mbajtur parasysht:

- **Vullneti politik:** duke qenë se posti i koordinatorit për pakicat është brenda bashkisë dhe nuk ka bazë ligjore, mungesa e vullnetit politik mund ta pengojë qëndrueshmërinë në kohë të tij.
- **Mungesa e OSHC-ve:** ky problem është zbutur nëpërmjet krijimit të një këshilli vendor, por projekti do të kishte qenë më i qëndrueshëm në kohë nëse nuk do të mbështetej vetëm te bashkia për zbatimin e tij. Në të njëjtën kohë, kjo tregon nevojën për një projekt të tillë.

### ► Komiteti Civil

Komiteti Civil është një instrument i efektshëm për t'i përfshirë komunitetet minoritare në vendimmarrje, siç e kërkon neni 15 i KMPK-së. Komiteti në Përmet përbëhej nga pesë anëtarë të komunitetit, por nëse përsëritet si përvojë në vende të tjera dhe nëse duhet përfshirë më shumë se një pakicë në Komitet, atëherë numri i anëtarëve mund të jetë më i madh. Krahas kësaj, është mirë të tregohet kujdes që Komiteti të jetë i drejtëpeshuar sa i takon përkatësisë gjinore, në mënyrë që të sigurohet trajtimi i nevojave të të gjithë anëtarëve të komuniteteve. Përvoja pozitive me një komitet të tillë të merret në konsideratë në debatet që po zhvillohen për hartimin e një ligji për pakicat në Shqipëri, në mënyrë që komitetet të kenë edhe bazë ligjore.

Një faktor i rëndësishëm që ka ndihmuar punën e Komitetit dhe që rekomandohet të përsëritet është funksioni si organizatë e shoqërisë civile. Pra, Komiteti ka funksionuar si OSHC në një bashki ku nuk kishte asnjë organizatë minoritare, paçka se nuk ishte e regjistruar si e tillë. Një komitet i tillë është mirë të ketë bazën ligjore, ose përmes regjistrimit si OSHC, ose si një organ konsultativ bashkiak, çka do t'i jepte më shumë legjitimitet. Kjo është sidomos me vlerë për bashkitë ku komunitetet minoritare nuk janë të organizuara. Komiteti e ka ndihmuar komunitetin egjiptian të sigurojë probleme të cilat i ka identifikuar vetë. Në këtë rast është me rëndësi që Komiteti nuk ushtronte aktivitet brenda institucioneve bashkiake, por si një OSHC de fakto, çka i jepte mundësi që edhe t'i kritikonte organet bashkiake. Mirëpo, ajo që e bënte të efektshëm Komitetin që bashkëpunimi nga afër me bashkinë, pra është e rëndësishme që bashkitë të jenë të ndërlidhura me OSHC-të dhe organet e tjera konsultative kur punojnë me pakicat dhe për pakicat. Për zbatimin e projektit, anëtarësimi në komitet që vullnetar, por, për t'ia siguruar dhe rritur efektivitetin, do të ishte më e efektshme që Komitete të tilla të kenë një bazë ligjore, qoftë si OSHC, qoftë si organ bashkiak, në mënyrë që të kenë të drejtë dhe të sigurojnë fonde.

### ► Fushatat e ndërgjegjësimit

Fushatat e ndërgjegjësimit, apo fushatat e informimit, siç quheshin nga projekti, qenë shumë të rëndësishme, sidomos ngaqë fokusoheshin te nevojat lokale të komunitetit egjiptian. Ndërgjegjësimi, përmes trajnimeve, takimeve apo shpërndarjes së fletushkave, është i rëndësishëm për t'i bërë komunitetet minoritare, por edhe shoqërinë e gjerë, të ndërgjegjshëm për të drejtat e tyre. Në përgjithësi, kishte një nivel të ulët ndërgjegjësimi për të drejtat e pakicave në rajon, te vetë komunitetet minoritare, dhe në raste të tilla janë të nevojshme dhe rekomandohen masat e ndërgjegjësimit. Sidomos kur nuk ka OSHC aktive që merren me çështjet e pakicave, është mirë që institucionet vendore ose qendrore të zbatojnë fushata ndërgjegjësimi.

### ► Nxitja e zgjedhjes së përfaqësueses të pakicës

Përfshirja e pakicave në zgjedhjet vendore është shumë e rëndësishme, prandaj rekomandohet nxitja e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhjet vendore. Kjo ka të bëjë me nxitjen e pakicave të marrin pjesë, jo vetëm si votues, por edhe si përfaqësues në pushtet vendor. Në mungesë të mekanizmave ligjore që të garantojnë ose

ndihmojnë përfaqësimin e pakicave në organet e zgjedhura në nivel vendor, pakicat mund të nxiten nëpërmjet ndërgjegjësimit ose lobimit, siç u veprua në Përmet. Me të gjitha partitë u bë lobim për një vend në listën e kandidatëve, gjersa u ra dakord me njërën prej tyre.

- ▶ Rritja e dialogut ndërkulturor dhe vlerësimi i kulturave të pakicave

Broshura që u përgatit në fund të projektit përshkruan arritjet pozitive dhe kontributet e individëve që u përkasin komuniteteve rome dhe egjiptiane, si një praktikë e mirë dhe e përsëritshme. Broshura shërben për të theksuar kontributet pozitive të pakicave në shoqëri, duke e ndryshuar kështu narrativën që mbizotëron për pakicat, nga negative ose diskriminuese, në një narrativë që evidenton sukseset dhe mënyrat me të cilat komunitetet e ndryshme kanë kontribuar në drejtim të përmirësimit më tej të shtetit, qoftë në kulturë, ose në fusha të tjera. Kjo broshurë mund të përditësohet me individë të rinj me vlerë dhe të shpërndahet gjerësisht në këtë bashki, përfshirë edhe nëpër shkolla, ku rekomandohet nxitja e shpërndarjes te fëmijët. Broshura do të jepte kontribut në drejtim të zbatimit të nenit 5 dhe 6 të KMPK-së, për të rritur frymën e tolerancës dhe dialogut ndërkulturor.

#### **Përfitimet:**

1. Rritje e ndërgjegjësimit të komuniteteve minoritare për të drejtat e tyre dhe për institucionet dhe mekanizmat për t'i kërkuar ato.
2. Rritje e efektivitetit të përgjigjes së Bashkisë ndaj nevojave lokale nëpërmjet vendosjes së një koordinatori për pakicat.
3. Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile me bazë në komunitet.
4. Fuqizimi i grave që u përkasin komuniteteve minoritare.
5. Ngritja e bazës për funksionimin e organeve konsultative.

## **Përfundime dhe rekomandime**

---

Projekti në Përmet ka kontribuar shumë në drejtim të përfshirjes së pakicës egjiptiane në vendimmarrje. Ai ka rritur edhe ndërgjegjësimin e komunitetit egjiptian për të drejtat e tyre, mekanizmat që mund të përdorin dhe si t'i përdorin. Projekti ka qenë sidomos i suksesshëm ngaqë iu është përgjigjur nevojave dhe problemeve të komunitetit egjiptian, duke i lidhur kështu aktivitetet me jetën e komuniteteve në këtë bashki.

Për një zbatim më efikas dhe përsëritjen e tij gjetkë, rekomandohet sa vijon:

- ▶ **Ndërgjegjësimi për rolin e shoqërisë civile.** Është e rëndësishme që komunitetet minoritare ta kuptojnë nevojën e organizimit si bashkësi, në rrugë politike, si edhe në rrugë civile. Në kuadër të këtij projekti, u krijua

Komiteti Civil, duke qenë se nuk kishte asnjë organizatë të shoqërisë civile që merrej me çështjet e pakicave. Projekti rriti ndërgjegjësimin për përfaqësimin politik, si edhe rriti kapacitetet e anëtarëve të komunitetit për t'i njohur dhe ushtruar të drejtat e tyre. Hapi tjetër do të ishte pasja e një komiteti civil të regjistruar, i cili, ose do të funksiononte si OSHC, ose si një organ bashkiak i mbështetur në ligjet shtetërore.

- ▶ **Ngritja e organeve konsultative.** Ky projekt e ka bërë të qartë nevojën për organe konsultative të përbëra nga pakicat, por jo vetëm, me një bazë ligjore dhe mandat të qartë, si në nivel qendror, ashtu edhe në nivel vendor. Projekti mbështeti krijimin e Komitetit Civil. Ndërkohë që OSHC-të, në këtë rast Komiteti Civil, funksiononin si organizata civile në bashkëpunim të ngushtë me bashkinë, rekomandohet që të ekzistojnë zyra konsultative kombëtare dhe më të përhershme, për të siguruar zbatimin e të drejtave të njeriut dhe të pakicave brenda bashkive. Komitete të tilla mund të regjistrohen si shoqata ose OSHC në të gjitha bashkitë me pakica dhe bashkia të ketë detyrimin me ligj që të jetë në kontakt me to për çështje që kanë të bëjnë me komunitetet minoritare. Përndryshe, organe të tilla mund të bëhen shumë të varura nga vullneti politik. Gjithashtu, aty ku nuk ekzistojnë, shtetet duhet të mundësojnë krijimin e mekanizmave konsultative kombëtare të cilat do të ndërlidheshin me organet konsultative dhe përfaqësuesit e komuniteteve në nivel vendor.



## Bashkia Përmet

Vlerësimi i praktikave më të mira në Shqipëri



# Vlerësimi i praktikave të mira në Bosnjë dhe Hercegovinë

---

Shfrytëzimi i qëndrueshëm i teknologjive informatike në funksion të nxitjes së pakicave kombëtare nga zona e Bashkisë Gradishkë

**Bashkia Gradishkë**

*Tema: Gjuha dhe mediat*

*Pakicat e prekura: rome, ukrainase, polake dhe malazeze*

## Hyrje

---

*Konteksti vendor: pakicat dhe bashkësia e tyre*

**N**jëzet vjet pas fundit të luftës, ku u bënë krime të rënda nga të gjitha palët e përfshira, përfshirë edhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, dëbimet dhe gjenocidin,<sup>219</sup> Bosnja dhe Hercegovina mbetet një vend thellësisht i ndarë sipas përkatësive etnike, për shkak të mospërfundimit të pajtimit mes palëve që kanë qenë të përfshira në luftë, por edhe për shkak të veçimit të kërkuar me kushtetutë në jetën politike dhe publike sipas përkatësisë etnike.

Konflikti mori fund vetëm kur u arrit Marrëveshja e Përgjithshme Kuadër për Paqen në Bosnjë dhe Hercegovinë (Marrëveshja e Dejtonit).<sup>220</sup> Nisur nga nevoja për të krijuar një shtet të realizueshëm në Bosnjë dhe Hercegovinë, detyra kryesore e Marrëveshjes së Dejtonit qe ruajtja e një drejtpeshimi pushteti ndërmjet tri kombeve që e formojnë këtë shtet, pra ndërmjet popujve themelues. Termi themelues lidhet me faktin se anëtarët e këtyre grupeve etnike përmenden shprehimisht në kushtetutë dhe se asnjëri prej tyre nuk mund të konsiderohet si pakicë. Pra, Marrëveshja e Dejtonit orvatej të zgjidhte problemin më të ngutshëm në

---

219 Në një vendim të datës 26 shkurt 2007, në një çështje për zbatimin e Konventës për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë konstatonte se, në fakt, në Bashkinë Srebrenicë ishte kryer gjenocid. Shih GJND, "Bosnja dhe Hercegovina – Serbia dhe Mali i Zi", Çështja 91, Aktgjykim i datës 26 shkurt 2007.

220 *Marrëveshja e Përgjithshme Kuadër për Paqen në Bosnjë dhe Hercegovinë*, e sigluar në Dejton, Ohajo: 21 nëntor 1995, e nënshkruar në Paris: 14 dhjetor 1995, e miratuar nga Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Republika Federative e Jugosllavisë, 35 (1996) ILM 75.

projektimin e institucioneve demokratike, përmes ofrimit të një modeli të ndarjes së pushtetit ndërmjet boshnjakëve, serbëve dhe kroatëve në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Por, krahas popujve themelues, në Bosnjë dhe Hercegovinë jetojnë edhe shtatëmbëdhjetë grupime të tjera etnike (shqiptarë, malazezë, çekë, italianë, çifutë, hungarezë, maqedonas, gjermanë, polakë, romë, rumunë, rusë, rutenianë, sllovakë, sllovenë, turq dhe ukrainas). Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2013,<sup>221</sup> 2,73% ose 96.539 shtetas të Bosnjës dhe Hercegovinës u përkasin pakicave kombëtare. Të drejtat e pakicave kombëtare mbrohen në nivel kombëtar me anë të ligjit të vitit 2003 për mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve të pakicave kombëtare, i cili u garanton lirinë kulturore, fetare, arsimore, shoqërore, ekonomike dhe politike. Gjithashtu, për shkak të copëzimit administrativ të shtetit sipas përkatësisë etnike, të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare shtellohen në dy ligje të entiteteve, që janë ligji për mbrojtjen e personave që u përkasin pakicave kombëtare në Republikën Srpska (RS) dhe ligji për mbrojtjen e personave që u përkasin pakicave kombëtare në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës (FBH).

Problemet kryesore të komuniteteve etnike jo shumicë në Bosnjë dhe Hercegovinë përfshijnë diskriminimin institucional, mungesën e mundësive për punësim, arsim dhe të drejta shoqërore. Siç konstatonte Gjykata Evropiane e të Drejtave në Njeriut që në vitin 2009 në çështjen "Sejdić dhe Finci – Bosnja dhe Hercegovina", Kushtetuta e Bosnjës dhe Hercegovinës i diskriminon pakicat kombëtare duke i përjashtuar popujt jothemelues nga mundësia për t'u zgjedhur si president apo si anëtar i dhomës së lartë të parlamentit kombëtar dhe duke u mohuar të drejtën për të vënë veton mbi një legjislacion të cilin ata e konsiderojnë se u cenon interesat e grupit etnik. Ndërkohë që papunësia në Bosnjë dhe Hercegovinë shkon 30%,<sup>222</sup> ky problem është më i theksuar në rastin e pakicave rome, të cilat kanë edhe problemin shtesë të mosarritjes së hyrjes në tregun e punës për shkak të nivelit të ulët arsimor.

Bashkia Gradishkë ndodhet në pjesën veriperëndimore të Bosnjës dhe Hercegovinës, me popullsi 51.727 banorë, 999 prej të cilëve u përkasin pakicave kombëtare, sipas censit më të fundit. Bashkia ka 69 fshatra, të organizuara në 53 komunitete lokale. Pakicat kombëtare më së shumti banojnë në pjesët rurale të bashkisë, çka e përkeqëson pamundësinë për të marrë shërbimet kryesore dhe për të marrë pjesë në tregun e punës. Në bazë të të dhënave të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Gradishkë, ka katër shoqata të pakicave kombëtare që janë aktive në Gradishkë: Shoqata e malazezëve dhe miqve 'Luča', shoqata e polakëve 'Mak', shoqata e ukrainasve 'Verhovena' dhe Shoqata Rome e Bashkisë Gradishkë.

### *Projekti: përgjigjja ndaj nevojave vendore*

Objektivi kryesor i projektit "Shfrytëzimi i qëndrueshëm i teknologjive informatike në funksion të nxitjes së pakicave kombëtare" qe rritja e dukshmërisë së shoqatave ekzistuese të pakicave kombëtare në Bashkinë Gradishkë, rritja e ndërgjegjësimit

221 Regjistrimi i Popullsisë, Familjeve dhe Banesave në Bosnjë dhe Hercegovinë. 2013.

222 Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. Anketë për Opininion Publik 2015 e "Balkan Barometer", Sarajevë 2015.

të gjithë banorëve të Gradishkës për ekzistencën dhe aktivitetet e tyre dhe nxitja e përdorimit të gjuhëve minoritare. Kjo detyrë është arritur përmes krijimit të një platforme të bashkisë në internet, e cila përmban të gjithë informacionin përkatës, të përkthyer në gjuhët e pakicave kombëtare që jetojnë në Bashkinë Gradishkë. Në këtë mënyrë, gjuhët minoritare u integruan në faqen zyrtare në internet të Bashkisë Gradishkë. Meqë përfaqësuesit e pakicës kombëtare malazeze hoqën dorën nga mundësia për ta përkthyer faqen në internet në gjuhën malazeze për shkak të ngjashmërisë me gjuhën zyrtare, atë serbe, faqja në internet u përkthye në gjuhët polake, ukrainase dhe rumune.<sup>223</sup> Krahas kësaj, u vendosën 17 tabela topografike në dy gjuhë, për të shënuar dhe treguar vendet historike, kulturore dhe fetare minoritare.

Pjesëmarrësit e pyetur për këtë studim e konsideronin të rëndësishëm këtë projekt, sepse ai e ka rritur dukshmërinë e pakicave të Gradishkës dhe i ka ndihmuar në jetën e përditshme. Siç e theksoi një prej të intervistuarve, projekti e ka "ngritur në një nivel të ri" bashkëpunimin që ekzistonte më parë ndërmjet Bashkisë dhe shoqatave të pakicave kombëtare. Gjithashtu, siç e tha një përfaqësues i një pakice të synuar, projekti ka arritur për herë të parë bashkëpunimin ndërmjet shoqatave të ndryshme të pakicave, të është një bazë e mirë për aktivitetet e përbashkëta në të ardhmen me synim sigurimin e kushteve më të favorshme për mbrojtjen e të drejtave të pakicave.

Por, raporti i parë për të gjitha vendet, i realizuar në kuadër të Projektit të përbashkët BE/KiE "Nxitja e të drejtave të njeriut dhe e mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore"<sup>224</sup> kishte parashikuar që projekti i ndërmarrë që konsideruar si prioritet në nivel të moderuar, si nga ekipi zbatues, ashtu edhe nga pjesëmarrësit e vlerësimit të ndërgjegjësimit, veçanërisht në krahasim me problemet e tjera me të cilat përballen personat minoritarë në bashki. Risku i dytë i vërejtur kishte të bënte me një nivel relativisht të ulët organizimi të grupeve minoritare në Gradishkë. Projekti ia ka dalë mbanë bindshëm ta zbusë këtë shqetësim të fundit duke u ofruar shoqatave të pakicave kanale të reja komunikimi me aktorët bashkiakë. Kjo, nga ana e vet, e ka rritur rolin proaktiv të tyre në zbatimin e projektit, çka ka sjellë një kontribut konstruktiv në hartimin e aktiviteteve pasuese, të cilat iu përgjigjën me sukses shqetësimit të parë, të shprehur në raportin për vendin. Më konkretisht, aktivitetet pasuese mbështeten te mbrojtja e gjuhëve minoritare – komponenti kryesor i projektit, duke e lidhur këtë me fuqizimin e kapacitetit të shoqatave të pakicave në fushën e teknologjike informatike dhe përpilimin e projekteve.

Kështu, ndërsa pjesa e parë e projektit është zhvilluar më së shumti nga vetë palët e interesit në bashki, aktivitetet pasuese janë propozuar bashkërisht nga pakicat dhe palët e interesit në bashki. Kjo ka siguruar eliminimin e dallimeve të konsiderueshme në prioritetet e lidhura me masat e projektit ndërmjet

---

223 Gjithashtu, duke njohur nevojën për ta hapur bashkinë ndaj investitorëve të mundshëm të huaj dhe se shumë vizitorë të huaj e përdorin Gradishkën si pikë hyrjeje në Bosnjë dhe Hercegovinë, aktorët bashkiakë i kanë përkthyer prezantimet në internet edhe në gjuhët angleze, gjermane dhe italiane.

224 "Nxitja e të drejtave të njeriut dhe e mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore", Raporti i Parë për Vendin.

përfaqësuesve të pakicave dhe aktorëve bashkiakë. Pra, edhe pse pjesëmarrësit në pyetësor nga shoqatat e pakicave e konsiderojnë fazën e dytë të projektit si më të lidhur me nevojat e tyre, si pjesëmarrësit nga pakicat ashtu edhe nëpunësit bashkiakë i kushtonin një prioritet më të lartë aktiviteteve pasuese.

### *Aktivitetet: krijimi i një hapësire gjithëpërfshirëse*

Në fazën e parë të zbatimit të projektit është futur në përdorim një faqe moderne në internet e Bashkisë. Një pjesë e konsiderueshme e faqes në internet u kushtohet informacioneve për aktivitetet e shoqatave minoritare, përfshirë informacione në gjuhët minoritare përkatëse (ukrainase, polake dhe rome). Krahas kësaj, faqja në internet është përkthyer në dy gjuhë minoritare të tjera shtesë (gjermane dhe italiane) në një gjuhë të huaj (angleze).

Në mbarë bashkinë janë vendosur 17 tabela topografike dygjuhëshe që tregojnë pika të rëndësishme kulturore dhe fetare të pakicave lokale (kisha, varreza, zyra publike). Ky aktivitet është plotësuar me një fletëpalosje të nxjerrë nga pushteti vendor, si edhe me një gamë materialesh promociionale (çanta, lapsa dhe logo të projektit).

Një pankartë që u uron mirëseardhjen vizitorëve të Bashkisë Gradishkë në gjuhët minoritare përkatëse është vendosur në anë të rrugës e cila, për shkak të pozitës strategjike të Gradishkës në pikën kufitare me më shumë aktivitete në Bosnjë dhe Hercegovinë, shihet nga më shumë se 1,5 milion udhëtarë që kalojnë transit çdo vit.

Projekti ka rritur kapacitetet e katër shoqatave minoritare nëpërmjet sigurimit të pajisjeve informatike bazë (6 kompjuterë, projektor), të një zyre të përbashkët për katër shoqata minoritare dhe nëpërmjet sigurimit të formimit për të ndihmuar bashkërendimin mes katër shoqatave minoritare dhe pushtetit vendor.

## **Metodika**

---

Për vlerësimin e praktikave më të mira, janë marrë në internistë disa palë interesi. Anëtarët e grupit të posaçëm të punës dhe përfaqësuesit e pakicave të synuara u intervistuan personalisht në Bashkinë Gradishkë. Vlerësimi mbështetet edhe në vizitën e kryer në Gradishkë në qershor 2016. Duke qenë se ky projekt përfshinte produkte të ndryshme, si tabela rrugore dhe pankarta dygjuhëshe, që e rëndësishme të shiheshin dhe të vlerësoheshin edhe këta komponentë.

Për këtë studim janë intervistuar katër persona, nga të cilët dy qenë zyrtarë bashkiakë dhe dy përfaqësues të shoqatave minoritare që qenë përfshirë në zbatimin e projektit. Nga katër personat e intervistuar tri qenë femra, njëri që mashkull.

## Vlerësimi i projektit

---

### Qëndrueshmëria në kohë

- ▶ Rritja e kapacitetit të shoqatave minoritare

Projekti i rriti me sukses kapacitetet njerëzore dhe teknike të katër shoqatave minoritare nëpërmjet sigurimit të pajisjeve informatike bazë (6 kompjuterë, projektor, tabelë me tabakë letre etj.) dhe dy aktivitete trajnuese të organizuara nga Këshilli i Evropës në Prijedor dhe Sarajevë. Në fazën e dytë të projektit, deri në muajin tetor 2016, objektivi i aktorëve bashkiakë është rritja e numrit të njësive kompjuterike deri në 20. Objektivi kryesor i këtij aktiviteti qe lehtësimi i një bashkërendimi më të mirë ndërmjet katër shoqatave dhe me pushtetin vendor. Krahas kësaj, shoqatave minoritare iu dha formim në teknologjitë informatike nga personeli bashkiak. Shoqatat po i përdorin pajisjet për të përkthyer dokumentet më kryesore të pushtetit vendor në gjuhët minoritare përkatëse dhe për të publikuar të rejat në lidhje me aktivitetet e tyre në faqen në internet të Bashkisë. Në fazën përfundimtare të zbatimit të projektit, shoqatave minoritare u janë dhënë një hapësirë zyre në një ndërtesë në pronësi të bashkisë, ku ndodhet edhe inkubatori i biznesit, shërbimet sociale bashkiake dhe një zyrë punësimi. Shpresohet se përmes bashkimit të forcave me promotorët e biznesit lokal dhe përmes sigurimit të njohurive teknike për hartimin e projekteve, ky projekt do ta ulë në periudhë afatmesme papunësinë e anëtarëve të komuniteteve minoritare.

- ▶ Rritja e dukshmërisë së larmisë gjuhësore

Projekti e ka rritur dukshmërinë e larmisë gjuhësore përmes integritet të tri gjuhëve minoritare (dhe tri gjuhëve të huaja nga bota) në faqen në internet të bashkisë. Krahas kësaj, pushteti vendor ka vendosur një pankartë në hyrje të bashkisë, ku u urohet mirëseardhja vizitorëve në gjuhën zyrtare dhe gjashtë gjuhë të tjera. Një rritje e dukshmërisë së tillë të larmisë gjuhësore është shumë në përputhje me interpretimin që i bën nenit 11, pika 3, të KMPK-së ACFC-ja. Në Shpjeguesin për të Drejtat Gjuhësore, ai nxit vendosjen e tabelave dygjuhëshe, duke qenë se ato përcjellin "mesazhin se në një territor të përbashkët jetohet në harmoni nga disa grupe popullore."<sup>225</sup>

- ▶ Rritja e njohurive për larminë kulturore

Projekti ia ka dalë mbanë të vendosë 17 tabela topografike turistike dhe fetare në gjuhët minoritare në të gjithë bashkinë. Vendet e shënuara janë përzgjedhur me kujdes, në bashkëpunim me shoqatat minoritare, për të siguruar që përfaqësojnë pika me rëndësi të veçantë për kulturën dhe fenë e komuniteteve minoritare lokale (varreza, kisha, pika historike etj.). Ky produkt është pasuar me mbulim të gjerësishtëm në media dhe me një gamë të gjerë aktiviteteve promociionale, duke bërë kështu që edhe popullsia në shumicë të njihej me kulturën dhe historinë e përbashkët me fqinjët që vijnë nga grupime etnike të tjera. Pra, ky aktivitet ka

---

<sup>225</sup> ACFC, "Të drejtat gjuhësore të personave që u përkasin pakicave kombëtare në bazë të Konventës Kuadër", miratuar më 5 korrik 2012, pika 67.

kontribuar në zbatimin e nenit 5 dhe 6 të KMPK-së, në kuptimin që mbështet ruajtjen dhe zhvillimin e kulturave dhe gjuhëve minoritare dhe kontribuon në mirëkuptimin reciprok dhe dialogun ndërkulturor.

### *Faktori udhëheqës*

Ekipi i zbatimit të projektit përbëhet nga Drejtoria për Zhvillim pranë Bashkisë Gradishkë dhe Zëvendëskryetarit të Bashkisë Gradishkë. Krahas kësaj, në ekipin e zbatimit të projektit është përfshirë një përfaqësues nga secila prej shoqatave minoritare të Gradishkës (nga shoqatat minoritare polake, rome, ukrainase dhe malazeze). Detyrat kryesore të përfaqësuesve të shoqatave minoritare përfshinin përkthimin e materialeve në gjuhët minoritare, të cilat janë hedhur në faqen bashkiake në internet, përzgjedhjen e pikave për tabelat topografike në gjuhët minoritare dhe këshillimin e ekipit zbatues për aktivitetet pasuese të projektit.

Palët e interesuara të intervistuar thonë se qëllimi, metoda e hartimit të projektit dhe detyrat e tij qenë të qarta për të gjithë personat e përfshirë në zbatimin e projektit. Gjatë zbatimit të projektit, ekipi zbatues është mbledhur katër herë në mjediset e Bashkisë për të diskutuar për masat përkatëse, ndërsa janë zhvilluar edhe takime të shumta dypalëshe ndërmjet aktorëve bashkiakë dhe përfaqësuesve të pakicave.

### *Elementet kryesore të përsëritshme*

- ▶ Faqja shumëgjuhëshe në internet e bashkisë dhe tabelat rrugore dygjuhëshe

Përdorimi i gjuhës është thelbësor për ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kombëtar, etnik dhe gjuhësor. Gjithashtu, përdorimi i gjuhëve minoritare në marrëdhëniet me autoritetet publike është një parim kushtetues në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, ku rregulloret kombëtare, rajonale dhe bashkiake përcaktojnë fushëveprimin territorial të zbatimit dhe autoritetet e prekura. Në këtë aspekt, vendosja e prezantimeve administrative shumëgjuhëshe në internet është një element i praktikës së mirë sepse nxit larminë gjuhësore, por edhe u jep mundësi komuniteteve minoritare t'ia prezantojnë aktivitetet e tyre komunitetit në shumicë.

Përdorimi i tabelave rrugore topografike dygjuhëshe zakonisht rezervohet për situatat ku ka dygjuhësi të administruar me ligj, ose kur ka një interes turistik ose tregtar, pra nëpër aeroporte, pikat e kalimit kufitar, pikat turistike, institucionet ndërkombëtare etj. Por, siç mund të shihet në Bashkinë Gradishkë, më shumë përdorim joformal i tabelave dygjuhëshe gjendet në zonat ku ka banuar tradicionalisht një popullsi minoritare dhe ku tabelat e dhura shënojnë pikat historike, kulturore dhe fetare të një popullsise të tillë. Në këtë kontekst, dygjuhësia sinjalizon gatishmërinë e shprehur nga administrata vendore për t'u shërbyer të gjithë shtetasve njësoj. Këto produkte mund të përsëriten në të gjitha njësive administrative vendore me popullatë të larmishme.

- ▶ Bashkëpunimi institucional me përfaqësuesit dhe shoqatat e pakicave

Shoqatat minoritare lokale qenë të angazhuara, jo vetëm për zbatimin, por edhe për planifikimin e aktiviteteve në kuadër të këtij projekti. Gjithashtu, angazhimi i shoqatave minoritare ndihmoi në komunikimin ndërmjet komunitetit jo në shumicë dhe Bashkisë, duke qenë se organizatat minoritare kanë komunikim të rregullt dhe më pak formal me komunitetet minoritare përkatëse.

#### **Përfitimet:**

1. Rritja e dukshmërisë së shoqatave ekzistuese të pakicave kombëtare në Bashkinë Gradishkë.
2. Rritja e ndërgjegjësimit për ekzistencën dhe aktivitetet e pakicave kombëtare në Bashkinë Gradishkë.
3. Përmirësimi i larmisë gjuhësore.
4. Rritja e larmisë kulturore.

## **Përfundime dhe rekomandime**

---

Ky projekt ia ka dalë mbanë t'i çojë përpara kapacitetet e katër organizatave minoritare që janë aktive në Bashkinë Gradishkë, duke u siguruar pajisje informatike dhe njohuri teknike për hartimin e projekteve. Gjithashtu, ai e ka rritur dukshmërinë dhe njohuritë për larminë gjuhësore dhe kulturore përmes futjes në përdorim të një platforme bashkiake shumëgjuhëshe në internet dhe përmes vendosjes së një pankarte shumëgjuhëshe dhe 19 tabelave topografike në gjuhët minoritare. Të gjitha produktet e përmendura shërbejnë si tregues të fortë të qëndrueshmërisë afatgjate në kohë të projektit. Në fund, prania e fuqishme e pakicave të synuara të projektit në të gjitha fazat, me përjashtim të fazës fillestare, të zbatimit të projektit dhe roli i përkushtuar i aktorëve bashkiakë ka siguruar një faktor udhëheqës lokal të fuqishëm mbi projektin, çka ka ndikuar pozitivisht në ecurinë e përgjithshme.

Për të siguruar qëndrueshmërinë në kohë dhe suksesin e vazhdueshëm të projekteve të ngjashme në të ardhmen, jepen rekomandimet e mëposhtme:

- ▶ **Përfshirja e komunitetit minoritar lokal që prej fazës fillestare të projektit.** Për të shmangur dallimet e konsiderueshme mes prioriteteve të vendosura nëpërmjet aktiviteteve të projektit ndërmjet pakicave dhe aktorëve bashkiakë është e nevojshme të përfshihen fuqimisht përfaqësuesit e komuniteteve minoritare përkatëse brenda ekipit të projektit që në fillim të tij. Duke qenë se rezultati i projektit varet shumë nga mënyra e hartimit të tij, është me rëndësi thelbësore të krijohen grupe të posaçme me palët e interesit që në fazën fillestare të përgatitjes së projektit. Sikurse shihet në rastin e Gradishkës, një problem tjetër është niveli përgjithësisht i ulët i organizimit të grupeve minoritare në

bashki. Në këto raste, thelbësore është që aktorët bashkiakë t'i dalin përpara këtij problemi duke i fuqizuar organizatat minoritare.

- ▶ **Kapaciteti financiar.** Pavarësisht nga vullneti i fortë për ta përmirësuar integrimin e pakicave kombëtare të demonstruar nga ana e Bashkisë Gradishkë, detyrat komplekse dhe të gjithanshme të ndërmarra për promovimin e të drejtave të pakicave nuk do të mund të ishin arritur pa kontributin financiar të BE-së dhe Këshillit të Evropës. Kur vëren trendin e përgjithshëm të amullisë apo ndonjëherë edhe të pakësimit faktik të mjeteve financiare të caktuara për promovimin e aktiviteteve kulturore dhe aktiviteteve të tjera të pakicave në vendet e Ballkanit Perëndimor, e përkeqësuar më tej nga kriza ekzistuese financiare, mund të arrihet në përfundimin se kufizimet financiare e bëjnë më të vështirë modernizimin e aktiviteteve kulturore dhe institucioneve minoritare. Prandaj, është e rëndësishme të sigurohet një kapacitet financiar i qëndrueshëm në kohë i bashkive jo homogjene në nivel kombëtar, për të siguruar që uljet e buxheteve të mos prekin në mënyrë jo proporcionale pakicat kombëtare.
- ▶ **Transferimi i disa kompetencave nga niveli qendror te ai vendor.** Disa prej kompetencave që synojnë përmirësimin e pozitive të pakicave janë kompetenca ekskluzive e pushtetit qendror. Në rastin e Gradishkës, ka qenë e vështirë të sigurohej leja e nevojshme nga autoritetet përkatëse në nivel shteti dhe entiteti, për vendosjen e tabelave rrugore në gjuhë minoritare. Prandaj do të ishte me vlerë bërja e një interpretimi më elastik të kompetencave për tabelat rrugore nëse këto nuk kanë të bëjnë me trafikun por kanë për qëllim promovimin e të drejtave të pakicave.



## Bashkia Gradishkë



# Vlerësimi i praktikave më të mira në Kroaci

---

Fuqizimi i administratës për minoritarët çon në barazi

**Pula**

*Tema: Gjuha*

*Pakicat e prekura: Italiane*

## Hyrje

---

*Konteksti vendor: pakicat dhe bashkësia e tyre*

**K**ushtetuta e Republikës së Kroacisë garanton mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe rendit 22 pakica tradicionale që jetojnë në vend (shih, më lart, Tabelën 1). Gjithashtu, të drejtat e pakicave mbrohen me Aktin kushtetues për të drejtat e pakicave kombëtare në Republikën e Kroacisë dhe dy ligje të posaçme që garantojnë arsim në gjuhët minoritare dhe të drejta specifike për përdorimin e gjuhëve minoritare në jetën publike, që janë Ligji për përdorimin e gjuhëve dhe alfabetëve të pakicave kombëtare dhe Ligji për arsimin në gjuhën dhe alfabetin e pakicave kombëtare. Në fund, në nivel rajonal dhe vendor, Akti Kushtetues për të drejtat e pakicave kombëtare parashikon që njësitë vendore ku anëtarët e pakicave përbëjnë 5 deri në 15% kanë të drejtën të kenë një përfaqësues në këshillin vendor. Nëse një pakicë është më shumë se 15% e popullatës vendore ose më shumë se 5% e popullatës në nivel qarku, ajo ka të drejtën për përfaqësim proporcional në këshillat vendorë dhe rajonalë.

Kroacia banohet më së shumti nga banorë të etnisë kroate të cilët, sipas regjistrimit më të fundit të popullsisë në vitin 2011, përbëjnë 90,42% të popullsisë. Grupet minoritare më të mëdha janë serbët (4,36%), boshnjakët (0,73%), hungarezët (0,33%), italianët (0,42%), shqiptarët (0,41%) dhe romët (0,40%). Përqendrimi territorial i etnive është tejet i dukshëm në Kroaci, ku pakicat banojnë në rajonet që kufizohen me shtetet mëmë. Italianët banojnë më së shumti në rajonin e Istrias ku përbëjnë 6,03% të popullsisë së qarkut. Në pesë qarqet në kufi me Serbinë dhe Bosnjën dhe Hercegovinën, serbët përbëjnë më shumë se 10% të popullsisë.

Shkallët më të mëdha të largësisë etnike shprehen në lidhje me serbët etnikë, pasuar nga romët dhe boshnjakët. Sipas organizatës "Human Rights Watch", serbët dhe romët vijnë të përballen me diskriminim, ku romët përballen me vështirësi të veçanta sa i takon marrjes së shërbimeve bazë shtetërore si kujdesi shëndetësor, asistencë sociale ose arsim. Me përjashtim të Istrias, shumica e problemeve me të cilat përballen pakicat kanë të bëjnë me varfëri dhe zhvillim të ulët ekonomik të rajoneve ku janë të përqendruara.

Sipas censit të vitit 2011, qyteti i Pulës ka 57.460 banorë, nga të cilët shumica e shtetasve janë kroatë, që përbëjnë 70,14% të popullsisë. Pakicat më të mëdha etnike janë: 3.454 serbë (6,01%), 2.545 italianë (4,43%), 2.011 boshnjakë (3,5%) dhe 549 sllovenë (0,96%).

### *Projekti: përgjigjja ndaj nevojave vendore*

Nisur nga fakti se anëtarët e pakicës italiane në qytetin e Pulës nuk e përdorin të drejtën që u jep Akti Kushtetues për të drejtat e pakicave kombëtare në Republikën e Kroacisë për të përdorur gjuhën amtare në jetën publike, projekti "Fuqizimi i administratës për minoritarët çon në barazi" synonte fuqizimin e politikës dhe kapacitetit për zbatimin e përdorimit zyrtar të barabartë të gjuhës italiane në praktikë në kontekstin lokal.

Gjatë zbatimit të projektit, dokumente dhe formularë përkatës bashkiakë janë përkthyer në italisht dhe janë afishuar në faqen në internet të pushtetit vendor, janë vendosur tabela treguese dygjuhëshe brenda ndërtesës së administratës bashkiake dhe në rrugë, është krijuar hartë 360 gradë në Google për objektet e Bashkisë Pulë në tri gjuhë (kroatisht, italisht dhe anglisht), ndërsa punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore kanë marrë pjesë në një kurs të gjuhës italiane.

Personat e intervistuar për këtë studim e lëvduan projektin e zbatuar, si një projekt të rëndësishëm për përmirësimin e pakicës kombëtare italiane në Pulë. Gjithashtu, anëtarët e pakicës jo italiane i kanë parë përfitimet e projektit, megjë një prej rezultateve të tërthorta të projektit është rritja e bashkëpunimit të komuniteteve minoritare në qytetin e Pulës.

Raporti i parë për vendin i realizuar në kuadër të Projektit të Përbashkët të BE/KiE "Nxitja e të drejtave të njeriut dhe e mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore" shprehte shqetësim në lidhje me riskun e mundshëm të mospërfshirjes së organizatave të pakicës së synuar ose të personave të veçantë minoritarë në zbatimin e projektit. Ky shqetësim është trajtuar përmes aktiviteteve të punës afruese të gjithanshme të realizuara nga aktorët e qytetit të Pulës me synim informimin e komunitetit minoritar dhe jo minoritar se si të përdorin më mirë instrumentet ekzistuese për ushtrimin e të drejtave për përdorim zyrtar të gjuhës italiane në kontekstin lokal.

Pavarësisht nga fakti që, sipas regjistrimit më të fundit të popullsisë, serbët janë pakica më e madhe që jeton në Pulë, ky projekt është marrë më së shumti me promovimin e gjuhës italiane për shkak të faktit se italishtja është gjuha e dytë zyrtare në Qarkun Istria. Ky qark është i vetmi qark zyrtarisht dygjuhësh në Kroaci.

## *Aktivitetet: krijimi i një hapësire gjithëpërfshirëse*

Gjatë zbatimit të projektit, palët e interesi të zbatimit të projektit kanë përkthyer në italisht 118 dokumente dhe formularë të përdorur për qëllime zyrtare. Krahas kësaj, janë vendosur pllakate dhe etiketa dygjuhëshe në shtatë organe të vetëqeverisjes vendore dhe 39 tabela rrugore dhe 1 tabelë dygjuhëshe. Në fund, aktorët e pushtetit vendor kanë prezantuar një hartë me fotografi 360 të rrugëve në Google në tri gjuhë, për objektet e qytetit të Pulës. Aktivitetet e përmendura janë të lidhura drejtpërdrejt me nenin 10 të KEGJRM-së që siguron përdorimin e gjuhëve minoritare në kuadër të autoritetit rajonal ose vendor dhe që ndihmon dhe nxit përdorimin e gjuhëve minoritare me mjete të tjera, dhe nenet 10 dhe 11 të KMPK-së.

Për të rritur arritshmërinë e shërbimeve të Bashkisë për anëtarët e pakicës kombëtare italiane, Bashkia Pulë u ka ofruar punonjësve të saj një kurs të gjuhës italiane. Pjesëmarrës në kursin e gjuhës janë përzgjedhur ata që treguan interes, por edhe ata të cilët në punën e tyre të përditshme janë në kontakt të drejtpërdrejtë me anëtarë të komunitetit minoritar italian. Në fund të projektit, kursin e gjuhës, prej 70 orësh, e përfunduan me sukses 24 nëpunës publikë. Prej tyre, 10 arritën nivelin A2, 7 arritën nivelin B1 dhe 7 arritën nivelin B2. Në bazë të intervistave me palët e interesit, reagimi i punonjësve lidhur me mundësinë për të mësuar gjuhën italiane qe tejet pozitiv, ndërsa vetëqeverisja vendore ka marrë madje një shprehje të përsëritur të interesit për kurse të një niveli më të avancuar.

Një pjesë integrale e projektit përfshinte takime me përfaqësues të të nëntë grupeve minoritare lokale. Aktivitetet më të rëndësishme qenë një seminar pune, një konferencë dhe grup diskutimi me të rinjtë për të drejtat e personave që i përkasin pakicës kombëtare italiane për të përdorur zyrtarisht gjuhën dhe alfabetin e tyre. Në aktivitete morën pjesë më shumë se njëqind palë përkatëse të interesit, përfaqësues bashkiakë dhe punonjës të projektit.

Në fund, aktorët bashkiakë kanë organizuar aktivitete të shumta promovimi me synim rritjen e dukshmërisë të aktiviteteve të realizuara nga projekti. Ndër këto përfshihet botimi i fletëpalosjeve të posaçme për të drejtën e përdorimit të gjuhës minoritare në proceset përpara organeve administrative të qytetit të Pulës, fletushka promocionale dhe pjesëmarrja në aktivitete publike si festimi i Javës së Evropës, Dita e Pakicave Kombëtare, festivali i filmit i Pulës etj.

## **Metodika**

---

Për këtë studim janë intervistuar katër persona, nga të cilët tre zyrtarë bashkiakë dhe një përfaqësues i këshillit të pakicave kombëtare. Përfaqësuesi i këshillit nuk është përfshirë drejtpërdrejt në zbatimin e projektit. Nga katër personat e intervistuar dy qenë femra, dy meshkuj. Anëtarët e grupit të posaçëm të punës dhe përfaqësuesit e pakicave të synuara u intervistuan personalisht në Bashkinë Pulë në korrik 2016.

## Vlerësimi i projektit

---

### *Qëndrueshmëria në kohë*

- ▶ Rritja e dukshmërisë së larmisë gjuhësore

Vendosja e pllakateve dhe etiketave dygjuhëshe në zyra dhe vendosja e tabelave, në periudhën afatgjatë do ta rrisë pranimin dhe konotacionin pozitiv të larmisë gjuhësore në qytetin e Pulës. Këto veprime e kanë potencialin për ta rritur përdorimin e gjuhës italiane në sferën publike.

- ▶ Përmirësimi i dispozitave ligjore dhe rritja e përdorimit zyrtar të gjuhëve minoritare

Përdorimi i italishtes në sferën publike është penguar deri tani nga një numër i pamjaftueshëm nëpunësish civilë që komunikojnë me gojë dhe me shkrim në italisht, si edhe nga mungesa e formularëve dygjuhësh të nevojshëm për komunikimin me shkrim me autoritetet publike. Ky projekt i ka përmirësuar mundësitë për personat që i përkasin pakicës italiane për ta përdorur gjuhën e saj, përmes rritjes së zotësisë gjuhësore të punonjësve të Bashkisë së Pulës duke siguruar formim gjuhësor për 24 nëpunës publikë dhe përmes përkthimit dhe publikimit të dokumenteve publike dhe formularëve që përdoren për qëllime zyrtare në gjuhët kroate dhe italiane. Me këto veprime, projekti ka të ngjarë që të arrijë ta rrisë përdorimin zyrtar të gjuhës italiane në administratën publike të qytetit të Pulës, si në komunikimin me përfaqësues të komuniteteve minoritare, ashtu edhe në ndërveprimin reciprok të autoriteteve vendore.

- ▶ Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet organizatave të ndryshme minoritare

Pavarësisht nga fakti se përdoruesit kryesorë të këtij projekti qenë vetëm anëtarët e pakicës kombëtare italiane, aktivitetet e organizuara në kuadër të zbatimit të projektit, dhe sidomos konferenca dhe një grup diskutimi, kanë çuar në rritje të bashkëpunimit ndërmjet dhjetë organizatave minoritare të pranishme në qytetin e Pulës. Në këtë aspekt, vlen të thuhet se seminari i zhvilluar në mes të projektit u propozua një aleancë e këshillave minoritare të qytetit të Pulës. Me këtë synohej të arrihej përmirësimi i mëtejshëm i mbrojtjes së të drejtave të pakicave të tjera kombëtare në Pulë që nuk përfitojnë drejtpërdrejt nga ky projekt.

### *Faktori udhëheqës*

Ekipi i zbatimit të projektit konsistonte në anëtarë të projektit nga Drejtoria e Politikave Evropiane, Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Informimit e Këshillit Bashkiak të Pulës, Drejtoria e Punës e Këshillit Bashkiak të Pulës dhe Zyra e Bashkisë Pulë. Krahas kësaj, Zëvendëskryetari i Bashkisë Pulë jepte mbështetjen e nevojshme politike për zbatimin e projektit. Palët e interesuara të intervistuar thonë se qëllimi, metoda e hartimit të projektit dhe detyrat e tij qenë të qarta për të gjithë personat e përfshirë në zbatimin e projektit. Ekipi zbatuar ka bashkëpunuar nga afër me organet e tjera të administratës vendore, sidomos në lidhje me përzgjedhjen e pjesëmarrësve në kursin e gjuhës italiane. Megjithatë bashkëpunimi me organizatat dhe personat minoritarë përkatës fillimisht mungonte, situata ka ndryshuar andej

nga fundi i projektit kur në aktivitet e projektit u përfshinë të gjitha organizatat minoritare që ushtrojnë aktivitet në qytetin e Pulës.

### *Elementet kryesore të përsëritshme*

- ▶ Nxitja e larmisë gjuhësore përmes kurseve të gjuhës, përkthimit dhe publikimit të dokumenteve dhe formularëve dygjuhësh të nevojshëm për komunikimet me shkrim me autoritetet publike dhe përdorimit të toponimisë dygjuhëshe

Nxitja e larmisë gjuhësore rrit drejtpërdrejt mundësitë e pakicave të synuara për ta përdorur gjuhën amtare në sferën publike. Këto aktivitete janë sidomos të përsëritshme në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku banojnë pakica gjuha amtare e të cilave është tjetër ajo e shumicës së popullsisë lokale. Gjithashtu, kjo lidhet drejtpërdrejt me nenet 10 dhe 15 të KMPK-së në kuptimin që çdo persona që u përket pakicave kombëtare ka të drejtën për ta përdorur lirisht dhe pa ndërhyrje gjuhën e vet minoritare, në jetën private dhe atë publike, me gojë dhe me shkrim dhe se palët nënshkruese do të krijojnë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen e efektshme të personave që u përkasin pakicave kombëtare në jetën publike. Gjithashtu, ky element ndër lidhet me nenin 8 dhe nenin 10 të Kartës, për aq sa nxit ofrimin e kurseve të arsimit të vazhdueshëm për të rritur në gjuhët minoritare, meqë subjektet e formimit do të sigurojnë përdorimin e gjuhës minoritare në kuadër të autoritetit vendor.

- ▶ Anketë e opinionit publik

Përpara vendosjes eksperimentale të tabelave dygjuhëshe, aktorët bashkiakë të Pulës realizuan një anketë të opinionit publik për vendosjen e tabelave dygjuhëshe, duke e pasuar me dy analiza që shihnin parametrat e ndryshëm sasiorë dhe cilësorë. Përmes përfshirjes së një numri më të madh qytetarësh në vendimmarrjen për vendosjen e tabelave dygjuhëshe në kontekstin lokal, vetëqeverisja vendore u kujdes që kjo mënyrë e nxitjes së dygjuhësisë të mos shihej si imponuese, duke parandaluar kështu kundërshtimin e mundshëm popullor dhe/ose aktet e vandalizmit në drejtim të tabelave dygjuhëshe në të ardhmen. Por, anketat e opinionit publik përfshijnë riskun e kundërshtimit nga shumica e qytetarëve të masave të diskriminimit pozitiv në lidhje me nxitjen e gjuhëve minoritare. Risqe të tilla duhen marrë në konsideratë sa herë bëhen konsultime me publikun dhe, nëse është e nevojshme, ato duhen parandaluar përmes një fushate informative afruese.

#### **Përfitimet:**

1. Rritja e arritshmërisë së shërbimeve të Bashkisë për anëtarët e pakicës kombëtare italiane.
2. Përmirësimi i larmisë gjuhësore në qytetin e Pulës.
3. Përmirësimi i kapacitetit të administratës publike në qytetin e Pulës.
4. Rritja e bashkëpunimit ndërmjet organizatave të ndryshme minoritare.

## Përfundime dhe rekomandime

---

Ky projekti e ka përmirësuar larminë gjuhësore në qytetin e Pulës përmes përmirësimit të kushteve për pakicat e synuara për ta përdorur gjuhën amtare në komunikimin me gojë dhe me shkrim me autoritetet publike vendore. Projekti ka edhe vlerën e shtuar në lidhje me rritjen e bashkëpunimit të organizatave të ndryshme minoritare. Siç thuhet edhe më lart, projekti ka një potencial të fortë sa i takon zbatimin në njësitë e tjera të administratës vendore. Për të siguruar qëndrueshmërinë në kohë dhe suksesin e vazhdueshëm të projekteve të ngjashme në të ardhmen, jepen rekomandimet e mëposhtme:

- ▶ **Të rritet ndërgjegjësimi i grupit të synuar në lidhje me të drejtat e pakicave** Intervistat e kryera në kuadër të vlerësimit të projektit dhe të përgatitjes së manualit për praktikantët më të mira kanë treguar se anëtarët e komuniteteve minoritare kanë njohuri të kufizuara për të drejtën ndërkombëtare, legjislacionin e brendshëm, politikën dhe strategjitë për nxitjen e të drejtave të tyre. Gjithashtu, pavarësisht nga mungesa e shifrave të prekshme, nga intervistat mund të arrihet në përfundimin se numri i qytetarëve që e përdorin gjuhën amtare në komunikimin e administratën publike vendore nuk është rritur. Për ta maksimizuar efektin e punës së bërë për përmirësimin e kushteve për përdorimin e gjuhët minoritare në marrëdhëniet me autoritetet vendore, një komponent tjetër shtesë i projektit do të duhej të merrte në konsideratë aktivitete të punës afruese me publikun me synim ndërgjegjësimin e pakicave dhe të shumicës për të drejtat e pakicave.
- ▶ **Të sigurohet mbështetja e popullsisë në shumicë.** Zbatimi i masave të diskriminimit pozitiv që nxisin larminë gjuhësore, siç është vendosja e tabelave rrugore dygjuhëshe, varet shumë nga mbështetja lokale e popullsisë në shumicë lidhur me masa të tilla dhe nga vullneti politik i përfaqësuesve të zgjedhur. Në këtë aspekt, është e nevojshme të sigurohet mbështetje më e gjerë për masa të tilla nga shumica e popullsisë. Kjo mund të bëhet përmes aktiviteteve të punës afruese, si debatet publike, aktivitetet në media, fletëpalosjet, fletushkat apo madje edhe fushatat derë më derë, sidomos në njësitë e vogla të vetëqeverisjes.
- ▶ **Të vendoset njohuria e gjuhës si kërkesë punësimi.** Për të siguruar përdorimin e gjuhës minoritare në sferën publike në ato njësi të vetëqeverisjes vendore ku janë në përdorim zyrtar dy ose më shumë gjuhë, paralelisht me ofrimin e kursit të formimit në gjuhët minoritare, rekomandohet vendosja e një kërkesë gjuhësore për postet në administratën publike. Kjo kërkesë mund të përshtatej më tej për të pasqyruar nivelin e ndërveprimit me publikun.



Pula



# Vlerësimi i praktikave më të mira në Malin e Zi

---

Ndërmjetësit dhe asistentët arsimorë romë dhe egjiptianë

**Bashkia Tivat**

*Tema Arsimi*

*Pakicat e prekura: romët dhe egjiptianët*

## Hyrje

---

*Konteksti vendor: pakicat dhe bashkësia e tyre*

**M**ali i Zi ka më shumë se nëntë komunitete që jetojnë në territorin e tij, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, dhe këto komunitete në përgjithësi janë objekt diskriminimi. Megjithëse shteti organizon trajnime kundër diskriminimit për sektorin e shërbimit civil publik, përpjekjet për ta luftuar diskriminimin mbeten modeste.<sup>226</sup> Komunitetet shqiptare dhe boshnjake vijojnë të jenë të nënpërfaqësuar në administratën publike,<sup>227</sup> ndërsa komunitetet rome dhe egjiptiane përballen me vështirësi në punësim.

Ka raportime për dhunë në shoqëri, sidomos kundër komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane.<sup>228</sup> Këto komunitete që jetojnë në Malin e Zi përballen me shumë çështje, ndërkohë që disa kanë jetuar në territorin e Malit të Zi prej një kohe më të gjatë, të tjera janë refugjatë nga Kosova\*, statusi ligjor i të cilëve ende nuk është zgjidhur nga shteti. Sikurse edhe në vendet e tjera të rajonit, në Malin e Zi komunitetet rome dhe egjiptiane kanë vështirësi sa i takon marrjes së arsimit, kujdesit shëndetësor dhe punësimit dhe nuk kanë përfaqësim politik. Krahas kësaj, ata shpesh jetojnë në kushte shumë të këqija dhe në lagje pa infrastrukturë. Gratë e këtyre komuniteteve janë sidomos të cenueshme duke qenë se martohen në moshë të vogël, çka e pengon arsimin e tyre dhe ua rrezikon shëndetin për shkak të lindjes së fëmijëve në moshë të vogël. Megjithëse arsimi fillor në Malin e Zi është falas, dhe arsimi i mesëm është falas por jo i detyrueshëm, në përgjithësi përqindja e frekuentimit të shkollës nga komunitetet rome dhe egjiptiane është e ulët, përkatësisht në 51% dhe 54%.

---

226 Raportet e Departamentit të Shtetit të SHBA-së për të drejtat e njeriut në 2015, Raporti për Malin e Zi.

227 Adresari i grupeve të të drejtave të pakicave, Mali i Zi.

228 Raportet e Departamentit të Shtetit të SHBA-së për të drejtat e njeriut në 2015, Raporti për Malin e Zi.

Në Bashkinë Tivat, egjiptianët përbëjnë komunitetin e katërt më të madh, pas malazezëve, serbëve dhe kroatëve, me 335 banorë, ndërkohë që ka edhe 35 banorë romë. 1275 nuk kanë dashur ta deklarojnë përkatësinë etnike, ndërsa komunitetet e tjera përfshijnë, ndër të tjerë, shqiptarët, boshnjakët myslimanët dhe jugosllavët.<sup>229</sup> Duhet theksuar se komunitetet rome në përgjithësi janë numëruar më pak në regjistrimi e popullsisë.

Komunitetet rome dhe egjiptiane në Tivat flasin gjuhët shqipe dhe rome, dhe kanë vështirësi ta mësojnë gjuhën malazeze, gjuhë e cila përdoret si gjuhë mësimi në shkolla, duke qenë se fëmijët që u përkasin këtyre komuniteteve rrallë shkojnë në kopsht. Për pasojë, ata e kanë të vështirë ta marrin provimin e pranimit, që është kërkesë për të gjithë nxënësit që fillojnë klasën e parë. Krahas kësaj, ata kanë probleme me marrjen e provimit që u jep mundësi të kalojnë në vitin tjetër, i cili është provim që duhet ta bëjnë nxënësit me nota të dobëta. Nxënësit që nuk e kalojnë këtë provim duhet të përsëritin vitin, ndërsa nxënësit që nuk e kalojnë provimin e pranimit kthehen në kopsht. Edhe nëse nxënësit e kalojnë provimin e pranimit ata e kanë të vështirë të ndjekin mësimet dhe ta kryejnë shkollën me sukses. Në një rast, që shërben si tregues i diskriminimit me të cilin përballen nxënësit romë dhe egjiptianë në Tivat përpara fillimit të projektit, mësuesit kishin kthyer në shtëpi gjashtë nxënës romë dhe egjiptianë “për arsye higjienike”.<sup>230</sup> Një trajtim diskriminues si ky mund të çojë në braktisje të hershme të shkollës. Krahas kësaj, barrierat gjuhësore përbën një pengesë shtesë për përparimin e nxënësve në shkollë, si edhe për bërjen përpara në punësim.

### *Projekti: përgjigjja ndaj nevojave vendore*

Projekti “Ndërmjetësit dhe asistentët arsimorë romë dhe egjiptianë” ka trajtuar çështjen e arsimit të komuniteteve rome dhe egjiptiane që jetojnë në Tivat. Projekti kishte në objektiv synimin për t’i ndihmuar nxënësit të kalonin provimet e pranimit që janë të detyrueshme për t’u regjistruar në shkollë dhe provimet përfundimtare që janë të detyrueshme për nxënësit me nota më të ulëta se mesatarja. Krahas kësaj, projekti punoi me fëmijët e regjistruar që u përkisnin komuniteteve rome dhe egjiptiane për t’i integruar më mirë në mjedisin e shkollës dhe për ta ulur numrin e nxënësve që e braktisin shkollën.

Për t’i dhënë zgjidhje shkollës së lartë të braktisjes së shkollës dhe për ta rritur mbështetjen për nxënësit minoritarë në mënyrë që t’u bëjnë ballë sfidave brenda sistemit arsimor, projekti krijoi një pikë informacioni (Info Spot) e cila do të shërbente për të monitoruar frekuentimin, për të ofruar orë mësimi shtesë, për seminare pune dhe për të mbështetur nxënësit dhe mësuesit. Info Spot, një zyrë brenda shkollës, përbëhej nga një ndërmjetës dhe një asistent arsimor, të cilët kanë punuar vazhdimisht për t’i mbikëqyrur dhe mbajtur në patronazh nxënësit. Kjo zyrë, jo vetëm që e fuqizoi rolin e asistentit arsimor dhe të ndërmjetësuesit brenda shkollës përmes dhënies së një shembulli të qartë pozitiv, por edhe vendosi një kanal të rëndësishëm komunikimi ndërmjet shkollës dhe prindërve, të cilët shpesh kanë probleme me gjuhën malazeze. Të gjitha palët e interesit të

229 Zyra Statistikore e Malit të Zi, të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë 2011, <http://www.monstat.org/eng/page.php?id=394&pageid=57>.

230 “Nxitja e të drejtave të njeriut dhe e mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore”: Raport i dytë për vlerësimin e ndërgjegjësimit, f. 227–228.

lidhura me përmirësimin e arsimit të fëmijëve u përfshinë për ta shndërruar në sukses këtë projekt: prindërit, shkolla dhe institucionet bashkiake përkatëse. Krahas kësaj, mënyra me të cilën projekti përcaktoi rolin e asistentit arsimor dhe kushtet në të cilat punonte mund të shërbejë si një praktikë e mirë për ta përmirësuar rolin e asistentëve arsimorë në Malin e Zi. Sikurse thuhet në Hyrjen e këtij studimit<sup>231</sup>, sipas vlerësimit të ACFC-së asistentët arsimorë romë në Malin e Zi shpesh punojnë në kushte të brishta, me një status ligjor të papërcaktuar.

Ajo që është më e rëndësishmja, projekti krijoi një hapësirë të mbrojtur për fëmijët e komuniteteve romë dhe egjiptiane. Prindërit e intervistuar kanë vërejtur se projekti, jo vetëm që siguroi një mbështetje të fortë morale, por ata vunë re edhe një përmirësim të madh në sjelljen e fëmijëve të tyre dhe në rezultatet shkollore. Krahas kësaj, ata kanë vërejtur se zyra dhe punonjësit e saj kanë shërbyer për të ofruar kurset shtesë aq shumë të nevojshme për t'ua dalë mbanë, si edhe se është ushqyer kreativiteti i fëmijëve, suke qenë se projekti përfshinte aktivitete të ndryshme, përfshirë artet dhe punën e dorës. Një prind vërejtë se edhe ata e kanë vizituar shpesh Info Spot-in, sepse u është dukur si një zyrë që i mirëpriste për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të tyre dhe për t'u kujdesur për fëmijët e tyre në shkollë.

Rritja e nivelit të besimit ndërmjet ndërmjetësuesit dhe asistentit arsimor, shkollës dhe prindërve i ka dhënë mundësi projektit t'u japë përgjigje edhe sfidave të tjera të komunitetit, si martesa në moshë të hershme dhe transporti publik. Ekipi i projektit shpesh u përgjigjur nevojave të komunitetit, për shembull u ndërtua një rrugë me ndihmën e bashkisë, për të mundësuar transport më të mirë për fëmijët e komuniteteve romë dhe egjiptiane, meqë lagjja e tyre arrihej me vështirësi nga automjetet. Janë marrë të gjitha masat me qëllimin kryesor rritjen e mundësive për arsimim dhe rritjen e cilësisë së arsimit.

Megjithëse ishte parashikuar fillimisht që Bashkia Tivat kishte kushte më pak të favorshme për zbatimin e projektit<sup>232</sup>, meqë sukcesi i projektit varej nga shkolla lokale për zbatimin e tij, që do të thotë se nëse shkolla nuk kishte gatishmëri të merrte pjesë do të rrezikohej projekti, kjo vështirësi u kapërcye me t'u konfirmuar nga Ministria e Arsimit baza ligjore për Info Spot-in. Gjithashtu, kushtet e pafavorshme u kapërcyen për shkak të faktit se ekipi i projektit, ku përfshiheshin zyrtarë bashkiakë si edhe ndërmjetësuesi dhe asistenti arsimor, të cilët u përkisnin komuniteteve minoritare, qe shumë këmbëngulës dhe i motivuar për të punuar për projektin, çka u vu re që në fillim të projektit<sup>233</sup>. Është bashkëpunimi i ngushtë i të gjithë personave të përfshirë në projekt, zyrtarëve bashkiakë, shkollës dhe përfaqësuesve të komuniteteve, ai që mundësoi zbatimin me sukses të këtij projekti.

### *Aktivitetet: krijimi i një hapësire gjithëpërfshirëse*

Aktivitetet e projektit synonin rritjen e numrit të nxënësve romë dhe egjiptianë në shkollat lokale, si edhe përmirësimin e rezultateve arsimore të tyre, dhe kishin në objektiv të tyre probleme që e pengonin frekuentimin e shkollës. Rezultati

231 Shih "Hyrje", f. 14.

232 "Nxitja e të drejtave të njeriut dhe e mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore": Raport i dytë për vlerësimin e ndërgjegjësimit, f. 229.

233 "Nxitja e të drejtave të njeriut dhe e mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore": Vlerësimi i parë për vendin, f. 67.

kryesor i projektit ishte qendra Info Spot, një zyrë pranë shkollës lokale “Drago Milovic”. Info Spot është vizituar 800 herë nga nxënës, prindër, mësues, drejtoi i shkollës dhe shërbimet arsimore gjatë zbatimit të projektit. Nëpërmjet Info Spot-it janë organizuar orë mësimi dhe takime pune shtesë me fëmijët. Më konkretisht, ka pasur 69 orë mësimi për nxënësit parashkollorë, për t’i përgatitur për provimin e pranimit, dhe dy herë në javë janë organizuar orë mësimi shtesë me fëmijët më të mëdhenj në moshë, për t’i ndihmuar për vështirësitë që hasnin në klasë. E rëndësishme që se nxënësve iu siguruan mësimet të gjuhëve malazeze dhe angleze, ku kjo e fundit ishte vullnetare dhe nuk ishte parashikuar fillimisht nga projekti. Nxënësit janë nxjerrë nëpër ekskursionet dhe nëpër koncerte të ndryshme të shkollës dhe në një ekspozitë me foto, çka ndihmoi më tej me integrimin e tyre në shkollë dhe i ndihmoi të bënin miqësi me nxënësit e komunitetit jo minoritar.

Projekti zhvilloi edhe 16 seminare pune me prindërit për t’i ndërgjegjësuar për çështjet e higjienës, martesave në moshë të vogël, rëndësisë së arsimit dhe parandalimit të dhunës mes moshatarëve.

U hartua një bazë të dhënash për nxënësit romë dhe egjiptianë në Bashkinë Tivat, e cila u përditësua gjatë periudhës së projektit. Baza e të dhënave është përdorur për të dokumentuar numrin e nxënësve që frekuentojnë shkollën, pjesëmarrjen e tyre dhe për të ndjekur numrin e nxënësve që nuk frekuentojnë shkollën dhe të nxënësve të ardhshëm që duhet të regjistrohen.

## Metodika

---

Për vlerësimin e praktikave më të mira, janë marrë në intervistë trembëdhjetë persona. Anëtarët e grupit të posaçëm të punës dhe anëtarët e pakicave të synuara u intervistuan personalisht në Bashkinë Tivat. Vlerësimi është mbështetur edhe në vizitën në Tivat dhe në shkollën “Drago Milovic” në muajin qershor.

Nga të trembëdhjetë personat e intervistuar për këtë studim, dy qenë zyrtarë bashkiakë, një përfaqësues i komunitetit që kishte punuar në Info Stop, drejtori i shkollës dhe dy mësues që kishin punuar me nxënës minoritarë duke i mbajtur në patronazh. Shtatë të intervistuar qenë anëtar të pakicës së synuar, nga të cilët tre prindër dhe katër fëmijë. Ngaqë fëmijët qenë në moshë shumë të vogël dhe të ndrojtur, ata u intervistuan në praninë e prindërve. Nga trembëdhjetë personat e intervistuar tetë qenë femra, pesë meshkuj.

## Vlerësimi i projektit

---

Ky projekt pati sukses duke qenë se krijoi një hapësirë të mbrojtur dhe hapur për nxënësit minoritarë brenda shkollës. Kjo ndihmoi në integrimin e tyre dhe i motivoi të qëndronin në shkollë dhe të ndienin përfitimet e arsimit. Ai siguronte edhe një hapësirë ku mund të drejtohen mësuesit në rast nevojë. Zyra shërbente edhe për të rritur ndërgjegjësimin për çështje me të cilat përballen nxënësit që i përkasin komunitetit

*“Info Spot që një dritë në errësirë për komunitetin [rom dhe egjiptian]”*

egjiptian. Në fund, ai vendoste një lidhje ndërmjet prindërve dhe shkollës, duke i bërë prindërit të ndiheshin se për fëmijët po tregohej kujdes dhe se qenë të mbrojtur në shkollë dhe duke i mbajtur prindërit të informuar gjatë gjithë kohës.

### *Qëndrueshmëria në kohë*

Qëndrueshmëria e këtij projekti është siguruar për shkak të funksionimit të qendrës Info Spot pranë shkollës lokale "Drago Milovic". Suksesi dhe efektiviteti i zyrës, me ndihmën e faktorëve të tjerë, e ka bërë të qëndrueshëm në kohë këtë projekt dhe të vlefshëm për t'u zbatuar edhe në shkolla të tjera brenda dhe jashtë Malit të Zi. Në komponentët që kontribuojnë në qëndrueshmërinë në kohë të këtij projekti përfshihen:

#### ► Rritja e mbështetjes arsimore për nxënësit minoritarë

Info Spot për fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian brenda shkollës krijoi përfitime, si për komunitetin, ashtu edhe për shkollën, çka siguron qëndrueshmërinë në kohë të tij ngaqë është në interesin më të mirë të shkollës dhe të komunitetit të gjerë që kjo zyrë të vijojë të funksionojë. Intervistat me punonjësit e projektit, prindërit dhe fëmijët kanë zbuluar se ata janë të gjithë interesuar për vijimin e projektit, duke qenë se të gjithë besojnë se ka kontribuar shumë në drejtim të një integrimi më të madh dhe cilësisë më të lartë të arsimit për nxënësit minoritarë. Punonjësit e projektit qenë të kënaqur me suksesin e fëmijëve në shkollë dhe me uljen e numrit të rasteve të braktisjes së shkollës, prindërit qenë shumë të kënaqur me asistencën profesionale që merrnin fëmijët e tyre, ndërsa fëmijët kishin marrë mbështetje të vazhdueshme nga Info Spot.

Info Spot përbëhet nga një ndërmjetësues, një asistent, si edhe mësuesit që u japin mësim jashtëshkollorë nxënësve për t'i përgatitur për provimin e pranimit si edhe për t'i ndihmuar nxënësit e tjerë të arrijnë shokët e tyre në mësim. Nxënësit u ndanë në një grup fëmijësh të vegjël dhe një grup fëmijësh më të rritur, dhe u ndihmuar gjatë gjithë vitit shkollor. Ndërmjetësuesi dhe asistenti qenë gjatë gjithë kohës në zyrë, duke punuar me turne. Atyre u qe ngarkuar detyra për të ndihmuar nxënësit dhe mësuesit. Ata ofronin ndihmë me përkthimin në mënyrë që nxënësit, prindërit dhe mësuesit të mund ta kuptonin njëri-tjetrin. Ata ndiqnin edhe nxënësit gjatë provimit dhe siguronin që të ishin të pranishëm të gjithë nxënësit minoritarë. Ndërmjetësuesi dhe asistenti u kanë dhënë mbështetje morale të konsiderueshme nxënësve dhe prindërve, duke ndihmuar në integrimin e nxënësve në mjedisin shkollor. Info Spot ndodhet në një zyrë brenda ndërtesës së shkollës. Në ka karrige dhe banka për nxënësit, fletore dhe materiale të tjera shkollore, një printer dhe një kompjuter. Është një hapësirë shumë e thjeshtë, por mirëpritëse, që ka fëmijët në qendër. Muret i ka të mbuluara me vizatime të bëra nga nxënësit, për t'u dhënë atyre një ndjenjë krenarie, por edhe që t'u duket se janë zot të kësaj hapësire.

Ndërkohë që në fazat e para kuadri ligjor për përfshirjen e një hapësire të tillë Info Spot nuk ishte e qartë, kjo dilemë është zgjidhur me miratimin e Ministrisë së Arsimit të Malit të Zi, duke mundësuar kështu funksionimin e kësaj zyre brenda mjedisëve të shkollës. Në këtë leje përcaktohen edhe detyrimet dhe detyrat e personave që punojnë pranë zyrës, por me anë të saj sigurohet edhe legjitimiteti brenda shkollës. Gjatë kohëzgjatjes së këtij projekti, zyra u kthye në një pikë referimi për nxënësit,

mësuesit dhe prindërit. Fëmijët gjetën në të një mjedis të mbrojtur ku mund të shkonin dhe të mësonin, të ankoheshin, të bënin pyetje apo të kërkonin këshilla. Mësuesit i drejtoheshin kësaj zyre sa herë që një fëmijë mungonte në shkollë ose kur kishin nevojë për prindërit e fëmijës. Prindërit e vizitonin zyrën për të biseduar për ecurinë e fëmijëve, por edhe për të kërkuar ndihmë për leximin dhe shkrimin e dokumenteve zyrtare. Mandati i kësaj zyre shpesh shkonte përtej asaj që pritej prej saj, duke qenë se dy zyrtarët që punonin në të shpesh punonin më gjatë nga sa u kërkohej, në mënyrë që të siguronin që të gjithë fëmijët të vinin në shkollë, të ishin të mbrojtur dhe të ndiheshin rehat në mjedisin e shkollës. Ky vit qe hera e parë që anëtarët e komunitetet rome dhe egjiptiane u diplomuan nga shkolla e mesme e Tivatit, ku katër nxënës vijuan studimet e larta me ndihmën dhe mbështetjen e zyrës për procesin e paraqitjes së kërkesës. Megjithëse Info Spot kishte qëllimin kryesor t'i ndihmonte nxënësit të hynin në shkollë dhe të mbështeste brezin e ri, kjo zyrë i ka shërbyer edhe brezit të vjetër, sepse ndërmjetësuesi dhe asistenti ka ndihmuar me këshillim për mundësitë për shkollën e mesme dhe për procesin e pranimit. Ndërmjetësuesi dhe asistenti vijuan të punojnë pranë Info Spot për t'i përgatitur fëmijët për vitin e ardhshëm shkollor dhe bashkia po bën lobim pranë Ministrisë së Arsimit për të gjetur fonde që kjo zyrë të qëndrojë hapur edhe pas projektit.

- ▶ Ndiurma për bërjen e politikave në bazë të informacioneve dhe monitorimi

Në kuadër të këtij projekti, u hartua nga punonjësit e Info Spot, shkollës dhe bashkisë një bazë të dhënash për nxënësit që i përkasin komunitetit egjiptian. Kjo bazë të dhënash ka ndihmuar në identifikimin e nxënësve të regjistruar në shkollë dhe në monitorimin e frekuentimit nga ana e tyre. Baza e të dhënave është përditësuar për vitin e ri shkollor, për të siguruar që të regjistrohen të gjithë nxënësit e rinj. Nxënësit janë monitoruar lidhur me frekuentimin, ndërsa prindërit janë kontaktuar sa herë që nxënësit mungonin në shkollë, çka nuk qe praktikuar më parë me nxënësit romë dhe egjiptianë.

Kjo bazë të dhënash është një mjet i thjeshtë që mund të përdoret me lehtësi në atë ardhmen, si nga shkolla, ashtu edhe nga bashkia. Baza e të dhënave mund të përdoret nga shkolla dhe nga Bashkia Tivat ku mbahen dhe përditësohen të dhënat.

- ▶ Përmirësimi i komunikimit ndërmjet shkollës dhe komuniteteve minoritare

Dy punonjësit që punojnë në Info Spot, ndërmjetësuesi dhe asistenti, janë personat të trajnuar të cilët e dinë qartë se cilat janë detyrat dhe kufizimet e tyre në shkollë. Ata janë gjithashtu të trajnuar dhe me përvojë në trajtimin e temave delikate, si martesë në moshë të vogël. Njohuritë për çështjet që prekin komunitetet si edhe besimi që gëzojnë te komuniteti egjiptian në Tivat qenë ndër arsyt kryesore për suksesin e projektit. Kjo mund të sigurojë edhe qëndrueshmërinë në kohë. Si shkolla, ashtu edhe bashkia, qenë shumë të kënaqura me punën e kryer nga këta dy zyrtarë, dhe janë të gatshëm t'i mbajnë në të njëjtat poste që kanë pasur në kuadër të projektit. Besimi dhe entuziazmi vihej re edhe te punonjësit e tjerë, mësuesit, të cilët kanë punuar herë pas here vullnetarisht për ta vazhduar projektin. Si ndërmjetësuesi, ashtu edhe asistenti, kanë bërë shumë vizita në terren, të cilat i kanë ndihmuar të vendosin lidhje të ngushta me komunitetet rome dhe egjiptiane, si edhe t'i ndjekin

më mirë nxënësit. Përkushtimi dhe njohuritë e personave të përfshirë në mbajtjen e zyrës siguron qëndrueshmërinë në kohë të saj.

- ▶ Rritja e shprehive gjuhësore të nxënësve minoritarë dhe e pjesëmarrjes së tyre

Kurset e gjuhës qenë thelbësore për fëmijët. Popullata rome dhe egjiptiane në Tivat flet shqip, ndërsa gjuha e mësimi në shkollë është ajo malazeze. Barriera gjuhësore është një prej arsyeve kryesore përse nxënësit mbeten pas në klasë, ngaqë nuk e kuptojnë gjuhën në të cilën zhvillohet mësimi dhe kështu nuk kanë ndërtuar ta vijojnë arsimimin. Kurset e gjuhës, krahas kurseve të tjera shpesh që kanë bërë fëmijët, i kanë ndihmuar jo vetëm të kalojnë provimet e pranimit që janë të detyruar të marrin të gjithë nxënësit për të filluar shkollën, por edhe të ndihen më mirë në këtë mjedis. Ata ndiejnë më shumë besim te vetja dhe kanë treguar përmirësim të madh në shkollë. Përmirësimi dhe suksesi i tyre këtë vit, falë mbështetjes së madhe që kanë marrë nga mësuesit, ndërmjetësuesi dhe asistenti, do të vazhdojë të ketë efekte pozitive.

Çështje të rëndësishme që duhen mbajtur parasysh:

- **Kuadri ligjor:** kuadri ligjor për një post të tillë pranë shkollës mund të ndryshojë sipas vendit, prandaj duhet të shihet kuadri ligjor përpara fillimit të projektit, në mënyrë që të shmangen vonesat.
- **Zyrtarët:** është e rëndësishme që personat e punësuar si ndërmjetës dhe asistentë të trajnohen dhe të shihen me sy të mirë nga komuniteti me të cilin punojnë.

- ▶ Rritja e ndërgjegjësimit të komuniteteve minoritare

Projekti përfshinte takime me punë për prindërit dhe për fëmijët. Seminaret me prindërit janë veçanërisht të rëndësishme, sepse në to është folur për rëndësinë që ka arsimimi i fëmijëve, si edhe për martesën në moshë të vogël. Rritja e ndërgjegjësimit të prindërve për këto dy çështje është e rëndësishme për qëndrueshmërinë në kohë të projektit, duke qenë se prindërit mësuuan të jenë të ndërgjegjshëm për rëndësinë që ka qëndrimi në shkollë i fëmijëve. Këto çështje janë sidomos delikate kur diskutohen në lidhje me vajzat nxënëse, sepse shpesh janë ato që vuajnë nga martesat në moshë të vogël, për ç'shkak u duhet edhe ta braktisin herët shkollën. Këto takime mundësuan që problemi i arsimit të trajtohet bashkë me prindërit dhe jo vetëm nëpërmjet punës së bërë me fëmijët. Prindërit qenë shumë të përfshirë gjatë gjithë këtij projekti, madje në Info Spot ka pasur 240 vizita nga prindërit, të cilët vinin në zare për t'u informuar për ecurinë e fëmijëve të tyre, por edhe për të kërkuar ndihmë për çështje të tjera. Një prind tha se e vizitonte qendrën Info Spot thuajse përditë, sepse konsideronte një hapësirë të sigurt për ta. Punonjësit e projektit, nëpërmjet takimeve të punës me nënat, vunë re edhe potencialin e tyre. Shumë prej grave qenë të papuna, por kishin aftësi për t'u punësuar në të ardhmen. Punonjësit e projektit janë duke menduar se në çfarë mënyrash të përfshihen më shumë në të ardhmen nënat.

### *Faktori udhëheqës*

Projekti ka pasur mbështetjen e gjerë të bashkisë, shkollës dhe komunitetit. Bashkia luajti një rol shumë të fortë udhëheqës në projekt, çka mund të thuhet edhe për

shkollën. Është vërejtur se është mirë që Info Spot të mos jetë askund tjetër përveç se në shkollë, ku ndërmjetësuesi dhe asistenti mund të ndërveprojnë drejtpërdrejt me nxënësit dhe mësuesit. Ndërmjetësuesi dhe asistenti, punonjësit e projektit, i kanë kapërcyer rolet e pritura prej tyre në fushën e zbatimit të projektit, shpesh duke punuar në mënyrë vullnetare. Të gjithë e kanë lëvdar punën e papushuar të ndërmjetësuesit dhe asistentit dhe janë shprehur se vendosja e tyre brenda shkollës, por edhe brenda komunitetit rom dhe egjiptian, ka ndihmuar që projekti të mbyllet me sukses. Projekti ka pasur mbështetjen e të gjitha institucioneve të rëndësishme për zbatimin e tij, që janë bashkia, shkolla lokale dhe Ministria e Arsimit. Krahas kësaj, punonjësit e projektit kanë pasur bashkëpunim të shkëlqyer me drejtori të ndryshme ët bashkisë, çka u dha mundësi të zbatojnë pjesë të ndryshme. Kjo mbështetje ka hedhur një themel të qëndrueshëm për vijimin e këtij projekti. Por faktori që siguron qëndrueshmërinë në kohë të këtij projekti janë individët që janë përfshirë në të. Punonjësit e projektit vijnë në mënyrë kritike për çështjet që kanë të vejnë me popullatën rome dhe egjiptiane në Tivat. Ata kanë kryer një anketë me prindërit për të zbuluar arsyt përse nuk i çojnë në shkollë fëmijët dhe kanë kërkuar shkakun kryesor për mbeten mbrapa në klasë. Në bazë të anketë, arsyeja kryesore përse fëmijët mbeten pas në shkollë është se nuk kanë qenë në kopsht, kështu nuk e kanë mësuar gjuhën dhe për pasojë kanë probleme me provimet e pranimit.

Këta hapa shtesë tregojnë se bashkia, shkolla dhe punonjësit e projektit janë të vendosur t'i japin zgjidhje problemit të arsimit që në rrënjë, për të pasur sukses. Kjo vendosmëri dhe rol udhëheqës i fuqishëm mbi të gjitha siguron një projekt të suksesshëm në vitet e ardhshme, ku Info Spot do të shërbejë si kanali kryesor i komunikimit për institucionet e ndryshme, prindërit dhe fëmijët.

### *Elementet kryesore të përsëritshme*

- ▶ Info Spot brenda mjediseve të shkollës

Info Spot brenda mjediseve të shkollës është një instrument shumë i dobishëm dhe ka një efekt shumë të dukshëm dhe të suksesshëm mbi komunitetin e synuar. Është e rëndësishme që Info Spot të përsëritet Brenda shkollës dhe jo në një zyrë apo ndërtesë tjetër, duke qenë se kështu mund të vendosë kontakt të drejtpërdrejtë me nxënësit dhe t'u përgjigjet nevojave të tyre menjëherë. Afërsia ka qenë thelbësore për rritjen e besimit, si te nxënësit, ashtu edhe te mësuesit, duke qenë se të dy këto grupe janë mësuar të mbështeten në shërbimet e Info Spot. Krahas kësaj, vendosja brenda shkollës shërben t'i japë më shumë legjitimitet Info Spot-it, që ka sidomos rëndësi për prindërit. Një faktor tjetër që e bën të suksesshëm Info Spot dhe që duhet mbajtur në konsideratë nëse do të zbatohet gjetkë, është fakti se në të punonte, edhe një burrë, edhe një grua. Gruaja që mbante postin e asistentit arsimor është tashmë një person së cilës vajzat e shkollës i besojnë hallet dhe problemet e tyre, kështu që ajo ka një informacion më të mirë se cilat qenë problemet e tyre. Burri që mbante postin e ndërmjetësuesit ka qenë shumë i rëndësishëm për të luftuar paragjykimin dhe dhunën apo provokimet e lidhura me këtë, që ndodhin në oborrin e shkollës. Nëpërmjet mbikëqyrjes së nxënësve gjatë pushimit të drekës, ndërmjetësuesi që në gjendje t'i parandalonte mosmarrëveshjet dhe t'i zgjidhte ato. Gjithashtu, nxënësit kishin më pak gjasa ta linin orën e mësimit nëse qenë nën vëzhgim dhe kujdes gjatë pushimit. Ekzistenca e zyrtarëve të dy gjinive ndihmoi edhe

në vendosjen e marrëdhënieve më të ngushta me prindërit, që është me shumë rëndësi për pakësimin e numrit të rasteve të braktisjes së shkollës dhe mungesave të gjata në shkollë. Por, një bashki që dëshiron ta zbatojë këtë ide, do të duhet të krijojë kuadrin ligjor dhe kufijtë e kësaj zyre, për të përcaktuar kompetencat dhe mundësitë e pasjes së një zyre të tillë. Meqë besimi ndërmjet ndërmjetësuesit dhe asistentit arsimor, nga njëra anë, dhe fëmijëve dhe prindërve, nga ana tjetër, është thelbësor për funksionimin e efektshëm të një zyre të tillë, është me rëndësi të sigurohet që këta individë të merren në punë me kontratë afatgjatë.

► Takimet e punës për prindërit dhe nxënësit

Projekti përfshinte disa takime pune me fëmijë dhe me prindër për çështje të ndryshme që kishin në objektiv komunitetet rome dhe egjiptiane në Tivat. Temat me prindërit përfshinin rëndësinë e higjienës dhe pastrimit, martesat në moshë të vogël dhe rëndësinë e arsimit. Fëmijëve iu ofruan orë pune vizatimi dhe gjuhe. Është me rëndësi zhvillimi dhe përsëritja e seminareve me prindërit sepse kështu përfshihen edhe ata në procesin e mësimin. Përmes rritjes së ndërgjegjësimit të prindërve për çështje të tilla si martesat në moshë të vogël dhe arsimi, projekti ka siguruar që personat që janë më përgjegjës për fëmijët janë të mirinformuar për pasojat e braktisjes së shkollës dhe martesës në moshë të vogël. Është e rëndësishme që në projekte të tilla, të përfshihen nga afër edhe prindërit në projekt, jo vetëm fëmijët, meqë edhe mjedisi i familjes është po aq i rëndësishëm, në mos edhe më i rëndësishëm se mjedisi i shkollës. Ndërkohë që disa çështje që trajtohen në takime të tilla janë të një rëndësie të përgjithshme (si rëndësia e arsimit) të tjerat mund të ndryshojnë sipas rrethanave lokale.

► Kurse shtesë dhe patronazh për nxënësit

Kurset shtesë në nivel parashkollor dhe për fëmijët e regjistruar tashmë në shkollë janë shumë të dobishme. Patronazhi gjithashtu është i mirë jo vetëm në rastet kur ka një barrierë gjuhësore, por edhe kur ka një shkallë të lartë të braktisjes së shkollës. Orës mësimore shtesë i ndihmuan fëmijët parashkollorë ta kalojnë provimin e pranimit dhe të rrisin besimin te vetja përpara frekuentimit të shkollës. Për fëmijët më të mëdhenj në moshë, të cilët nuk kishin mbështetje të mëparshme, këto orë mësimi i ndihmuan t'i përmirësojnë rezultat shkollorë, t'i kuptojnë konceptet që qenë të vështira dhe të fitonin disiplinë, siç tha njëri prej të intervistuarve. Ofrimi i mbështetjes arsimore për fëmijët që nuk e kanë frekuentuar më parë shkollën ose që e kanë frekuentuar por më pas e kanë braktisur, është shumë i rëndësishëm për të rritur besimin. Këto orë mësimi u plotësuan me ekskursionet që i nxitën nxënësit të kenë rezultate të mira në shkollë dhe edhe kjo është një praktikë e mirë. Ndërkohë që në orët mësimore shtesë fëmijët qenë nga komunitetet rome dhe egjiptiane, gjatë ekskursioneve qenë bashkë nxënës nga të gjitha komunitetet. Shkolla ndihmoi dhe uli pagesat për fëmijët që u përkasin komuniteteve rome dhe egjiptiane në mënyrë që të merrnin pjesë edhe ata. Ekskursionet ndihmuan në krijimin e miqësive mes komuniteteve. Një person i intervistuar vërejti se si fëmijët qenë ulur veçmas në fillim të ekskursionit por pastaj në kthim fëmijët qenë përzier me njëri-tjetrin dhe nuk rrinin më të veçuar.

Është e rëndësishme të thuhet se frekuentimi i nxënësve përfitoi shumë nga transporti falas që i priste deri sa të mbaronin orët mësimore shtesë dhe t'i çonte

të sigurt në shtëpi. Pra, këshillohet transporti falas për nxënësit që u përkasin komuniteteve të brishta.

- Baza e të dhënave për monitorimin e frekuentimit dhe numrit të nxënësve

Baza e të dhënave është një instrument shumë i dobishëm dhe i thjeshtë për t'u përsëritur, sidomos në bashkitë e vogla. Baza e të dhënave ndihmon në monitorimin e numrit të nxënësve që ndjekin shkollën, por mund të ndihmojë në hartimin e politikave. Për trajtimin e çështjeve të u përkasin komuniteteve minoritare dhe për të hartuar politika të bazuara në informacione të vërtetuara, numri i këtyre komuniteteve minoritare në një bashki të caktuar është i rëndësishëm në planifikimin e strategjive për trajtimin e çështjeve që kanë në objektiv komunitetet minoritare.



#### **Përfitimet:**

1. Krijon një mjedis të mbrojtur dhe të sigurt për nxënësit që u përkasin komuniteteve minoritare.
2. Rrit vetëbesimin dhe suksesin e fëmijëve që u përkasin komuniteteve minoritare.
3. Vendos një lidhje të fortë dhe konsekuente ndërmjet shkollës dhe prindërve.
4. Trajton problemet e nxënësve minoritarë dhe mjedisin e tyre që në fazë të hershme.
5. Përmirëson efikasitetin dhe suksesin e rolit të asistentëve arsimorë.

## **Përfundime dhe rekomandime**

Ky projekt krijoi një hapësirë të mbrojtur dhe mirëpritëse për nxënësit që u përkasin komuniteteve romë dhe egjiptiane në Tivat. Nëpërmjet Info Spot-it, ndërmjetësuesit, asistentëve arsimorë dhe mbajtësve në patronazh, nxënësit morën mbështetje morale dhe arsimore, të nevojshme për ecuri të suksesshme në shkollë. Gjithashtu, projekti rriti besimin që kanë prindërit te sistemi arsimor, si edhe ta bashkia, duke qenë se të gjithë punuan së bashku për zbatimin me sukses të aktiviteteve. Pamja e plotë që kishin punonjësit e projektit për problemet që kanë të bëjnë me komunitetet romë dhe egjiptiane në fushën e arsimit mundësuan qasje të synuara për t'i kapërcyer këto probleme. Për përsëritjen me sukses të këtij projekti, rekomandimet e mëposhtme mund të ndihmojnë në zbatim:

- **Të përcaktohet ligjërisht roli i asistentit arsimor.** Një status i përcaktuar qartë për asistentët arsimorë do të ndihmonte zbatimin e projektit duke qenë se nuk do të shkaktonte vonesa në reagim, që do të shkaktoheshin nga paqartësia lidhur me detyrat. Gjithashtu, kjo do t'i jepte më shumë legjitimitet dhe siguri këtij posti, që do të forconte bashkëpunimin me organet përkatëse, si shkolla dhe institucioni bashkiak. Paçka se në Tivat bashkëpunimi qe shumë efikas, pa përcaktim të qartë të detyrave realizimi i rolit të asistentit arsimor do të varej nga vullneti i mirë i shkollës dhe i autoriteteve vendore ose qendrore. Madje edhe në Tivat, Info Spot u arrit të zbatohet vetëm pas aprovimit të Ministrisë dhe pas përcaktimit të detyrave, çka shkaktoi vonesa të vogla në zbatim.



## Bashkia Tivat

Vlerësimi i praktikave më të mira në Malin e Zi



# Vlerësimi i praktikave më të mira në Serbi

---

Trigjuhësi elektronike

**Suboticë**

*Tema: Përdorimi zyrtar i gjuhëve dhe alfabeveve*

*Pakicat e prekura: hungareze, kroate*

## Hyrje

---

*Konteksti vendor: pakicat dhe bashkësia e tyre*

**K**ushtetuta e Republikës së Serbisë e ndalon diskriminimin e anëtarëve të pakicave kombëtare dhe garanton të drejtën e tyre për barazi përpara ligjit. Të drejtat e pakicave rregullohen më me hollësi në Ligjin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Pakicave Kombëtare dhe Ligjin për Këshillat Kombëtarë për Pakicat Kombëtare. Dispozitat për të drejtat e pakicave kombëtare të caktuara mishërohen edhe në Ligjin për Përdorimin Zyrtar të Gjuhëve dhe Alfabeveve, Ligjin për Informimin Publik dhe Median, Ligin për Kulturën dhe ligjet përkatëse për arsimin.

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 ka 37 grupe etnike të ndryshme që jetojnë në Serbi. Pakicat etnike më të mëdha janë ato hungareze (3,53%), boshnjake (2,02%), rome (2,05%), kroate (0,81%) dhe malazeze (0,54%), ndërsa të gjitha pakicat e tjera përfaqësohen nga më pak se 0,5 për qind secila. Ndërkohë që serbët dhe malazezët etnikë janë kryesisht të krishterë ortodoksë, hungarezët dhe kroatët janë katolikë, ndërsa boshnjakët, romët dhe shqiptarët etnikë janë kryesisht myslimanë. Serbët, boshnjakët, malazezët dhe kroatët etnikë i përkasin grupit të sllavëve të jugut, ndërsa hungarezët, romët dhe shqiptarët etnikë janë me origjinë jo sllave. Megjithatë grupet me origjinë etnike nga sllavët e jugut kuptohen me njëri-tjetrin, secili prej këtyre grupeve etnike ka gjuhën e vet.

Përqendrimi territorial i etnive është tejet i dukshëm në Serbi, ku pakicat banojnë në rajonet që kufizohen me shtetet mëmë. Hungarezët jetojnë kryesisht në Vojvodinë ku përbëjnë 14,28% të popullsisë së krahinës. Në gjashtë bashkitë në kufi me Hungarinë përbëjnë shumicë absolute, ndërsa në dy të tjera shumicë relative. Boshnjakët jetojnë kryesisht në Sanxhak midis Serbisë, Malit të Zi dhe Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Kosovës\*. Shqiptarët jetojnë më shumë në bashkitë Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje në kufi me Kosovën\*. Romët jetojnë në

të gjithë Serbinë dhe çmohet se numri i tyre është të paktën tri herë më i lartë se shifrat zyrtare. Mungesa e statistikave të sakta për numrat e saktë është pasojë e shkallës së lartë të përjashtimit të këtij grupi në çdo sferë të jetës, që nga shkalla e ulët e pjesëmarrjes në arsim dhe tregun e punës deri te kushtet e brishta sociale dhe ekonomike në të cilat jetojnë romët.

Shkallët më të mëdha të largësisë etnike shprehen në lidhje me shqiptarët etnikë, pasuar nga kroatët, romët dhe boshnjakët. Krahas kësaj, vlen të theksohet se incidente ndëretnike vijnë në shfaqjen në Vojvodinë gjatë viteve të fundit dhe konkretisht në qytetet e banuara nga pakica hungareze: Temerin, Beçej dhe Novi Sad. Megjithatë, shumica e problemeve me të cilat përballen pakicat kanë të bëjnë me varfëri dhe zhvillim të ulët ekonomik të rajoneve ku janë të përqendruara. Sanxhaku dhe Serbia Jugore janë mes zonave më të varfra në Serbi. Shkalla e lartë e papunësisë, infrastruktura e neglizhuar dhe mungesa e perspektivës ekonomike kontribuon në faktorët destabilizues.

Sipas regjistrimit të vitit 2011, qyteti i Suboticës ka 141.554 banorë, nga të cilët 35,65% (50.469 banorë) janë anëtarë të pakicës hungareze, 27,02% (38.254 banorë) janë serbë, 10% (14.151) janë anëtarë të pakicës kombëtare kroate dhe 9,57 % (13.553 banorë) janë anëtarë të pakicë kombëtare bunjevce.

### *Projekti: përgjigjja ndaj nevojave vendore*

Megjithëse Kushtetuta Serbe parashikon përdorimin zyrtar të gjuhës serbe dhe alfabetit cirilik, ajo u jep të drejtë personave që u përkasin pakicave kombëtare të përdorin zyrtarisht gjuhën dhe alfabetin e tyre. Ligji për Përdorimin Zyrtar të Gjuhës dhe Alfabetit konfirmon se gjuha minoritare mund të përdoret për legjislacion, komunikim me organet publike, prezantimin e emrave në dokumentet zyrtare, punën me organet përfaqësuese, emrat e njësive të vetëqeverisjes vendore, qyteteve dhe fshatrave, rrugëve, shesheve etj., në bashkitë ku të paktën 15% e popullsisë i përket një pakice. Ka shtatë gjuhë në përdorim zyrtar në bashki të ndryshme të Vojvodinës (serbisht, kroatisht, rumanisht, rutenisht, hungarisht, sllovakisht dhe çekisht) dhe katër gjuhë në disa bashki të caktuara në Serbinë Qendrore (serbisht, boshnjakisht, shqip dhe bullgarisht).

Duke njohur nevojën për ta përmirësuar përdorimin e gjuhëve hungareze dhe kroate në qytetin e Suboticës, ky projekt synon të ngrejë kapacitetin teknik të organeve përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet softuerit të specializuar për sistemin e menaxhimit të dokumenteve (SMD) në të dy gjuhët. SMD është një program kompjuterik që përdoret për të gjurmuar, menaxhuar dhe ruajtur dokumentet zyrtare në administratën publike të Suboticës, por deri në fillim të projektit mund të përdorej vetëm në gjuhën serbe.

Pritet që projekti të ketë një efekt afatgjatë mbi cilësinë dhe fushëveprimin e zbatimit të të drejtave gjuhësore të pakicave kombëtare dhe në zgjidhjen e nevojave personale të qytetarëve që u përkasin pakicave kombëtare. Megjithëse përdoruesit kryesorë të SMD-së janë anëtarë të administratës bashkiake, përfituesit kryesorë janë shtetas që u përkasin komuniteteve minoritare hungareze dhe kroate. Nuk ka ende interes të ndjeshëm nga pakicat e synuara për përdorimin

e shërbimeve të reja administrative të ofruara në gjuhët minoritare, të cilat palët e interesit të intervistuar e interpretojnë në dritën e faktit që sistemi është krijuar vetëm tani vonë, por edhe për shkak të mungesës së punës afruese dhe bashkëpunimit të pamjaftueshëm të pakicave kombëtare. Pavarësisht kësaj, disa përfaqësues të pakicave të synuara e konsideronin projektin të rëndësishëm dhe shprehën kënaqësinë me mundësinë për t'u regjistruar, për shembull, në listat zgjedhore minoritare në gjuhën amtare.

Këto sfida qenë njohur që në raportin e parë për vendin në kuadër të projektit, ku sinjalizohej mungesa e përfshirjes së komunitetit minoritar relativisht të organizuar mirë në përzgjedhjen e temës ose hartimin e projektit. Megjithatë, duke konsideruar objektin tejet teknik të projektit, kjo vështirësi nuk e pengoi realizimin me sukses të vetë detyrave të projektit. Megjithatë, për të përhapur rezultatet e projektit dhe për të rritur ndërgjegjësimin e shtetasve që u përkasin pakicave kombëtare në lidhje me të drejtën për ta përdorur gjuhën amtare në kontaktet me administratën bashkiake, do të jetë me shumë rëndësi të përfshihen OJQ-të minoritare lokale dhe këshillat e pakicave kombëtare.

### *Aktivitetet: krijimi i një hapësire gjithëpërfshirëse*

Rezultati kryesor i projektit është prezantimi i Sistemit të Specializuar për Menaxhimin e Dokumenteve (SMD), një sistem kompjuterik për organizimin e dokumenteve që ofron mundësinë për të mbajtur në kontroll dhe monitoruar gjuhën e procedurave administrative dhe mundësinë për t'i informuar përdoruesit për kalimin e dosjes së tyre në fazën tjetër si edhe për përfundimin e procesit. Gjatë zbatimit të projektit është testuar SMD, ndërsa formularët model të bashkisë janë përkthyer dhe janë përfshirë në mënyrë elektronike në gjuhët që janë në përdorim zyrtar në vetëqeverisjen vendore.

Ky projekt është tejet teknik në formën e tij, çka kërkon njohuri prej eksperti të specializuar. Prandaj, një komponent i rëndësishëm i zbatimit të projektit ka qenë rritja e kapacitetit të afërsisht 40 aktorëve të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet ofrimit të trajnimit për përdorimin e SMD-së.

Rezultatet e projektit u prezantuan në një konferencë njëditore ndërbashkiake si edhe nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme promicionale në territorin e rrethit administrativ të Baçkës së Veriut, ku përfshiheshin ditë informative të organizuara nga Bashkia Suboticë dhe rritjes së bashkëpunimit me median lokale dhe kombëtare.

## **Metodika**

---

Për këtë studim janë intervistuar pesë persona, nga të cilët tre zyrtarë bashkiakë, një përfaqësues i këshillit të pakicave kombëtare dhe një përfaqësues i pakicës së synuar. Përfaqësuesi i këshillit dhe përfaqësuesi i pakicës së synuar nuk janë përfshirë drejtpërdrejt në zbatimin e projektit. Nga pesë personat e intervistuar katër qenë femra, njëri qe mashkull. Anëtarët e grupit të posaçëm të punës dhe përfaqësuesit e pakicave të synuara u intervistuan personalisht në Bashkinë Suboticë në qershor 2016.

## Vlerësimi i projektit

---

### *Qëndrueshmëria në kohë*

- ▶ Rritja e larmisë gjuhësore.

Projekti e ka rritur larminë gjuhësore në qytetin e Suboticës përmes integritetit të dokumenteve administrative që nxjerr administrata bashkiake në fushat e ndryshme (për shembull, listat e votuesve minoritarë, regjistrat, financat, çështjet sociale, kompensimet financiare për familjet etj.) në një sistem të njëzuar që përmbush kërkesat e përdorimit trigjuhësh zyrtar, që janë gjuhët serbe, hungareze dhe kroate. Një rezultat i qëndrueshëm në kohë është unifikimi i dokumenteve në gjithë administratën bashkiake, në mënyrë që të jenë në të tri gjuhët zyrtare dhe të nxirren në mënyrë të shpejtë dhe pa probleme. Në këtë mënyrë, projekti ia ka dalë mbanë ta rrisë përdorimin zyrtar të gjuhëve minoritare në administratën publike të qytetit të Suboticës, si në komunikimin me përfaqësues të komuniteteve minoritare, ashtu edhe në ndërveprimin reciprok të autoriteteve vendore.

- ▶ Përmirësimi i dispozitave ligjore dhe rritja e përdorimit zyrtar të gjuhëve minoritare

Efekti i projektit është një zbatim i njëtrajtshëm i Ligjit për përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe alfabeteve, si edhe i akteve të tjera ligjore të lartpërmendura. Ky projekt do të ketë efekt afatgjatë mbi cilësinë dhe fushëveprimin e zbatimit të të drejtave të pakicave kombëtare në administratën publike në lidhje me përdorimin e gjuhës amtare për pakicat kombëtare.

- ▶ Modernizimi i sistemit informatik të administratës bashkiake

Si rezultat i projektit, është përditësuar plotësisht sistemi paraekzistues informatik i administratës bashkiake. Afërsisht 40 aktorë të vetëqeverisjes vendore kanë marrë trajnime për përdorimin e teknologjive të reja informatike të lidhura me zbatimin e këtij projekti. Ngritja e kapaciteteve të administratës bashkiake do të ndihmojë në kapërcimin e vështirësive praktike dhe teknike të hasura gjatë përdorimit të gjuhëve minoritare në fushën e komunikimit zyrtar. Për më tepër, ky projekt ka hapur tashmë kanale të reja komunikimi ndërmjet administratës bashkiake dhe komunitetit minoritar përmes postës elektronike dhe SMS-ve. Qëndrueshmëria në kohë e projektit sigurohet përmes softuerit të specializuar të zgjeruar rishtazi për Sistemin e Menaxhimit të Dokumenteve (SMD). Sistemi ka mundësinë për të mbajtur në kontroll dhe monitoruar gjuhën e procedurave administrative dhe për t'i informuar përdoruesit për kalimin e dosjes së tyre në fazën tjetër si edhe për përfundimin e procesit. Zyra e alfabeteve siguron modulën kryesor, që përbën bazën e të gjitha operacioneve zyrtare të Këshillit Bashkiak. Moduli përdoret për të pranuar dokumentet dhe për të ndjekur rrjedhën e një dosjeje, ndërsa krahas kësaj përdoret për të përpiluar një bazë statistikore të dhënash që do të përdoren nga administrata

bashkiake dhe institucionet përkatëse për t'i zhvilluar më tej instrumentet ligjore dhe praktike për përmirësimin e të drejtave minoritare.

### *Faktori udhëheqës*

Ekipi i zbatimit të projektit përbëhej nga punonjës të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik Vendor (ZHEV), Drejtorisë së Informatikës dhe punonjës administrativë të shërbimit për klientët të Bashkisë Suboticë. Palët e interesuara të intervistuar thënë se qëllimi, metoda e hartimit të projektit dhe detyrat e tij qenë të qarta për të gjithë personat e përfshirë në zbatimin e projektit. Gjatë zbatimit të projektit, ekipi zbatues ka bashkëpunuar nga afër në mënyrë të përditshme në mjediset e Këshillit Bashkiak për të diskutuar për masat përkatëse, ndërsa janë zhvilluar edhe aktivitete për punë afruese me mediat, një konferencë dhe katër takime dypalëshe ndërmjet aktorëve bashkiakë dhe përfaqësuesve të këshillave të pakicave. Megjithëse projektit i mungonte mbështetja materiale nga pakicat e synuara, për shkak të aspektit vetëm teknik, që më e rëndësishme që ekipi zbatues ka marrë mbështetjen e Ministrisë së Administratës Publike dhe Vetëqeverisjes Vendore.

### *Elementet kryesore të përsëritshme*

- ▶ Sistemi i Specializuar për Menaxhimin e Dokumenteve

Sistemi i Specializuar për Menaxhimin e Dokumenteve (SMD), një sistem kompjuterik për organizimin e dokumenteve që ofron mundësinë për të mbajtur në kontroll dhe monitoruar gjuhën e procedurave administrative dhe mundësinë për t'i informuar përdoruesit për fazat e ndryshme të dosjes së tyre, është vërtet një praktikë me përfitim të zbatuar nga Bashkia Suboticë. Si i tillë është i përsëritshëm në institucione të ndryshme të administratës publike. Megjithatë, fakti se SMD ka përkthyer formularët model bashkiakë në tri gjuhët zyrtare në Suboticë (serbisht, hungarisht dhe kroatisht) e bën këtë komponent të projektit unik dhe novator dhe, kështu, është tejet i rekomandueshëm për t'u përsëritur në kushte të vetëqeverisjes vendore johomogjene. Megjithëse mund të përdoret menjëherë në bashki të tjera të Vojvodinës që kanë të njëjtat gjuhë minoritare, sikurse kemi mësuar në fazën e fundit të intervistave, ekipi zbatues i projektit ka marrë tashmë shprehjen e interesit për ta transferuar këtë njohuri teknike në disa bashki të Malit të Zi dhe Serbisë Jugore.

#### **Përfitimet:**

1. Përmirësimi i zbatimit të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave gjuhësore të pakicave.
2. Përmirësimi i kapacitetit të administratës publike në qytetin e Suboticës.
3. Rritja e larmisë gjuhësore në qytetin e Suboticës.
4. Rritja e arritshmërisë së shërbimeve të Bashkisë për anëtarët e pakicave kombëtare hungareze dhe kroate.

## Përfundime dhe rekomandime

---

Përmes krijimit të një sistemi që mund të përdoret nga punonjës të trajnuar bashkiakë në përfitim të qytetarëve, ky projekt ia ka dalë mbanë t'i çojë përpara kapacitetet e administratës publike të Bashkisë Suboticë. Gjithashtu, ai ka përmirësuar larinë gjuhësore në Suboticë duke u dhënë mundësi pakicave të synuara t'i përpunojnë dhe dorëzojnë dokumentet zyrtare në gjuhën e tyre amtare përmes SMD-së. Siç thuhet edhe më lart, projekti ka një potencial të fortë sa i takon zbatimin në njësitë e tjera të administratës vendore. Për të siguruar qëndrueshmërinë në kohë dhe suksesin e vazhdueshëm të projekteve të ngjashme në të ardhmen, jepen rekomandimet e mëposhtme:

- ▶ **Të transferohen njohuritë teknike.** Ky projekt është tejet teknik në formën e tij, çka kërkon njohuri prej eksperti të specializuar. Prandaj, një komponent i rëndësishëm i projekteve të ardhshme që përfshijnë përdorimin e SMD-ve në mënyrë që nëpunësit e njërive të vetëqeverisjes vendore t'i trajtojnë më mirë të drejtat e pakicave në bashkitë përkatëse do të duhej të ishte transferimi i njohurive teknike dhe ngritja e kapaciteteve të aktorëve përkatës të vetëqeverisjes vendore. Duke mbajtur parasysh që nëpunësit civilë të Bashkisë Suboticë kanë treguar një zotësi të lartë në zhvillimin dhe zbatimin e aplikacionit SMD, do të ishte tejet e rekomandueshme përfshirja e tyre si instruktorë trajnimit në njësi të interesuara të vetëqeverisjes vendore.
- ▶ **Të sigurohet kapaciteti financiar.** Pavarësisht nga vullneti i fortë politik për ta përmirësuar integrimin e pakicave kombëtare të demonstruar nga ana e Bashkisë Suboticë, detyrat komplekse dhe të gjithanshme të prezantimit të SMD-së nuk do të mund të ishin arritur pa kontributin financiar të BE-së dhe Këshillit të Evropës. Kur vëren trendin e përgjithshëm të amullisë apo ndonjëherë edhe të pakësimit faktik të mjeteve financiare të caktuara për promovimin e aktiviteteve kulturore dhe aktiviteteve të tjera të pakicave në vendet e Evropës Juglindore, e përkeqësuar më tej nga kriza ekzistuese financiare, mund të arrihet në përfundimin se kufizimet financiare e bëjnë më të vështirë realizimin e projekteve të vështira si ky i futjes në përdorim të SMD-së. Prandaj është e rëndësishme të sigurohet kapaciteti i qëndrueshëm financiar i bashkive të ndryshme në nivel vendi për t'u dhënë atyre mundësi të mund të zbatojnë projekte novatore në përfitim të pakicave lokale.
- ▶ **Të rritet ndërgjegjësimi i grupit të synuar në lidhje me të drejtat e pakicave** Bërrja e kërkesës dhe formimi i aktorëve të vetëqeverisjes vendore nuk përbën qëllim në vetvete. Intervistat kanë treguar se anëtarët e komuniteteve minoritare kanë njohuri të kufizuara për ligjet, politikat dhe strategjitë për promovimin e të drejtave të tyre dhe, për pasojë, nuk e përdorin mundësinë të komunikojnë me administratën vendore në gjuhën amtare. Prandaj, për ta maksimizuar produktin e zbatimit të SMD-së në kushtet e ardhshme, një komponent shtesë i projektit do të ishte marrja në konsideratë e aktiviteteve të punës afruese me publikun për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e pakicave.



**Suboticë**

**Vlerësimi i praktikave më të mira në Serbi**



# Vlerësimi i praktikave më të mira në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë

---

Përmes vlerave kulturore tradicionale të komuniteteve drejt një jete më të mirë për qytetarët e Staro Nagoriçanr

**Staro Nagoriçane**

*Tema: Trashëgimia kulturore*

*Pakicat e prekura: serbe*

## Hyrje

---

*Konteksti vendor: pakicat dhe bashkësia e tyre*

**K**omunitetet minoritare që jetojnë në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë shpesh janë të nënpërfaqësuar, si në nivel politik, ashtu edhe në administratë publike. Komuniteti shqiptar është ankuar se është i nënpërfaqësuar në të dyja këto sfera, ndërsa raporti i Avokatit të Popullit<sup>234</sup> dhe një raport i kohëve të fundit mbi zbatimin e Marrëveshjes Kuadër të Ohrit kanë konstatuar se, me përjashtim të komunitetit serb dhe atij vllah, të gjitha komunitetet minoritare janë të nënpërfaqësuar, sidomos në postet drejtuese<sup>235</sup>. Gjithashtu, ka pasur incidente të shumta vitet e fundit midis komunitetit etnik shqiptar dhe atij maqedonas, që e kanë rritur tensionin në marrëdhëniet ndëretnike. Komuniteti rom është shpesh i diskriminuar, sidomos në mundësinë për punësim dhe marrjen e shërbimeve shëndetësore.

Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, arsimi parashikohet për komunitetet minoritare në gjuhën e tyre. Bëhet mësim në gjuhët shqipe, serbe dhe turke, por jo në gjuhën rome. Gjithashtu, nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme studiojnë veçmas duke qenë se turnet në shkolla shpesh ndahen sipas përkatësisë etnike, pra në një shkollë ku studiojnë shqiptarë dhe maqedonas, nxënësit mësojnë

---

234 Siç përmendet në Raportet e Departamentit të Shtetit të SHBA-së për të drejtat e njeriut në 2015, Raporti për Malin e Zi.

235 Marrëveshja Kuadër e Ohrit: Shqyrtim i Kohezionit Social.

në dy turne të ndryshme, çka u jep shumë pak mundësi komuniteteve të ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Edhe mediat janë të ndara, televizioni kombëtar jep lajme dhe programe televizive në të gjitha gjuhët minoritare, por mediat private janë shpesh njëgjuhëshe, ka vetëm dy televizione private kombëtare në shqip dhe maqedonisht. Gjithashtu, përdorimi i gjuhës së urrejtjes në media është i pranishëm dhe rrallë ndëshkohet.

Komunitetet minoritare, të cilat përbëjnë më pak se 20% të popullsisë, janë shpesh në rrezik përjashtimit, sidomos në vendimmarrje. Për të monitoruar dhe nxitur zbatimin e ligjeve që u përkasin këtyre komuniteteve, shteti ka ngritur Agjencinë për Realizimin e të Drejtave të Komuniteteve, e cila vazhdon të ketë vështirësi sa i takon pasjes së një mandati dhe buxheti adekuat, si edhe lidhur me mungesën e mbështetjes nga institucionet shtetërore përkatëse.<sup>236</sup>

Kultura është një prej fushave të planifikuara për t'u decentralizuar sipas Marrëveshjes Kuadër të Ohrit të vitit 2001. Decentralizimi në fushën e kulturës do t'i shërbente funksionit të përmbushjes së nevojave specifike lokale të komuniteteve me identifikim etnik dhe kulturor të ndryshëm. Ministria e Kulturës dhe buxheti qendror i ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë financojnë përpjekjet kulturore dhe institucionet që konsiderohen se janë institucione shtetërore. Ndërsa për aktivitetet dhe institucionet që konsiderohen se janë të një natyre lokale, financat vijnë nëpërmjet donacioneve në bllok nga buxheti qendror i ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë për secilën bashki, si edhe nëpërmjet një mbështetje modeste nga autoritetet lokale, nëse ka fonde.

Duhet thënë se aktivitetet shtetërore, që financohen nga institucionet qendrore, përbëjnë pjesën më të madhe të donacioneve ose financimeve për aktivitetet kulturore, ndërsa donacionet në bllok përbëjnë pjesën më të vogël. Krahas burimeve të kufizuara për projektet kulturore, shumica e fondeve u shkojnë bashkive urbane. Bashkitë e vogla, rurale, të cilat nuk kanë trashëguar institucione kulturore të favorizuara nga organet qendrore, për pasojë kanë më pak ose aspak fonde. Bashki të tilla si Staro Nagoriçane kanë fatin e grupit të bashkive që marrin shumë pak financim nga buxheti qendror. Në këto kushte, financimi nga jashtë është një mundësi që këto bashki të nisin veprimtari të reja.

Në bazë të regjistrimit të popullsisë të kryer në vitin 2002, popullsia maqedonase përbëhet nga 2.022.457 banorë, nga të cilët 724.566 janë komunitete jo shumicë. Komuniteti serb është komuniteti i katërt më i madh në nivel shteti (35.939 banorë) dhe komuniteti i dytë më i madh në bashkinë e Staro Nagoriçanes, me 926 banorë<sup>237</sup> nga 4.840 banorë gjithsej. Në kohën e regjistrimit të popullsisë, kishte 3.906 maqedonas, 1 rom dhe 6 "të tjerë". Gjuhët zyrtare janë maqedonishtja dhe serbishtja, të cilat janë edhe gjuhët në të cilat bëhet mësimi në shkollat lokale.

<sup>236</sup> Marrëveshja Kuadër e Ohrit: Shqyrtim i Kohezionit Social, f. 9.

<sup>237</sup> Agjencia Shtetërore e Statistikave, Regjistrimi i Popullsisë 2002, <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/knigaXIII.pdf>.

## *Projekti: përgjigjja ndaj nevojave vendore*

Projekti “Përmes vlerave kulturore tradicionale të komuniteteve drejt një jete më të mirë për qytetarët e Staro Nagoriçanes ” kishte për synim rigjallërimin e traditave kulturore të komunitetit serb. Çuarja përpara e vlerave kulturore dhe traditave është arritur nëpërmjet mësimin të valleve tradicionale nga fëmijët si edhe nëpërmjet përgatitjes së veshjeve tradicionale nga gra lokale të trajnuara. Bashkia e Staro Nagoriçanes është e shtrirë gjeografikisht, me 39 zona të banuara brenda bashkisë, disa mjaft të vogla. Ky projekt ishte një mundësi për t’i bashkuar banorët e bashkisë dhe për t’i bërë të ndien pjesë e një komuniteti.

Aktivitetet e këtij projekti ia dolën mbanë të rigjallëronin jetën shoqërore dhe kulturore të Staro Nagoriçanës. Në të gjitha aktivitetet ku vallëzuan fëmijët morën pjesë banorët e bashkisë nga të gjitha komunitetet (serbë, maqedonas dhe romë) si edhe vizitorë nga jashtë bashkisë. Kryetari i bashkisë u shpreh me entuziazëm se “projekti ka qenë një sukses i vërtetë” gjatë intervistës për këtë studim. Madje, ky ka qenë projekti i parë i këtij lloji, siç e theksuan disa të intervistuar. Projekti e siguroi qëndrueshmërinë në kohë edhe përmes trajnimit të pjesëmarrësve dhe sigurimit të mjeteve për të mundësuar vijueshmërinë e këtij projekti.

Në analizën fillestare të këtij projekti, parashikoheshin dy risqe: mbështetja te OSHC për zbatimin e projektit dhe angazhimi i komuniteteve lokale.<sup>238</sup> Bashkëpunimi ndërmjet OSHC-së dhe Bashkisë u rrit me zbatimin e projektit duke qenë se ekzistonte një krenari e përbashkët, krahas përgjegjësisë, për këtë projekt. Megjithatë komuniteti serb nuk konsiderohej si shumë i organizuar, ky projekt ia arriti të sillte aktiviteve ku u bashkuan njerëzit. Sfidat e projektit kishte të bënte me reagimin e ulët ndaj thirrjes së hapur për trajnimin e grave për të bërë veshje tradicionale, meqë bënë kërkesë për pjesëmarrje vetëm katër gra (numri minimal i nevojshëm), të cilat përfaqësonin të tri komunitetet që jetojnë në Staro Nagoriçane: dy ishin serbe, një romë dhe një maqedonase. Por niveli i lartë i pjesëmarrjes së fëmijëve në mësimet e valleve tregon interesin e madh për projektin dhe për ruajtjen e vlerave kulturore.

Pjesëmarrësit e këtij projekti u ndien zot të aktiviteve të tij, krahas ndjenjës së krenarisë për arritjet e tyre. Fëmijët qenë të kënaqur që mësuuan këto aftësi të reja dhe treguan entuziazëm për arritjet e tyre. Komuniteti i gjerë gjithashtu u ndie pjesë e projektit, prindërit qenë të kënaqur me aktivitetin në të cilin merrnin pjesë fëmijët, ndërsa grave që qepnin veshjet tradicionale u vinin vizitorë të shpeshtë nga komuniteti i bashkisë për të parë se punën e tyre. Madje, punishtja e grave që një hapësirë interesante për t’u vizituar për shkak të materialeve të shumta, më interesante nga të cilët që *razboji* apo vegja tradicionale prej druri. Vetë gratë e tregonin punën e tyre me krenari. Gjithashtu, gratë e trajnuara zhvilluan edhe një marrëdhënie të mirë me valltarët e vegjël të cilët i ndihmonin për t’u përgatitur për çdo shfaqje, duke vendosur kështu një lidhje të fortë bashkëpunimi ndërmjet pjesëve të ndryshme të projektit.

---

238 “Nxitja e të drejtave të njeriut dhe e mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore”: Raporti i vlerësimit të parë të projektit, f. 57.

## *Aktivitetet: krijimi i një hapësire gjithëpërfshirëse*

Në kuadër të projektit, një instruktor profesionist u mësoi valle tradicionale 96 fëmijëve të moshave 5 deri 15 vjeç. Që fëmijët të hidhnin valle me veshje popullore, u trajnuar katër gra lokale për të qepur, qëndisur dhe endur kostume popullore. Gratë e trajnuara prodhuan 500 veshje gjatë projektit, që përfaqësonin tri krahina, pra një larmi veshjesh popullore të komunitetit serb. Për të siguruar që veshjet tradicionale dhe produktet e tjera të këtij projekti të ekspozohen si duhet dhe për të treguar se vërtet i përkasin komunitetit, bashkia i vendosi në Shtëpinë Etnografike të çelur në fund të projektit, e cila mund të shihet nga vizitorët.

Janë zhvilluar pesë koncerte në fshatra të ndryshme të bashkisë, si edhe një në Bashkinë Kumanovë. Në fund u bë një ekspozitë me të gjitha veshjet, suvenirët dhe produktet e tjera të përgatitura gjatë projektit. Krahas këtyre, Bashkia e Staro Nagoriçanës ka ftuar një OSHC me krijimin e degës së organizatës "Srpski Vez" e cila ndihmoi në zbatimin e projektit. "Srpski Vez" është një organizatë kulturore që synon promovimin e kulturës serbe në Maqedoni dhe dega e saj u ngrit në Staro Nagoriçane për ndihmuar në zbatimin e projektit. Organizata do të vijojë të ketë një degë në bashki edhe pas përfundimit të projektit.

## **Metodika**

---

Për këtë studim janë intervistuar gjashtëmbëdhjetë persona, nga të cilët dy qenë zyrtarë bashkiakë, një anëtar OSHC-je që qe përfshirë në zbatimin e projektit, instruktori i grave, instruktori i valleve, drejtori i shkollës, një prind dhe nëntë anëtarë të pakicës së synuar. Nga gjashtëmbëdhjetë personat e intervistuar tetë qenë femra, dhe tetë meshkuj. Të gjithë personat u intervistuan personalisht gjatë një vizite në Staro Nagoriçane, ndërsa konsulenti mbikëqyrës u intervistua nëpërmjet postës elektronike. Për fëmijët e intervistuar u mor leje verbale nga drejtori i shkollës. Anëtarët e grupit të posaçëm të punës dhe anëtarët e pakicave të synuara u intervistuan personalisht në Bashkinë e Staro Nagoriçanës. Vlerësimi mbështetet edhe në vizitën e kryer në Staro Nagoriçane në maj 2016. Duke qenë se ky projekt përfshinte produkte të ndryshme, si veshje dhe batanije, ekspozita në Shtëpinë Etnografike, qe e rëndësishme të shiheshin dhe të vlerësoheshin edhe këta komponentë.

## **Vlerësimi i projektit**

---

Projekti është i suksesshëm duke qenë se rigjallëroi dhe bashkoi të gjithë komunitetin nëpërmjet koncerteve, valleve dhe mësimëve të qepjes. Gjithashtu ai ka frymëzuar bashkinë dhe komunitetin të vijojnë me këtë dhe me projekte të tjera që do të kontribuonin në drejtim të pasurimit të jetës kulturore dhe shoqërore të komuniteteve që jetojnë në Staro Nagoriçane. Në fund, projekti kontribuoi në drejtim të fuqizimit të grave dhe të rinjve në këtë bashki.

## Qëndrueshmëria në kohë

Ky projekt është i qëndrueshëm në kohë sepse ka shumë faktorë që mundësojnë vijueshmërinë e tij edhe pasi të mos jetë më grati i projekti. Faktorët që e bëjnë këtë projekt të qëndrueshëm në kohë e bëjnë atë me vlerë për t'u zbatuar edhe gjatë, duke qenë se disa prej elementeve të tij mund të mbajnë veten. Në këta faktorë përfshihen:

- Rritja e kapaciteteve dhe fuqizimi i grave lokale

Gjatë zbatimit të këtij projekti u trajnuan katër gra. Ndër shprehite e reja që mësuan janë endja, qepja dhe qëndisja. Krahas shprehive që mësuan, gratë u fuqizuan sepse ndiheshin krenare për arritjet e tyre dhe mezi prisnin të vijonin ushtrimin e shprehive të mësuara rishtazi. Krahas kësaj, projekti u ka siguruar punësim, duke qenë se janë paguar për punën me orar të shkurtuar. Punësimi u dha mundësi këtyre grave të dalin nga shtëpia dhe të shoqërohen nja dy orë, krahas fitimit të shprehive të reja.

Në vizitën në Nagoriçanën e Vjetër, gratë e tregonin me krenari punën e tyre. Megjithëse, siç e pranonin edhe vetë, fillimisht kishin ngurruar, por tani kishin besim se do ta vazhdonin këtë praktikë. Këtë e thanë edhe instruktori dhe zyrtarët bashkiakë, të cilët e kishin vënë re rritjen e vetëbesimit dhe disiplinës. Duke qenë se mjetet e blera për këtë projekt do të mbeten në punishte edhe pas përfundimit të projektit, është e lehtë që puna të vazhdojë. Zbatuesit e projektit kanë parë mundësitë për ta bërë këtë aktivitet të qëndrueshëm në kohë. Gratë e trajnuara mund të hapin një biznes dhe të fillojnë t'i shesin produktet në të ardhmen. Staro Nagoriçana është një bashki turistike me vende të famshme, prandaj ideja e një biznesi të vogël në të ardhmen mund të dalë me shumë sukses.

- Ruajtja e kulturës nëpërmjet brezave të rinj

Projekti parashikonte trajnimin e 36 fëmijëve, por në aktivitetin hapës të projektit u paraqitën 109 fëmijë, nga të cilët 96 qëndruan në grup deri në fund të projektit. Për pasojë, nga 36 kostume të parashikuara fillimisht nga projekti për t'u prodhuar, deri në fund të projektit u bënë 60 kostume për valltarët. Numri i lartë i fëmijëve që morën pjesë në këtë projekt është tregues i qartë i nevojës për aktivitete kulturore. Fëmijët u përkisnin komuniteteve maqedonase, serbe dhe rome dhe vinin nga fshatra të ndryshme të Bashkisë së Staro Nagoriçanës. Mësimet e valleve konsideroheshin të suksesshme sepse u mësuan fëmijëve më shumë për trashëgiminë kulturore, si edhe për disiplinën dhe rëndësinë e punës në një ekip shumetnik. Në kushtet e Maqedonisë kjo është e rëndësishme, sepse fëmijët shpesh nuk i mësojnë mjaftueshëm për kulturën e komuniteteve të tjera.<sup>239</sup> Nëpërmjet këtij projekti, u bënë valle dhe veshje të ndryshme serbe nga krahina të ndryshme të Maqedonisë dhe Serbisë, duke treguar kështu vlerësim për disa kultura.

Projekti duket se ka hapur alternativa edhe për fëmijët, sepse disa prej tyre vendosën të frekuentojnë orën e muzikës krahas kurseve jashtëshkollore të tjera.

<sup>239</sup> Marrëveshja Kuadër e Ohrit: Shqyrtim i Kohezionit Social, f. 7

Pra kurset e valles nuk qenë vetëm një aktivitet jashtëshkollor, por edhe një shtysë që pjesëmarrësit të vijonin të ishin më aktivë edhe përmes kurseve të tjera.

Ky aktivitet mund të jenë i qëndrueshëm në kohë sepse bashkia mund të vendosë të kërkojë një tarifë simbolike regjistrimi për pjesëmarrësit, në mënyrë që të mbulohet një pjesë ose e gjithë paga e instruktorit dhe të ndihmohet me transportin e fëmijëve nga fshatrat e tjera të bashkisë.

► Rritja e përfshirjes së komunitetit në ruajtjen e kulturës

Duke qenë se kjo qe hera e parë që zbatohet një projekt i tillë në Bashkinë e Staro Nagoriçanës, komunitetet treguan shumë angazhim dhe vlerësim për projektin. Të gjitha aktivitetet dhe koncertet u ndoqën nga një numër i madh spektatorësh. Prindërit e fëmijëve qenë shumë të lumtur t'i shoqëronin fëmijët dhe të merrnin pjesë në koncerte.

Edhe komuniteti i gjerë tregoi interes dhe mbështetje për gratë e ngarkuara me bërjen e veshjeve popullore. Banorët shpesh vinin në punishte për të parë se si bëheshin veshjet. Nga këto vizita, dhoma mbushej me disa persona që nuk kishin lidhje të drejtpërdrejtë me projektin. Një prej këtyre rasteve që ka lënë një mbresë të thellë te një për zbatuesve të projektit qe euforia e komunitetit kur u shpall se projekti qe përzgjedhur si shembull i praktikës së mirë. Kjo tregon se shumë komunitetit ky projekt i duket si i veti dhe se sa krenar është për të. Përfshirja e komunitetit dhe vlerësimi për aktivitetet dhe rezultatet e kanë siguruar më tej qëndrueshmërinë në kohë të projektit, duke qenë se tregon se mund të ketë angazhim për ta çuar më tej edhe kur të mungojnë financat e jashtme.

### *Faktori udhëheqës*

Bashkia e Staro Nagoriçanes dhe anëtarët e pakicës së synuar e kishin shumë të fortë ndjenjën se ky projekt dhe rezultatet e tij qenë të tyre. Projekti ka lënë një mbresë shumë të thellë në këtë bashki dhe për këtë arsye komuniteti po kërkon në mënyrë kreative mënyrat se si të financohen edhe në të ardhmen komponentët e projektit. Bashkia po planifikon tashmë të caktojë fonde nga buxheti i saj për vijimin e mësimëve të valleve.

### *Elementet kryesore të përsëritshme*

Në elementet kryesore të përsëritshme të këtij projekti që mund të zbatohen gjetkë përfshihen:

► Trajnimi dhe angazhimi i grave

Gratë lokale mund të trajnohen për prodhimin e produkteve artizanale. Mund të jetë prodhimi i veshjeve popullore, sidomos nëse kjo ndërthuret me kurse për mësimin e valleve. Por gratë mund të mësohen edhe për produkte të tjera, si poçeri, receta gatimi tradicionale ose aspekte të tjera të rëndësishme për një kulturë dhe komunitet të caktuar. Përmes trajnimeve, gratë fitojnë jo vetëm

shprehi, por edhe fuqizohen sepse punësohen dhe zhvillojnë pavarësi financiare. Krahas kësaj, ky aktivitet ka potencialin e lartë për të qenë i qëndrueshëm në kohë dhe afatgjatë.

► Mësimet e valleve dhe koncertet

Mësimet e valleve kanë kontribuar shumë në suksesin e këtij projekti sepse tregonin jo vetëm vallet e mësuara përmes koncerteve, por edhe punën e dorës të grave të trajnuara. Përmes kurseve të rregullta, fëmijët mësuuan të kërcëjnë valle të ndryshme, të vlerësojnë kulturën e tyre dhe të jenë të motivuar për të qenë aktivë. Aktivitete të tilla janë të rëndësishme për komunitetet e vogla ku mundësitë për pjesëmarrje janë të kufizuara. Përmes mësimave të valleve fëmijët janë motivuar dhe janë ndier më të përfshirë. Koncertet kanë shërbyer si një stimul për fëmijët, por edhe si aktivitete ku merr pjesë i gjithë komuniteti. Gjithashtu, ato kanë qenë një mundësi për komunitetin shumicë që të zhvillojë një vlerësim për kulturën dhe traditën e komunitetit pakicë.

► Shtëpia Etnografike, një ekspozitë publike e produkteve

Shtëpia Etnografike, e cila ndodhet në një shtëpi të vjetër me një dhomë në Staro Nagoriçane, ishte vendi ku janë ekspozuar produktet e projektit si edhe punë të tjera artizanale që kishte bashkia. Shtëpia Etnografike është një ide pozitive që vlen të zbatohet edhe në vende të tjera sepse krijon një ndjesi përkatësie në komunitetin dhe vlerësim për projektin, sepse duke i ekspozuar produktet jep mesazhin se këto produkte i përkasin bashkisë në tërësi dhe komuniteteve. Gjithashtu, është edhe një pikë turistike që mund të zgjasë në kohë sepse në këtë rast është përdorur një ndërtesë publike dhe mund të kërkohet një tarifë minimale ose të vendoset një kuti për donacione në mënyrë që të sigurohen fondet për vazhdueshmërinë në periudhën afatgjatë.

**Përfitimet:**

1. E bashkon komunitetin minoritar dhe jo minoritar, sidomos në bashkitë me zona të banuara të largëta dhe të shpërndara, forcon marrëdhëniet ndëretnike dhe dialogun ndërkulturor.
2. Kontribuon në drejtim të fuqizimit të grave lokale dhe, në këtë mënyrë, edhe në drejtim të pjesëmarrjes së tyre në jetën publike, shoqërore dhe ekonomike.
3. Kontribuon në mbijetesën dhe ruajtjen e traditave kulturore nga brezat e rinj.
4. Rigjallëron jetën shoqërore dhe kulturore lokale, përfshirë kulturën minoritare.


## Përfundime dhe rekomandime

---

Të drejtat dhe aktivitetet kulturore shpesh lihen jashtë fushave të financimit, meqë shpesh nuk janë prioritet. Por ky projekt tregon efektin që mund të kenë ngjarjet kulturore te rigjallërimi i një shoqërie. Ajo që e bën veçanërisht të suksesshëm

këtë prjekt është fakti se aktivizimi dhe zhvillimi kulturor arrihen përmes ngritjes së aktiviteteve të qëndrueshme në kohë si themelimi i degës lokale të OJQ-së "Srpski vez", trajnimi i grave për të prodhuar veshje dhe ornamente popullore dhe mësimet dhe koncertet e valleve për fëmijët. Për të siguruar që ky projekt të jetë një sukses edhe në të ardhmen dhe të përmbushë potencialin e tij, rekomandohet sa vijon:

- ▶ **Fuqizimi i punishtes së grave të jetë një subjekt më vete.** Punishtja e grave ka potencialin dhe elementet e nevojshme për të qenë një sipërmarrje ekonomike. Duke e bërë punishten të pavarur si një sipërmarrje të re, gratë e angazhuara do të mbështeteshin te puna e tyre, dhe për më tepër do të zhvillonin shprehi të tjera si administrimi i një biznesi. Gratë e trajnuara mund të trajnojnë gra të tjera dhe ta zgjerojnë biznesin. Por duke konsideruar se mjetet e përdorura i përkasin projektit, punishtja mund të vijojë t'i shërbejë grupit të valleve jo vetëm përmes prodhimit të veshjeve, por edhe riparimit të tyre sipas nevojës.
- ▶ **Mbështetja nga institucionet shtetërore.** Duke konsideruar efektin pozitiv të këtij projekti, institucionet shtetërore si Ministria e Kulturës është mirë të mendojnë dhënien e një kontributi në drejtim të qëndrueshmërisë financiare të projekteve të tilla, meqë kanë përfitime për publikun. Këto përfitime janë jo vetëm për komunitetin lokal por edhe fakti se ky projekt kontribuon në drejtim të detyrimeve që i dalin shtetit nga KMPK si edhe në drejtim të pasurimit të bashkisë me pika të ndryshme turistike. Në rastin e Staro Nagoriçanës, bashkia ka disa pika brenda kufijve të saj, pra është i pranishëm potenciali për rritje të turizmit duke qenë se, meqë turistët vijnë për këto pika turistike, mund të përfitojë edhe projekti.



## Staro Nagoriçane

Vlerësimi i praktikave më të mira në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë



# Vlerësimi i praktikave më të mira në Kosovë\*

---

Komunitetet jo shumicë në vendimmarrje

**Komuna e Vushtrrisë**

*Tema: Pjesëmarrja në sferën publike*

*Pakicat e prekura: serbe, turke, rome, ashkali*

## Hyrje

---

*Konteksti vendor: pakicat dhe bashkësia e tyre*

**M**brojtja dhe nxitja e të drejtave të pakicave në Kosovë\* sigurohen përmes disa ligjeve, strategjive dhe institucioneve. Në nivel shteti, Ministria për Komunitete dhe Kthim ka hartuar një strategji pesëvjeçare për komunitetet dhe kthimin, 2015–2020, për të rregulluar çështjen e të kthyerve në Kosovë\*, si edhe për të trajtuar nevojat e komuniteteve jo shumicë. Por në nivel komunal strategjia e hartuar dhe aprovuar nga Komuna Vushtrri është e vetmja në Kosovë\*.

Çështjet kryesore të komuniteteve jo shumicë<sup>240</sup> në Kosovë\* janë papunësia<sup>241</sup>, arsimi dhe liria e lëvizjes. Megjithëse Kosova\* ka një nivel të lartë papunësie në të gjithë popullsinë, komunitetet jo shumicë janë shpesh më të mënjanuara në tregun e punës, sidomos anëtarët e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane, të cilët kanë vështirësi në gjetjen e vendeve të punës për shkak të nivelit të arsimimit dhe paragjyqimeve nga shumica. Edhe komuniteti serb ka vështirësi në hyrjen në tregun e punës për shkak të mosnjohjes së diplomave që lëshon sistemi ose universitetet serbe.<sup>242</sup>

Komunitetet jo shumicë që jetojnë në Vushtrri gjithashtu vuajnë nga papunësia si edhe nga mundësia e kufizuar për të marrë shërbimeve (shëndetësore dhe arsimore). Vushtrria është një komunë me 67 fshatra, shumë prej të cilëve janë

---

240 Komunitetet minoritare në Kosovë\* përmenden ligjërisht si komunitete jo shumicë.

241 Shih raportet nga Raporti mbi Pulsin Publik nr.6 të UNDP; dhe "Kosovo Mosaic".

242 Raporti i katërt i vlerësimit të të drejtave të komuniteteve, nxjerrë nga Misioni i OSBE-së në Kosovë (2015), f. 19.

mjaft larg dhe të veçuar. Komunitetet jo shumicë, sidomos ato serbe dhe rome, shpesh jetojnë në zona që ndodhen larg shërbimeve kryesore, çka shkakton probleme për t'i arritur. Krahas kësaj, ka shumë pak mundësi ndërveprimi ndërmjet komuniteteve të ndryshme të komunës.

Në bazë të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 në Kosovë\*,<sup>243</sup> komuniteti serb përbën 1,5% të popullsisë,<sup>244</sup> komuniteti turk përbën 1,1%, ndërsa komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane përbëjnë, përkatësisht, 0,5%, 0,9% dhe 0,7%. Komunitetet e tjera përfshijnë ato boshnjake (1,6%), gorane (0,6%) dhe të tjera (0,1).<sup>245</sup> Komuna Vushtrri ka 69.870 banorë, ku shqiptarët përbëjnë shumicën me një popullsi prej 68.840 banorë. Komuniteti serb është komuniteti i dytë më i madh me 384 banorë, ndërsa komuniteti turk është i treti me 278 banorë. Komuniteti rom ka 68 anëtarë, ndërsa ai ashkali ka 143 anëtarë, ndërkohë që ka vetëm një banor të regjistruar si komunitet egjiptian dhe 33 anëtarë të komunitetit boshnjak.

### *Projekti: përgjigjja ndaj nevojave vendore*

Projekti “Komunitetet jo shumicë në vendimmarrje” është zhvilluar për të çuar përpara kapacitetet e komuniteteve jo shumicë, të shoqërisë civile dhe të komunës në mënyrë që të hartohet dhe aprovohet Strategjia komunale për integrimin e komuniteteve jo shumicë (2016–2021).

*“Ky projekt i ka bërë komunitetet ta ndiejnë se ato dhe nevojat e tyre kanë rëndësi.”*

Krahas kësaj, ky projekt ka bërë një investim më të drejtpërdrejtë në shoqëri nëpërmjet blerjes së pajisjeve sportive të cilat u janë shpërndarë komuniteteve të ndryshme në Komunën Vushtrri. Megjithëse blerja dhe shpërndarja e pajisjeve sportive të rinjve që u përkasin komuniteteve minoritare të ndryshme nuk lidhet drejtpërdrejt me qëllimin kryesor të projektit për ta çuar përpara rolin e komuniteteve jo shumicë në vendimmarrje, gjithsesi u integrua në projekt për të siguruar një rezultat më të prekshëm për projektin ku të merrte pjesë komuniteti i gjerë. Kjo do të ndihmojë edhe në integrimin e komuniteteve të ndryshme me njëri-tjetrin nëpërmjet aktiviteteve sportive.

Personat e intervistuar për këtë studim e konsideronin projektin të rëndësishëm sepse ai ka bërë që komunitetet jo shumicë në Vushtrri të ndihen se çështjen që i prekin merren seriozisht nga komuna. Siç e thanë një i intervistuar, një zyrtar komunal dhe një përfaqësues komuniteti: “Ky projekt i ka bërë komunitetet ta

243 Popullsia sipas përkatësisë etnike dhe gjinore, Regjistrimi i Popullsisë 2011, Agjencia e Statistikave të Kosovës <http://ask.rks-gov.net/sq/rekos2011>.

244 Përqindja e ulët e komunitetit serb erdhi si rezultat i bojkotit të regjistrimit të popullsisë nga komuniteti serb. Për më shumë, shih: <http://www.infoecmi.eu/index.php/ecmi-minority-figures-in-kosovo-census-to-be-used-with-reservations/>. Agjencia e Statistikave e Kosovës publikoi më pas një çmuarje të popullsisë serbe për komunat serbe në veri të Kosovës\*. Për këto rezultate, shih: Çmuarje e popullsisë së Kosovës 2011, publikuar në shkurt 2013.

245 Komuniteti malazez në Kosovë\* që përfshirë në kategorinë “të tjerë” në regjistrimin e popullsisë.

ndiejnë se ato dhe nevojat e tyre kanë rëndësi.” Një prej anëtarëve të pakicave të synuara vërejt se ka qenë hera e parë që kanë marrë pjesë në aktivitetet që kanë të bëjnë me komunitete jo shumicë dhe se kanë qenë të kënaqur me aktivitetet e lidhura me hartimin e strategjisë. Pajisjet sportive gjithashtu janë pritur mirë nga komunitetet në Vushtrri. Megjithëse hartimi i strategjisë mori një kohë më të gjatë për të mbaruar dhe do të kërkojë edhe më shumë kohë për t’u zbatuar dhe për të nxjerrë rezultate, pajisjet sportive janë parë si një aktivitet i drejtpërdrejtë ku do të merrnin pjesë një pjesë e madhe e komuniteteve jo shumicë dhe do të shiheshin rezultate të drejtpërdrejta.

Në raportin e parë për vendin të realizuar në kuadër të projektit të përbashkët BE-KiE “Nxitja e të drejtave të njeriut dhe e mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore”<sup>246</sup>, ku projektet u vlerësuan përpara zbatimit, risqet e mundshme të parashikuara qenë pritshmëria e ulët për sukses, niveli i ulët i organizimit të komuniteteve jo shumicë dhe mungesa e kanaleve të komunikimit me komunën.<sup>247</sup> Këto risqe janë kapërcyer nga ky projekt në shkallë të madhe, çka e rrit potencialin për qëndrueshmëri në kohë të projektit. Megjithëse në fillim projekti kishte pritshmëri të ulët, gjatë intervistave për këtë studim të gjithë personat e pyetur qenë optimistë dhe entuziastë për suksesin e projektit dhe besonin fuqimisht se Strategjia komunale për integrimin e komuniteteve jo shumicë, 2016–2020, do të zbatohet me sukses, për dy arsye: 1) puna e investuar nga zyrtarët komunalë gjatë hartimit të saj i shtynte personat e intervistuar të besonin se do të vijonin edhe me zbatimin e strategjisë; 2) mbështetja e kryetarit të Komunës Vushtrri i ka shtyrë personat e intervistuar të besojnë se nuk do të kenë pengesa në zbatimin e strategjisë në të ardhmen.

Projekti ndihmoi edhe në çuarjen përpara të organizimit të komuniteteve jo shumicë brenda komunës dhe në ndërgjegjësimin e tyre për të drejtat që kanë. Nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, si seminare dhe mbledhje publike me komunitetin, përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë u njohën me të drejtat e tyre si edhe me institucionet dhe mekanizmat kombëtare dhe vendore që ua sigurojnë këto të drejta. Krahas kësaj, këto aktivitete shërbyen për të vendosur një komunikim më të mirë ndërmjet komuniteteve, komunës dhe OSHC-ve vendore. Mbledhjet publike ndërmjet komunës dhe përfaqësuesve të komuniteteve qenë një mundësi ku komunitetet jo shumicë të shprehnin nevojat e tyre, si edhe komuna të njihet me këto. Nëpërmjet pjesëmarrjes së dy zyrtarëve komunalë, mbledhjet publike i njohën me situatën e komuniteteve jo shumicë. Siç e tha njëri prej zyrtarëve komunalë, “përpara mbledhjeve publike, nuk isha në dijeni të sistemit arsimor të komunitetit serb në komunën tonë”, duke e pasur fjalën për sistemin paralel të arsimit që ndodhet në Kosovë\*. Pra, projekti ka ndihmuar në çuarjen përpara të organizimit të komuniteteve jo shumicë si edhe në vendosjen e kanaleve të reja të komunikimit ndërmjet komunës dhe komuniteteve.

---

246 Shih “Nxitja e të drejtave të njeriut dhe e mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore”: Raporti i vlerësimit të parë të projektit.

247 “Nxitja e të drejtave të njeriut dhe e mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore”: Raporti i vlerësimit të parë të projektit, f.51.

## *Aktivitetet: krijimi i një hapësire gjithëpërfshirëse*

Rezultati kryesor i projektit ishte hartimi dhe miratimi i Strategjisë Komunale për Integrimin e Komuniteteve jo Shumicë 2016–2020. Një komision i krijuar rishtazi, i përbërë nga pesë nëpunës komunalë, nga të cilët një i përkiste komunitetit turk, dhe dy përfaqësues të OSHC-ve, njëri prej të cilëve i përkiste komunitetit serb, hartoi strategjinë e cila u miratua nga kuvendi komunal në nëntor 2015.

Për të filluar me hartimin e strategjisë, që në fillim u zhvillua një konsultim publik për rolin dhe rëndësinë e strategjisë komunale për integrimin e komuniteteve jo shumicë. U zhvilluan tri konsultime të tjera publike në zona të ndryshme të komunës, pas hartimit të strategjisë, për të marrë mendimet e të gjitha palëve të interesuara, përfshirë OSHC-të dhe institucionet e tjera publike. Këto takime shërbyen për të përcaktuar fushat prioritare që janë të rëndësishme për komunitetet minoritare, përfshirë: arsimi, marrja e shërbimeve shëndetësore, përdorimi i gjuhëve dhe pjesëmarrja e komuniteteve në vendimmarrje.

Për t'i përgatitur pjesëmarrësit për hartimin e strategjisë, si edhe për të kuptuar rëndësinë e saj dhe çështjen me të cilat përballen komunitetet jo shumicë, u zhvilluan dy seminare pune. Seminari treditor në Durrës, Shqipëri, me temën "Rritja e pjesëmarrjes së komuniteteve jo shumicë në proceset vendimmarrëse" mbledhi të gjitha palët përkatëse të interesit dhe realizoi debate për situatën e komuniteteve jo shumicë në Vushtrri. Seminari i dytë u zhvillua me qëllim finalizimin e strategjisë dhe temat kryesore të saj, së bashku me zyrtarët komunalë dhe përfaqësuesit e komuniteteve. U zhvillua një tryezë e rumbullakët për "Institucionet demokratike dhe integrimin" për t'i njohur më mirë palët e interesuara për rëndësinë e të drejtave të pakicave dhe të njeriut, si edhe për institucionet përkatëse që i sigurojnë këto të drejta.

Nëpërmjet projektit, u blenë dhe u shpërndanë pajisje sportive në komunitetet e ndryshme që jetojnë në Vushtrri. Krahas kësaj, projekti bleu fletore për fëmijët në nevojë që u përkasin komuniteteve në pozita të cenueshme. Këto aktivitete përbënin aspekte më të prekshme të projektit, duke e përfshirë komunitetin e gjerë dhe duke pasur efekt të menjëhershëm, në dallim nga strategjia që do të kërkojë më shumë kohë për t'u zbatuar.

## **Metodika**

---

Për këtë studim janë intervistuar njëmbëdhjetë persona, prej të cilëve pesë punonjës të komunës dhe anëtarë të grupit të posaçëm të punës, një qe përfaqësues OSHC dhe gjithashtu anëtar i grupit të punës dhe katër qenë anëtarë të pakicave të synuara dhe njëri qe mbikëqyrësi. Dy persona të intervistuar qenë femra, nëntë meshkuj.<sup>248</sup> Anëtarët e grupit të punës dhe disa anëtarë të

---

248 Me qëllim ruajtjen e anonimitetit, nuk do të bëhet e ditur përkatësia gjinore e pjesëmarrësve në anketë kur të citohen fjalët e tyre.

pakicave të synuara u intervistuan personalisht në komunën Vushtrri, tre anëtarë të pakicave të synuara u intervistuan me telefon, ndërsa konsulenti i Këshillit të Evropës me detyrën e mbikëqyrjes së projektit u intervistua nëpërmjet postës elektronike.

## Vlerësimi i projektit

---

Projekti për komunitetet jo shumicë në vendimmarrje e ka çuar përpara ndërgjegjësimin për të drejtat mes përfaqësuesve të pakicave dhe kapacitetet e tyre, si edhe njohuritë e punonjësve komunalë për çështjet e lidhura me komunitetet jo shumicë në komunën e tyre. Ai ka vendosur edhe kanale të reja komunikimi ndërmjet komunës dhe komunitetit. Strategjia komunale për integrimin e komuniteteve jo shumicë përbën një dokument afatgjatë që synon mbrojtjen dhe nxitjen e të drejtave të komuniteteve minoritare në Vushtrri.

### *Qëndrueshmëria në kohë*

Projekti për komunitetet jo shumicë në vendimmarrje ka një komponent që është i qëndrueshëm në periudhën afatgjatë: strategjinë komunale për integrimin e komuniteteve jo shumicë. Ka disa faktorë që e bëjnë këtë komponent të qëndrueshëm në kohë.

- Rritja e kapaciteteve të aktorëve kyç

Projekti zhvilli dy seminare dhe disa aktivitete të tjera me të gjitha palët e interesuara, përfshirë përfaqësues të komuniteteve serbe, turke, romë dhe ashkali, OSHC-të lokale dhe anëtarët e Kuvendit Komunal. Përfaqësuesit e komuniteteve përfshinin mësues, aktivistë dhe qytetarë që u përkasin komuniteteve jo shumicë të cilët kanë qenë aktivë brenda komunës në shprehjen e shqetësimeve të komuniteteve përkatëse. Fillimisht projekti zhvilloi një seminar pune se si të hartohet dhe shkruhet një strategji dhe për rëndësinë e pasjes së një dokumenti të tillë. Qasja gjithëpërfshirëse siguroi që të gjithë aktorët përkatës të ishin në gjendje të jepnin kontribut, të hartonin, të aprovonin dhe të merrnin pjesë në zbatimin e strategjisë. Kjo është me rëndësi sepse u jepte të gjithëve mundësi të informoheshin përse kjo strategji është e rëndësishme dhe si të hartohet dhe justifikohet ajo. Sipas pesë anëtarëve të intervistuar të grupit të punës, ky trajnim ishte thelbësor për t'i informuar për procesin e hartimit të një strategjie. Një prej anëtarëve të grupit të punës vërejti se ishte e rëndësishme përfshirja e anëtarëve të Kuvendit Komunal që nga fazat e hershme për të siguruar që të ishin të informuar për strategjinë në mënyrë që ta mbështesnin dhe miratonin në Kuvend. Kjo vendosi tonin e duhur jo vetëm për miratimin e strategjisë por edhe për përfshirjen e organeve kryesore që do të duhet ta zbatojnë këtë strategji në të ardhmen, duke siguruar qëndrueshmërinë në kohë dhe efektivitetin e strategjisë. Përfaqësuesit e komunitetit të pranishëm në seminar, takime dhe hartimin e strategjisë thanë se seminarët e punës u dhanë mundësi të mësojnë më shumë për të drejtat e

tyre ndërsa takimet u dhanë mundësi të shprehin drejtpërdrejt shqetësimet e komuniteteve të tyre në komunë. Një prej përfaqësuesve të komunitetit serb vërejtë se kishin ndihmuar në hartimin e strategjisë dhe në përcaktimin e fushave prioritare. Nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme komuniteteve jo shumicë iu dha rasti të ofronin një përshkrim realist të situatës së komuniteteve të tyre përpara zyrtarëve komunalë.

► Përmirësimi i marrëdhënieve brenda komunës

Zyrtarët komunalë e rritën besimin te njëri-tjetri. Gjatë intervistave doli qartë se zyrtarët komunalë kishin besim te aftësitë e kolegëve, si edhe të gjithë besonin se strategjia do të zbatohet. Krahas kësaj, të gjithë zyrtarët komunalë qenë entuziastë për punën e tyre në hartimin e dokumentit të strategjisë dhe për perspektivën e zbatimit të saj në të ardhmen. Disa zyrtarë komunalë kishin filluar tashmë lobimin me donatorë të jashtëm për financim për të siguruar zbatimin e strategjisë.

► Rritja e përfshirjes së organizatave lokale të shoqërisë civile

OSHC-të qenë pjesë integrale e zbatimit të këtij projekti, dhe jo vetëm që u përfshinë në aktivitetet e ndryshme të zbatuara nga projekti, por edhe qenë thelbësore për hartimin e strategjisë. OSHC "Sot, Nesër, Përgjithmonë", një organizatë e cila punon me komunitetet jo shumicë, por jo vetëm, kishte rolin e konstatimit të fakteve gjatë hartimit të strategjisë, duke siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm për zyrtarët komunalë të cilëve u qe ngarkuar detyra e hartimit të saj. Gjithashtu, përfshirja e OSHC-ve ndihmoi në komunikimin ndërmjet komuniteteve jo shumicë dhe komunës, meqë OSHC-të kanë një qasje më të ngushtë dhe më pak formale me komunitetet.

► Rritja e punës afruese me komunitetin

Komuna Vushtri zhvilloi katër takime publike me përfaqësues të komuniteteve jo shumicë për të diskutuar për problemet e tyre dhe për çështjet që janë me rëndësi për çdo komunitet. Mbledhjet qenë një mundësi e mirë ku komunitetet jo shumicë të shprehnin nevojat dhe shqetësimet e tyre, si edhe komuna të njihej me këto shqetësime. Dy përfaqësues të komuniteteve jo shumicë në këto mbledhje publike vërejtën se ato i kishin ndihmuar të lidheshin në rrjet me anëtarë të tjerë, si edhe të shprehnin shqetësimet e tyre. Edhe zyrtarët komunalë u shprehën se këto mbledhje qenë me përfitim sepse vërejtën se kishin fituar më shumë njohuri për çështjet që shqetësojnë komunitet jo shumicë.

### *Faktori udhëheqës*

Zyrtarët komunalë treguan një rol udhëheqës të fortë për strategjinë. Të gjithë zyrtarët komunalë të intervistuar përmendën mbështetjen e kryetarit të komunës në zbatimin e projektit dhe të strategjisë. Përfshirja e zyrtarëve komunalë në trajnimet dhe prezantimin e strategjisë, si edhe përfshirja e anëtarëve të Kuvendit Komunal në trajnimet që në fillim të projektit mundësuan një mbështetje të gjerë dhe faktor udhëheqës mbi projektin dhe, më e rëndësishme, mbi strategjinë.

Një rol i fortë udhëheqës u ndie nga vetë komuna, çka u duk nga lobimi i bërë nga ana e saj për financa shtesë për zbatimin e strategjisë. Megjithëse mbështetja politike e kryetarit të komunës dhe anëtarëve të Kuvendit Komunal, punonjësve të komunës si edhe e shoqërisë civile për këtë strategji është e fortë, komuniteti është më pak i angazhuar, me përjashtim të përfaqësuesve të komunitetit. Këtu me përfitim dolën pajisjes sportive, paçka se jo të lidhura me strategjinë. Duke qenë se ky aktivitet qe më i prekshëm dhe më imediat, ia doli mbanë të përfshinte një pjesë të madhe të komunitetit, si edhe të krijonte një atmosferë besimi dhe vlerësimi.

Çështje të rëndësishme që duhen mbajtur parasysh:

- **Vullneti dhe mbështetja politike:** duke qenë se kjo është strategji, pra një dokument i Bashkisë, është e rëndësishme që të ekzistojnë mbështetja dhe vullneti politik, dhe kjo mund të sigurohet nëse arrihet që pala lokale e bën të vetin këtë dokument dhe jep llogari për të.
- **Monitorimi:** pa mekanizma monitorimi, llogaridhënia dhe ndjekja e mëpasshme mund të pengohen seriozisht.

### *Elementet kryesore të përsëritshme*

Në elementet kryesore të përsëritshme të këtij projekti që mund të zbatohen gjetkë përfshihen:

- ▶ Strategjia për komunitetet jo shumicë:

Krijimi i në strategjie për komunitetet jo shumicë në nivel vendor është një sipërmarrje pozitive e cila mund të ndihmojë shumë në trajtimin e nevojave të komuniteteve vendore. Megjithëse Kosova\* e ka një strategji kombëtare, një strategji vendore është më e përshtatshme për trajtimin e çështjeve duke qenë se fokusohet drejtpërdrejt te nevojat vendore, ndërsa strategjitë kombëtare mund të japin drejtime më të përgjithshme ose të fokusohen në çështje që mund të mos kenë lidhje me kontekstin lokal të një komune të caktuar. Përfshirja e nëpunësve komunalë dhe përfaqësuesve të OSHC-ve dhe komuniteteve jo shumicë në hartimin e strategjisë është një praktikë pozitive sepse e rrit ndjesinë se ky dokument është i tyri, krahas rritjes së gjasave për zbatim meqë dokumenti kuptohet mirë nga personat përgjegjës për zbatimin e tij. Megjithëse njëri prej të intervistuarve vërejti se do të kishte qenë më mirë që strategjinë ta kishte hartuar një ekspert i jashtëm, është pikërisht angazhimi i aktorëve vendorë ajo që i rrit gjasat e zbatimit. Ndërkohë që mund të angazhohet një këshilltar apo konsulent i jashtëm, zyrtarët vendorë duhet të jenë pjesë integrale e procesit të hartimit të strategjisë.

- ▶ Seminaret e punës për palët përkatëse të interesit

Seminaret e punës janë një praktikë e mirë sepse i përshijnë të gjitha palët përkatëse të interesit (nëpunësit e pushtetit vendor, përfaqësuesit e komunitetit jo shumicë, anëtarët e Kuvendit Komunal, OSHC-të) të nevojshëm për konceptin,

hartimin, finalizimin dhe miratimin e strategjisë. T'i përgatisësh palët përkatëse të interesit dhe t'i informosh që nga fillimi i projektit dhe strategjisë, rritet efektiviteti i fazës së hartimit sepse të gjitha palët e interesit marrin të njëjtin informacion dhe njohuri. Është i rekomandueshëm edhe zhvillimi i seminareve të punës në fillim, në mes dhe në fund të fazës së hartimit të strategjisë, sepse mundësojnë përfshirjen e palëve të interesit në dy prej fazave të rëndësishme të hartimit të strategjisë. Seminari i parë i punës mund të shërbejë për të marrë informacion, si për mënyrën si të hartohet një strategji, por ashtu edhe për çështjet dhe pjesët përbërëse që duhen përfshirë në të në bazë të nevojave vendore. Seminari përfundimtar i punës mund të shërbejë për aprovimin e strategjisë dhe diskutimin e saj ndërmjet zyrtarëve vendorë, përfaqësuesve të komuniteteve dhe OSHC-ve përpara se t'i paraqitet organit vendor ose, sipas rastit, organit qendror.

► Mbledhjet publike me komunitetin jo shumicë

Mbledhjet publike kanë shërbyer për të përfshirë në diskutim komunitetet jo shumicë në përgjithësi. Kjo siguron që strategjia bazohet te nevojat vendore dhe i pasqyron ato. Përfshirja e komuniteteve jo shumicë nëpërmjet mbledhjeve publike është e rëndësishme, sepse i bën këto komuniteteve, shpesh të lëna mënjanë, pjesë të projektit si edhe pjesë të zgjidhjes së problemeve të tyre, u jep atyre forcë për të vepruar brenda njësisë së qeverisjes vendore, çka është një kusht i domosdoshëm. Krahas kësaj, këto mbledhje publike kanë shërbyer për të shkëmbyer ide si edhe për të rritur informimin e zyrtarëve komunalë për problemet që kanë komunitetet jo shumicë në këtë komunë. Numri i mbledhjeve publike mund të jetë i ndryshëm, por është e rëndësishme që ato të zhvillohen me komunitete të ndryshme jo shumicë të bashkuar në një vend, si edhe me një përfaqësim gjinor të drejtpeshuar. Një praktikë e mirë është edhe zhvillimi i këtyre mbledhjeve publike në vendndodhje të ndryshme, siç u veprua në Vushtrri, për të siguruar frekuentimin nga sa më shumë persona. Transporti mund të jetë problem, sidomos për grupet në pozita të brishta ekonomike, prandaj zhvillimi i këtyre mbledhjeve sa më pranë komuniteteve është i rëndësishëm.

**Përfitimet:**

1. Çuarja përpara e kapaciteteve bashkiake.
2. Përfshirja e aktorëve të ndryshëm në çështjet e komunitetit.
3. Shprehja e nevojave të komuniteteve që nuk janë shumicë.
4. Rritja e faktorit udhëheqës të zyrtarët bashkiakë.
5. Dokument dhe zgjidhje që zgjasin shumë.

## Përfundime dhe rekomandime

---

Ky projekt, nëpërmjet seminareve të punës dhe hartimit të vetë strategjisë, i ka çuar përpara kapacitetet e zyrtarëve komunalë, si edhe kapacitetet dhe organizimin e komuniteteve jo shumicë të kësaj komune, të gjithë tregues që mund të sigurojnë

qëndrueshmërinë në kohë të këtij projekti. Gjithashtu, përfshirja e aktorëve të ndryshëm të çështjeve të komuniteteve të kësaj komune në çdo fazë të projektit siguroi një rritje të rolit të udhëheqës nga ana e të gjithë këtyre aktorëve për të gjetur zgjidhje për problemet që janë të rëndësishme për komunitetet jo shumicë. Në veçanti, roli i angazhuar i zyrtarëve komunalë, si në zbatimin e projektit, ashtu edhe në hartimin e strategjisë, solli rritje të rolit udhëheqës të këtyre zyrtarëve, duke bërë që ata të ndihen të investuar në zbatimin e ardhshëm të strategjisë, si edhe rritje të besimit se janë personat e duhur për t'i çuar përpara objektivat e saj. Në fund, Strategjia komunale për integrimin e komuniteteve jo shumicë, 2016–2020, është një dokument afatgjatë me zgjidhje afatgjata, dhe roli i fortë udhëheqës dhe kapacitetet e rritura të zyrtarëve komunalë dhe komuniteteve jo shumicë do të veprojnë si masa mbrojtëse dhe garantues për zbatimin e saj.

Për të siguruar qëndrueshmërinë në kohë dhe suksesin e vazhdueshëm të projekteve të tilla, jepen rekomandimet e mëposhtme:

- ▶ **Përfshirja e njësisë së pushtetit vendor dhe e komunitetit minoritar.** Komuna është bartësi kryesor i strategjisë, nëse kemi parasysh se është një dokument zyrtar i miratuar nga Kuvendi Komunal, dhe është organi kryesor të cilit i është ngarkuar zbatimin i saj. Komunitetet jo shumicë duhen përfshirë në procesin e zbatimit, jo vetën në marrjen e përfitimeve, por edhe në gjetjen e zgjidhjeve. Kjo mund të organizohet nëpërmjet mbledhjeve publike dhe përfshirjes së përfaqësuesve të pakicave në hartimin e vetë strategjisë. Në këtë aspekt, entuziazmi dhe pritshmëria e strategjisë nuk do të binte pas pak kohe dhe do të krijohej një presion i vazhdueshëm mbi njësinë e pushtetit vendor për të vazhduar me zbatimin e saj.
- ▶ **Mekanizmat e monitorimit.** Njëri nga personat e intervistuar që skeptik për zbatimin e projektit, për shkak të mungesës së një mekanizmi monitorimi. Madje, për të siguruar zbatimin e strategjisë, si edhe për të vlerësuar efektet e saj, është i këshillueshëm zhvillimi i një mekanizmi monitorimi, ose brenda njësisë së pushtetit vendor, ose duke kërkuar ndihmë nga OSHC vendore ose të jashtme ose nga ekspertë të pavarur.
- ▶ **Llogaridhënia.** Përfshirja e njësisë së pushtetit vendor dhe e komunitetit, si edhe zhvillimi i mekanizmave të monitorimit, do të çojë në rritje të llogaridhënies. Komuna do të japë llogari përpara qytetarëve të Vushtrrisë nëse parashikohet qartë progresi i zbatimit të strategjisë dhe nëse komunitetet marrin pjesë në zbatim duke i dhënë mundësi suksesit.





**Komuna e  
Vushtrisë**



### III. Rekomandime

---

**Q**ëllimi i këtij publikimi është të bëjë një analizë të thellë të zbatimit në praktikë të projekteve për mbrojtjen e pakicave kombëtare në nivel vendor në shtatë vende të Evropës Juglindore, me synim nxjerrjen e përfundimeve përgjithësuese dhe gjetjen e elementeve të përsëritshme. Në këtë pjesë, ky studim mëton t'i japë lexuesit rekomandime për punën e ardhshme për përmirësimin e nxitjes së të drejtave të pakicave në kushtet lokale, në këto fusha të mbrojtjes së të drejtave të pakicave: kultura, arsimit, përdorimi i gjuhës dhe pjesëmarrja politike. Këto përmbledhen me një grup rekomandimesh të përgjithshme.

#### *Kultura minoritare*

- ▶ **Të nxiten përpjekjet sipërmarrëse për ruajtjen e kulturës.** Projekti i zbatuar në Nagoriçanën e Vjetër tregon se iniciativa tregtare është një rrugë për çuarjen përpara të të drejtave kulturore të pakicave. Shtetet me komunitete minoritare duhet të nxisin dhe stimulojnë përpjekjet sipërmarrëse që synojnë mbrojtjen e një kulture të caktuar. Në bashkinë e Nagoriçanës së Vjetër, rrobaqepësia e grave dhe mësimet e valleve janë aktivitete me qëndrueshmëri në kohë. Kanë nevojë vetëm për investim dhe mbështetje gjersa të bëhen të qëndrueshme nga ana financiare. Kjo është një praktikë e mirë për t'u zbatuar jo vetëm sepse mban veten dhe çon përpara të drejtat kulturore, por edhe sepse u gjen punë komuniteteve minoritare dhe e përfshin shoqërinë e gjerë.

#### *Të drejtat gjuhësore*

- ▶ **Të përmirësohet ndërgjegjësimi për të drejtat gjuhësore.** Siç konfirmohet në këtë studim nga rastet e Suboticës dhe Pulës, gjuhët minoritare mbeten jo të përdorura shpesh në sferën publike për shkak të nivelit të ulët të njohurive dhe/ose pranimin nga autoritetet për përdorimin e gjuhëve minoritare. Kështu, anëtarët e pakicave ende preferojnë t'u drejtohen autoriteteve në gjuhën e shtetit, për të evituar problemet, keqkuptimet dhe vonesat burokratike. Ky trend forcohet më tej nga pozita dominuese që ka gjuha shtetërore në arsim, media dhe tregun e punës. Prandaj, është mirë që autoritetet të jenë më proaktive në ndërgjegjësimin për të drejtat gjuhësore të popullsisë minoritare dhe asaj shumicë, si edhe brenda administratës shtetërore. Në këtë aspekt, një rol thelbësor mund të luajnë mediat minoritare dhe ato kryesore.

- ▶ **Të vendoset njohuria e gjuhës si kërkesë punësimi.** Për të siguruar përdorimin e gjuhës minoritare në sferën publike në ato njësi të vetëqeverisjes vendore ku janë në përdorim zyrtar dy ose më shumë gjuhë, rekomandohet vendosja e një kërkesë gjuhësore për postet në administratën publike që përfshijnë komunikim dhe dhënie shërbimesh publikut. Gjithashtu, është mirë t'u ofrohen të gjithë punonjësve të tjerë të administratës publike kurse të gjuhëve minoritare, si edhe të nxiten të marrin pjesë në këto kurse. Autoritetet mund të marrin në konsideratë mundësinë e ofrimit të përfitimeve financiare ose sociale shtesë nëpunësve civilë që arrijnë një nivel të caktuar zotërimi të një gjuhe minoritare në një test të akredituar. Siç e tregon rasti i Bashkisë Pulë, kurset e gjuhës mund të organizohen në bashkëpunim me organizatat minoritare lokale.
- ▶ **Shteti të marrë një rol proaktiv në garantimin e larmisë gjuhësore.** Rekomandohet që shtetet të vendosin në dispozicion formularë dygjuhësh për t'u përdorur në marrëdhëniet me administratën publike dhe të mbështetin krijimin dhe zhvillimin e burimeve të terminologjisë administrative dhe teknike në gjuhët minoritare kryesore. Kjo përfshin përdorimin e tabelave në gjuhët minoritare edhe atëherë kur kjo nuk kërkohet me ligj. Kështu, praktikat jozyrtare të tabelave në disa gjuhë mund të sinjalizojnë pranimin e pakicave, t'u sigurojnë atyre një identifikim më të mirë pranë autoriteteve vendore dhe t'u sinjalizojnë shumicave përfshirjen e pakicave.

### ***E drejta për arsimim***

- ▶ **Të rritet mbështetja për asistentët arsimorë nëpërmjet rolit të shtuar të ndërmjetësuesit.** Rolet e asistentit arsimor dhe ndërmjetësuesit vlen të përhapen sepse mund të ndihmojnë në zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe efikas për t'i ndihmuar nxënësit minoritarë të bëjnë përpara në sistemin arsimor. Ndërmjetësuesit dhe asistentët arsimorë është mirë të punojnë së bashku, ngaqë rolet e ndryshme që kanë janë në plotësim të njëri-tjetrit. Ndërkohë që roli i ndërmjetësuesit është të kontribuojë në drejtim të vendosjes së marrëdhënieve ndërmjet nxënësve që i përkasin shumicës dhe nxënësve minoritarë, ndërmjet shkollës dhe prindërve dhe, mundësisht, ndërmjet pushtetit vendor dhe prindërve, roli i asistentit arsimor duhet të jetë të ndihmojë fëmijët në shkollë, të mundësojë dhe organizojë orë mësimi jashtëshkolllore dhe të përditësojë bazën e të dhënave dhe evidencat. Si ndërmjetësuesi, ashtu edhe asistenti arsimor, është mirë të merren në punë me kontrata afatgjata, duke qenë se besimi ndërmjet tyre dhe anëtarëve të komuniteteve minoritare është i rëndësishëm maksimale për suksesin e aktiviteteve të tyre.
- ▶ **Të vendosen zyra të komuniteteve brenda shkollave:** Krahas krijimit të roleve të ndërmjetësuesit dhe asistentit arsimor, organet qendrore dhe vendore është mirë të mendojnë vendosjen e zyrave të

komunitetit nëpër shkolla, si Info Spot në Tivat. Përmes pasjes së një zyre, komunitetet kanë një vend ku mund të shprehin drejtpërdrejt shqetësimet e tyre. Kjo ka qenë e dobishme edhe për mësuesit, sepse kishin një pikë referimi në rastet kur kishin problem me ndonjë nxënës minoritar. Përveç se është e lehtë për prindërit, mësuesit dhe fëmijët të cilëve nuk iu duhej të shkonin gjetkë për orët mësimore jashtëshkollore apo të shkonin në ndonjë zyrë jashtë mjediseve të shkollës duke rrezikuar lënien e orëve të mësimi, kjo zyrë që e rëndësishme sepse u jepte më shumë legjitimitet roleve të ndërmjetësuesit dhe asistentit arsimor, meqë e ushtronin aktivitetin e tyre brenda mjediseve të shkollës. Në fund, kjo zyrë kontribuon në drejtim të krijimit të ndjesisë së përkatësisë. Nxënësve minoritarë dhe prindërve të tyre kjo zyrë u dukej si e tyreja, çka bën që të ndiheshin të mbrojtur brenda ndërtesës së shkollës, gjë që është e rëndësishme, sidomos për komunitetet që janë të përjashtuara dhe të mënjanuara.

- ▶ **Të zhvillohen orë mësimore jashtëshkollore për nxënësit që mbeten pas:** Orët mësimore jashtëshkollore në Tivat kanë kontribuar shumë në drejtim të suksesit të nxënësve minoritarë. Kurse të tilla është mirë të zhvillohen nga ministritë e arsimit, sidomos në rastet kur ka një pengesë gjuhësore, si në Tivat. Kurset kanë ndihmuar me ecurinë e nxënësve, duke u dhënë atyre mundësinë të kenë besim te vetja, por edhe duke i ulur gjasat për braktisje të shkollës, e cila mund të vijë edhe nga acarimi për shkak të moskuptimit të materialeve në orën e mësimi. Gjithashtu, mund të vendoset edhe një sistem i marrjes në patronazh të shokëve, ku nxënës më të mëdhenj në moshë, si nga komuniteti shumicë, ashtu edhe nga komuniteti pakicë, mund të marrin në patronazh për mësim nxënës të cilët kanë vështirësi. Nxënësit që kanë marrë në patronazh shokë me vështirësi në mësim mund të marrin bursa ose stimuj të tjerë, si libra apo pajisje shkollore. Kjo mund të kontribuojë në drejtim të një integrimi dhe komunikimi më të mirë ndërmjet nxënësve. Aktivitetet ku përfshiheshin si nxënës të pakicave ashtu edhe të shumicës perceptoheshin si shumë pozitive në Tivat, sepse qenë thelbësore në kapërcimin e paragjyqimeve, prandaj është mirë të nxiten aktivitetet që i bashkojnë nxënësit pas orarit të shkollës ose jashtë shkollës.

### ***Pjesëmarrje e efektshme në jetën publike***

- ▶ **Krijimi i komiteteve civile ose lloje të tjera të organeve këshillimore/konsultative në nivel të qeverisjes vendore.** Një nga problemet e hasura në disa njësi të qeverisjes vendore ishte niveli i ulët i organizimit i komiteteve minoritare. Ky nivel i ulët i organizimit çon edhe në mosshprehje të nevojave të këtyre komuniteteve përpara institucioneve vendore ose qendrore. Komitetet civile, si ai i ngritur në Përmet, mund të ndihmojnë në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve të përfaqësuesve të komunitetit vendor dhe në drejtim të rritjes së përfshirjes në vendimmarrje. Si alternativë, njëسيا e qeverisjes vendore mund të angazhohet me komunitetit përmes mbledhjeve, si ato të zhvilluara

në Vushtrri në kuadër të strategjisë, apo në mbledhje bashkiake për të siguruar që komunitetet të përfshihen në marrjen e vendimeve apo hartimin e politikave që u përkasin.

- ▶ **Të rriten kapacitetet e përfaqësuesve të komuniteteve.** Është e rëndësishme që përfaqësuesit e komuniteteve, pavarësisht nëse janë përfaqësues politikë zyrtarë ose përfaqësues jozyrtarë si pleqësi apo figura të respektuara në nivel lokal, të kenë kapacitetet për t'i njohur të drejtat e komuniteteve dhe mekanizmat e zgjidhjes së tyre. Përmeti dhe Vushtrria punuan gjerësisht në ngritjen e këtyre kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve për të drejtat e njeriut dhe të pakicave dhe për instrumentet dhe mekanizmat përkatëse, në nivel rajonal, kombëtar dhe vendor. Kjo ka kontribuar në drejtim të zbatimit të projekteve përkatëse duke qenë se përfaqësuesit e komuniteteve u përfshinë më shumë në vendimmarrje, por edhe ka hedhur themelin për një organizim më të mirë të komuniteteve minoritare në nivel vendor.

### ***Bërja e politikave***

- ▶ **Zhvillimi i strategjive vendore për zbatimin e të drejtave të pakicave.** Strategjitë kombëtare shpesh priren t'i japin prioritet një grupi ose një çështjeje mbi të tjerat, duke mos vendosur kështu në objektivi çështjet me të cilat përballen komunitete të caktuara në nivel vendor. Për këtë arsye, strategjitë e hartuara në nivel vendor do të kontribuonin për të pasur politika me objektivi të përcaktuar më saktë, sidomos në ato vend ku ka administratë publike të decentralizuara. Strategjia e hartuar nga Vushtrria jep një shembull pozitiv sepse pasqyron mendimet dhe përvojat e komuniteteve vendore. Krahas kësaj, strategjia është hartuar nga zyrtarë komunalë dhe përfaqësues të komunitetit, duke krijuar kështu një ndjesi të përbashkët pronësie mbi këtë dokument, çka e rrit kërkesën për zbatimin e tij, si edhe gjasat për sukses.
- ▶ **Zhvillimi dhe mirëmbajtja e bazave të të dhënave për të përmirësuar politikat dhe planifikimin.** Sikurse vërehet në hyrje, shpesh ka një mungesë statistikash zyrtare të përditësuara për numrin e pakicave në një njësi të caktuar të qeverisjes vendore. Për këtë arsye, do të ishte mirë të nxiteshin njësitë e qeverisjes vendore të zhvillonin baza të dhënash në bazë të nevojave ose fushave me interes. Tivati zhvilloi një bazë të dhënash enkas për numrin e nxënësve aktualë dhe të mundshëm në bashki. Kjo është bërë nëpërmjet konsultimit të evidencave zyrtare si edhe nëpërmjet vizitave në terren. Kjo bazë të dhënash mund të ndihmojë në zhvillimin e kurseve dhe politikave në të ardhmen. Edhe Përmeti zhvilloi një bazë të dhënash për të ndjekur nevojat shoqëro-ekonomike të komuniteteve egjiptiane, sidomos për të vlerësuar kushtet e strehimit dhe nevojën për dritare. Ky është gjithashtu një përdorim efikas i bazës së të dhënave, sepse bashkia mund të kategorizojë nevojat e komuniteteve dhe familjeve në mënyrë që t'i shpërndajë si duhet fondet.

## **Rekomandime të përgjithshme**

- ▶ **Të përmirësohet kapaciteti financiar.** Edhe atëherë kur ka vullnet të fortë politik për ta përmirësuar mbrojtjen e pakicave kombëtare në nivel vendor dhe rajonal, palët e interesit përballen me vështirësi të mëdha sa u takon burimeve financiare për shpenzime shpesh të kushtueshme që janë të lidhura me punën e tyre, siç u pa në rastin e Bashkisë Subotićë dhe Bashkisë Pulë. Kur vëren trendin e përgjithshëm të amullisë apo ndonjëherë edhe të pakësimit faktik të mjeteve financiare të caktuara për promovimin e të drejtave të pakicave në vendet e Evropës Juglindore, e përkeqësuar më tej nga kriza ekzistuese financiare, mund të arrihet në përfundimin se nevojitet një nivel më i lartë decentralizimi fiskal kur bëhet fjalë për punën lokale dhe rajonale për nxitjen e të drejtave të pakicave. Me fjalë të tjera, është e rëndësishme të sigurohet një kapacitet financiar i qëndrueshëm në kohë për njësitë e ndryshme të qeverisjes vendore, që shpesh kanë nevoja më të mëdha financiare se ato me shumë pak ose aspak pakica, meqë zbatimi i të drejtave të pakicave nuk është pa pasoja në kosto. Në fund, është mirë që donatorët ndërkombëtarë të tregojnë një angazhim më të madh në drejtim të projekteve që nxisin të drejtat e pakicave në nivel vendor dhe rajonal.
- ▶ **Të sigurohet mbështetja e popullsisë në shumicë.** Zbatimi i efektshëm i projekteve për nxitjen e të drejtave të pakicave kushtëzohet nga mbështetja e popullsisë shumicë për masa të tilla dhe nga vullneti politik i përfaqësuesve të zgjedhur. Në këtë aspekt, është e nevojshme të sigurohet mbështetje më e gjerë për masa të tilla nga shumica e popullsisë. Kjo mund të bëhet përmes aktiviteteve të punës afruese, si debatet publike, aktivitetet me mediat, fletëpalosjes, fletushkat dhe madje edhe vizitat derë më derë sidomos në njësitë e vogla të vetëqeverisjes vendore, por edhe përmes hartimit të projekteve nga të cilët përfiton edhe komuniteti shumicë, për të krijuar një situatë nga e cila përfitojnë të gjithë. Për shembull, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku SMD ende nuk është futur në përdorim, mund të ofrohet menjëherë edhe në një ose më shumë gjuhë minoritare, në varësi të numrit të anëtarëve të komuniteteve minoritare që jetojnë në të.
- ▶ **Të përfshihen pakicat në punën për nxitjen e të drejtave të pakicave.** Formulimi dhe zbatimi i politikave që nxisin të drejtat e pakicave në nivel vendor dhe rajonal është mirë të marrë në konsideratë nevojat e komuniteteve minoritare. Prandaj është e rëndësishme që organizatat minoritare dhe anëtarët e pakicave të përfshihen në projektet që synojnë përmirësimin e pozitave të të drejtave të pakicave që në fazën fillestare të tyre, për të siguruar kështu që masat e ndërmarra nga vetëqeverisja vendore të pasqyrojnë nevojat e komunitetit dhe të kuptohen prej tij. Për të siguruar mbështetje për hartimin e projekteve për mbrojtjen e të drejtave të pakicave, është me rëndësi thelbësore të krijohen grupe të posaçme me palët e interesit që në fazën fillestare të përgatitjes së projektit.



## Bibliografia

---

Benedek Wolfgang e të tjerë, "Human Rights Mainstreaming in the EU Enlargement Process in the Western Balkans with a Special Focus on Minorities" (Integrimi i të drejtave të njeriut në procesin e zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor, me fokus të veçantë te pakicat), i realizuar me kërkesë të Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut të Parlamentit Evropian, 2012.

Jutta Engbers, "Artikel 10", në Sigrid Boysen e të tjerë (redaktorë) Europäische Charta der Regional- oder Minderheitensprachen. Handkommentar, 2011, f. 249–284.

Korhecz Tamás, "National Minority Councils in Serbia" (Këshillat e pakicave kombëtare në Serbi", në Tove H. Malloy e të tjerë (red.), Managing Diversity through Non-Territorial Autonomy. Assessing Advantages, Deficiencies, and Risks (Menaxhimi i diversitetit nëpërmjet autonomisë joterritoriale. Analizë e avantazheve, mangësive dhe risqeve), 2015, f. 69–91.

Lantschner Emma, "Emerging European Standards of Minority Protection through Soft Jurisprudence?" (Standardet e reja evropiane të mbrojtjes së pakicave përmes praktikës gjyqësore jo të detyrueshme), në Emma Lantschner e të tjerë (red.), European Integration and its Effects on Minority Protection in South Eastern Europe (Integrimi evropian dhe pasojat për mbrojtjen e pakicave në Evropën Juglindore), 2008, f. 53–83.

I njëjti autor, "Protection of Minority Communities in Kosovo: Legally Ahead of European Standards – Practically Still a Long Way to Go" (Mbrojtja e komuniteteve minoritare në Kosovë: ligjërisht më lart se standardet evropiane – praktikisht mbetet ende shumë për të bërë), 33(4) *Review of Central and East European Law*, 2008, f. 451–490.

Petričušić Antonija, "Non-Territorial Autonomy in Croatia" (Autonomia joterritoriale në Kroaci), në Tove H. Malloy e të tjerë (red.), Managing Diversity through Non-Territorial Autonomy. Assessing Advantages, Deficiencies, and Risks (Menaxhimi i diversitetit nëpërmjet autonomisë joterritoriale. Analizë e avantazheve, mangësive dhe risqeve), 2015, f. 53–68.

### Dokumente të Këshilli të Evropës:

Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare, shih tekstin e plotë në <http://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/148>

Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, shih tekstin e plotë në <http://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/157>

Raporti i Parë i Komitetit të Ekspertëve për zbatimin e Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare në Bosnjë dhe Hercegovinë, miratuar më 28 shkurt 2013.

Raporti i Pestë i Komitetit të Ekspertëve për zbatimin e Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare në Kroaci, miratuar më 24 shtator 2014.

Raporti i Tretë i Komitetit të Ekspertëve për zbatimin e Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare në Malin e Zi, miratuar më 2 dhjetor 2014.

Raporti i Tretë i Komitetit të Ekspertëve për zbatimin e Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare në Serbi, miratuar më 4 nëntor 2015.

Komiteti Këshillimor për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Opinioni i Tretë për Shqipërinë, miratuar më 23 nëntor 2011.

Komiteti Këshillimor për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Opinioni i Tretë për Bosnjën dhe Hercegovinën, miratuar më 7 mars 2013.

Komiteti Këshillimor për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Opinioni i Katërt për Kroacinë, miratuar më 18 nëntor 2015.

Komiteti Këshillimor për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Opinioni i Dytë për Malin e Zi, miratuar më 19 qershor 2013.

Komiteti Këshillimor për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Opinioni i Tretë për Serbinë, miratuar më 28 nëntor 2013.

Komiteti Këshillimor për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Opinioni i Tretë për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, miratuar më 30 mars 2011.

Komiteti Këshillimor për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Opinioni i Tretë për Kosovën\*, miratuar më 6 mars 2013.

Komiteti Këshillimor për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Shpjegues për të drejtat gjuhësore të personave që u përkasin pakicave kombëtare në bazë të Konventës Kuadër, ACFC/44DOC(2012)001, miratuar më 5 korrik 2012.

Komiteti Këshillimor për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Shpjegues për pjesëmarrjen e efektshme të personave që u përkasin pakicave kombëtare në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe në çështjet publike, ACFC/31DOC(2008)001, miratuar më 27 shkurt 2008.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Raport Dyvjeçar “Zbatimi i Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare” i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për Asamblenë Parlamentare, 3 mars 2014.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Raport Dyvjeçar “Zbatimi i Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare” i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për Asamblenë Parlamentare, 2 mars 2016.

Komisioni i Venecias, Raport për personat pa shtetësi dhe të drejtat e pakicave, miratuar më 15–16 dhjetor 2006 CDL-AD(2007)001.

GJEDNJ, “Oršuš dhe të tjerë – Kroaci”, Kërkesë-padi Nr. 15766/03, Vendim (i Kolegjit të Bashkuar) datë 16 mars 2010

GJEDNJ, “Sejdic and Finci – Bosnjë dhe Hercegovinë”, Kërkesë-padi nr. 15766/03, vendim i datës 22 dhjetor 2009.

## Dokumente të Komisionit Evropian

- ▶ Komisioni Evropian, Raporti 2015 për Shqipërinë.
- ▶ Komisioni Evropian, Raporti 2015 për Bosnjën dhe Hercegovinën.
- ▶ Komisioni Evropian, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Raport Progresi, 2014.

## Burime ligjore dhe dokumente zyrtare

---

### Shqipëria

- ▶ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998.
- ▶ Ligji për shtypin, 1993.
- ▶ Ligji për sistemin arsimor parauniversitar, 1995.
- ▶ Ligji për radiotelevizionin publik dhe privat, 1998.
- ▶ Vendim i Këshillit të Ministrave për krijimin e Komitetit Shtetëror të Pakicave, 2004.
- ▶ Rezultatet e regjistrimit të popullsisë (nivel shteti dhe qarku), 2011. Gjendet në adresën: <http://www.instat.gov.al/al/census/census-2011/të-dhënat-sipas-qarqeve.aspx>.

### Bosnja dhe Hercegovina

- ▶ Ligji Shtetëror për Pakicat Kombëtare, 2003.
- ▶ Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare i Republikës Srpska, 2005.
- ▶ Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare i Federatës së BH-së, 2006.
- ▶ Rregulla 57/2011 e Agjencisë Rregullatore të Komunikacioneve
- ▶ Regjistrimi i Popullsisë, Familjeve dhe Banesave në Bosnjë dhe Hercegovinë. 2013.

### Kroacia

- ▶ Kushtetuta e Republikës së Kroacisë, 1990.
- ▶ Ligji për përdorimin e gjuhës dhe alfabetit të pakicave kombëtare, 2000.
- ▶ Ligji kushtetues për mbrojtjen e pakicave kombëtare, 2002.
- ▶ Ligji për zgjedhjen e përfaqësuesve në parlamentin kombëtar, 2003.
- ▶ Ligji për mediat, 2004.
- ▶ Regjistrimi i Popullsisë, Familjeve dhe Banesave. 2011.

### Mali i Zi

- ▶ Kushtetuta e Malit të Zi, 2007.
- ▶ Ligji për të drejtat dhe liritë e pakicave, 2006.

- ▶ Ligji për mediat elektronike, 2010.
- ▶ Ligji i përgjithshëm për arsimin
- ▶ Zyra Statistike e Malit të Zi. Regjistrimi i Popullsisë. 2011. Gjetet në adresën: <http://www.monstat.org/eng/page.php?id=16>.
- ▶ Ligji për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve, 2012.

#### Serbia

- ▶ Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 2006.
- ▶ Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare, 2002.
- ▶ Ligji për zgjedhjen e përfaqësuesve, 2003.
- ▶ Ligji për zgjedhjet vendore, 2007.
- ▶ Ligji për Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare, 2009.
- ▶ Ligji për bazën e sistemit arsimor, 2009, 2011 dhe 2013.
- ▶ Ligji për arsimin parashkollor, 2009.
- ▶ Regjistrimi i Popullsisë në Serbi. 2011.
- ▶ Ligji për arsimin fillor, 2013.
- ▶ Ligji për arsimin e mesëm, 2013.
- ▶ Statuti i Krahinës Autonome të Vojvodinës, 2014.

#### Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë

- ▶ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 2001.
- ▶ Ligji për nëpunësit civilë, 2000.
- ▶ Marrëveshja Kuadër e Ohrit, 2001.
- ▶ Ligji për vetëqeverisjen vendore, 2002.
- ▶ Ligji për arsimin e mesëm, 2002.
- ▶ Rezultate e regjistrimit të popullsisë, 2002. Gjetet në adresën: <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/knigaXIII.pdf>.
- ▶ Ligji për aktivitetin e transmetimeve, 2005.
- ▶ Ligji për Komitetin për Marrëdhëniet Ndëretnike, 2007.
- ▶ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve të Folura nga të paktën 20% e Shtetasve të Republikës së Maqedonisë dhe Njësive të Qeverisjes Vendore, 2008.
- ▶ Ligji për arsimin fillor, 2008.
- ▶ Ligji për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave që u përjasin komuniteteve që përbëjnë më pak se 20% të popullsisë, 2008.

#### Kosova\*

- ▶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.
- ▶ Ligji për përdorimin e gjuhëve, 2006.
- ▶ Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, 2008.

- ▶ Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, 2008.
- ▶ Çmuarja e popullsisë. 2011. Gjendet në adresën: <http://ask.rks-gov.net/sq/rekos2011>
- ▶ Statuti për themelimin e Këshillit Konsultativ për Komunitete në Kosovë, 2008.
- ▶ Ligji për Radiotelevizionin e Kosovës, 2012.
- ▶ Republika e Kosovës, Zyra e Komisionerit për Gjuhët, Monitorimi dhe vlerësimi i të drejtave gjuhësore në Kosovë, mars 2015, në adresën <http://www.ecmikosovo.org/uploads/English322.pdf>.

## Raporte dhe baza të dhënash

Kolegji i Evropës. “Nxitja e të drejtave të njeriut dhe e mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore”: Raporti i parë për të gjitha vendet për vlerësimin e parë të projektit. Gjendet në adresën: <http://pjp-eu.coe.int/documents/3513035/4042040/Cross+country+report/d4437d00-3d05-4003-88b1-3d5873b4a2f7>.

Kolegji i Evropës. “Nxitja e të drejtave të njeriut dhe e mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore”: Raport i dytë për të gjitha vendet për vlerësimin e ndërgjegjësimit. Gjendet në adresën: <http://pjp-eu.coe.int/documents/3513035/0/Awareness+Assessment+report+%28revised+and+final%29/99d8a80c-5d72-49d6-b804-61188cb10439>.

Informacion dhe udhëzues për vendin. 2014. Shqipëria: Grupet etnike minoritare, [https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/375421/CIG\\_Albania\\_Minority\\_ethnic\\_groups.pdf](https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/375421/CIG_Albania_Minority_ethnic_groups.pdf).

EIP. 2015 Marrëveshja Kuadër e Ohrit: Shqyrtim i Kohezionit Social. Gjendet në adresën: <http://www.eip.org/sites/default/files/OFA%20Review%20on%20Social%20Cohesion.pdf>

Freedom House. 2014. Liria në botë: Shqipëria. Gjendet në adresën: [https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2014/albania#.U\\_NYtfmMPMo](https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2014/albania#.U_NYtfmMPMo)

Minority Rights Group. Adresar botëror i pakicave dhe popujve indigjenë. Gjendet në adresën: <http://minorityrights.org/directory/>.

Misioni i OSBE-së në Kosovë. 2015. Raport vlerësimi i të drejtave të komuniteteve. Gjendet në adresën: <http://www.osce.org/kosovo/209956?download=true>.

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. Anketë për Opinionin Publik 2015 e “Balkan Barometer”, Sarajevë 2015.

Departamenti i Shtetit i SHBA-së. 2015. Raportet individuale për vendet në lidhje me praktikat për të drejtat e njeriut në 2015. Gjendet në adresën: <http://www.state.gov/j/drl/rls/hrrpt/humanrightsreport/index.htm#wrapper>.

UNDP. Raporti mbi pulsën publik nr.6. Gjendet në adresën: [http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Procurement/PPR6\\_Anglisht.pdf](http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Procurement/PPR6_Anglisht.pdf).

UNDP. Kosovo Mosaic. Gjendet në adresën: [http://www.lr.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo\\_Mosaic\\_2012\\_Eng\\_735317.pdf](http://www.lr.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Eng_735317.pdf).



# Shtojca

---

## Shtojca I – Metodika

Analiza e praktikave më të mira mbështetet në vizita studimore në njësitë e parapërzgjedhura të vetëqeverisjes vendore nga ekipi i CSEES në periudhën maj-korrik 2016. Gjatë vizitave studimore, janë intervistuar 53 persona gjithsej, për t'u marrë mendim mbi rezultatet, qëndrueshmërinë në kohë dhe elementet e përsëritshme të projekteve të kryera. Të intervistuarit u përkisnin dy kategorive: së pari, persona të përfshirë në zbatimin e projektit, përfshirë zyrtarë të pushtetit vendor dhe OSHC; së dyti, anëtarë të pakicave të synuara të projektit. Nga 53 persona të intervistuar, 19 qenë palë interesi të vetëqeverisjes vendore, 11 anëtarë të komuniteteve minoritare dhe përfaqësues të OSHC-ve të përfshira në zbatimin e projekteve dhe 23 anëtarë të pakicave të synuara jo të përfshirë në zbatimin e projekteve. U përgatit pyetësor më vete për personat e përfshirë në zbatimin e projektit, dhe pyetësor më vete për anëtarët e pakicave të synuara të projektit. Në rastet kur nevojitej më shumë informacion, ekipi kërkimor ka intervistuar edhe konsulentët e angazhuar nga Këshilli i Evropës për mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve.

Kapitujt dhe rastet studimore janë shkruar veçmas nga anëtarët e ekipit CSEES dhe janë shqyrtuar nga të gjithë. Kapitulli për kuadrin për mbrojtjen e pakicave në Evropën Juglindore është shkruar nga Emma Lantschner. Vlerësimi i praktikave të mira në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Malin e Zi është shkruar nga Lura Pollozhani, ndërsa rastet studimore në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci dhe Serbi janë shkruar nga Marko Kmezic. Florian Bieber ka mbikëqyrur dhe vlerësuar rezultat përfundimtare dhe ka bërë kontrollin e cilësisë.

## Shtojca II – Pyetësor për anëtarët e grupit të posaçëm të punës dhe OSHC-të (jo pakica të synuara)

1. Shpjegoni projektin, objektivat dhe aktivitetet kryesore dhe përfituesit kryesorë.
2. Kush ka qenë përfshirë më nga afër në zbatimin e projektit?
3. A kanë qenë të gjithë personat e përfshirë në projekt të njohur mirë me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre dhe a kanë qenë në nivelin e duhur?
4. Si i keni zbatuar aktivitetet? *(Kjo pyetje ka të bëjë me metodat e projektit, mund të jetë aktuale për disa prej projekteve se cilat metodat kanë përdorur, nëse kanë qenë të përshtatshme në kushtet e tyre. Kjo pyetje mund të përshtatet sipas projektit, për të parë se cilat metoda mund të përsëriten në të ardhmen, për shembull përfshirja e komunitetit dhe OJQ-ve etj.)*
5. Sipas çmuarjes suaj, si e vlerësoni bashkëpunimin ndërmjet grupeve (pushtetit vendor, OJQ-ve, komunitetit)?
6. Si është përfshirë komuniteti (si minoritar, edhe ai i gjerë) në zbatimin e projektit?
7. A keni pasur ndonjë problem në zbatimin e projektit? Cilat kanë qenë këto probleme dhe si i keni zgjidhur?
8. A keni pasur probleme njerëzore apo financiare?
9. (Nëse ka një komponent trajnim) Sa persona janë trajnuar nga projekti? Çfarë mendimi kanë ata për trajnimin dhe dobinë e tij? A janë ende të përfshirë në projekt, ose në aktivitete, ose në ndonjë mënyrë tjetër? A do t'i vazhdojnë aktivitetet pas përfundimit të projektit?
10. Çfarë ju ka pëlqyer në këtë projekt, në përgjithësi, dhe çfarë ju ka pëlqyer në rolin tuaj në projekt? Ndonjë histori interesante që doni të tregoni?
11. Si do ta vazhdonit këtë projekt? Në cilët komponentë do të investonit më shumë, ku do të kërkonit financim?
12. Çfarë do të ndryshonit në zbatimin e këtij projekti?
13. Cili aktivitet ishte më interesanti për komunitetin minoritar dhe komunitetin e gjerë? Përse?
14. A e ka mbështetur këtë projekt komuniteti dhe njësia e pushtetit vendor (komuniteti dhe institucionet)? Kush qe më mbështetës, kush qe më pak mbështetës?
15. Cili është një aktivitet apo rezultat novator në projektin tuaj?
16. A ka nxjerrë pushteti vendor ndonjë mësim nga projekti, a e ka ndryshuar sjelljen në lidhje me komunitetet?
17. A e ka përmirësuar projekti komunikimin ndërmjet pushtetit vendor dhe komunitetit? A ka hapur kanale të reja komunikimi?

18. Deri ku vazhdimi i këtij projekti varet nga vullneti politik i autoriteteve vendore ose shtetërore? *(Synimi këtu është për të vlerësuar nëse aktivitetet varen vetëm nga vullneti politik, që është problem po të kemi parasysh faktin se kryetarët e pushtetit vendor mund të mos rizgjidhen dhe mund të jenë më pak të gatshëm për ta mbështetur projektin, nëse projekti nuk ndihet si pjesë e komunitetit dhe e zyrtarëve të pushtetit vendor për t'i mbajtur objektivat e projektit edhe më pas.)*
19. A konsideroni projektin tuaj të suksesshëm në formën e fjalisë se “Ky projekt e ka përmirësuar jetën e komuniteteve që jetojnë në bashkinë apo komunën time”? Përse po/përse jo?
20. A mendoni se projekti mund të përsëritej në bashki dhe komuna të tjera me komunitete minoritare? Që të ishte e mundur kjo, çfarë kushtesh do të duhej të ekzistonin?

### Shtojca III – Pyetje për anëtarët e pakicës së synuar

1. Si morët pjesë në këtë projekt? (në çfarë mënyre ka ndihmuar anëtari i pakicës së synuar: trajnim, seminar pune etj.)
2. A pati projekti një efekt pozitiv apo negativ në jetën tuaj? Si?
3. Sipas mendimit tuaj, a kontribuoi projekti në përmirësimin e jetës së komunitetit tuaj në bashki ose komunë?
4. A do të merrnit pjesë në aktivitete të ngjashme në të ardhmen?
5. Çfarë ju pëlqeu konkretisht në këtë projekt?
6. A e rriti projekti nivelin e besimit dhe komunikimin që keni me pushtetin vendor?
7. Sipas jush, cilat probleme të komunitetit vendosi në objektiv projekti?
8. A ka sjellë ndonjë ndryshim projekti në sjelljen apo besimet tuaja në krahasim me më parë?
9. Ndonjë koment tjetër?



<http://pjp-eu.coe.int/en/web/minority-rights>  
<https://www.facebook.com/minority.protection>

ALB

[www.coe.int](http://www.coe.int)

Projekti i përbashkët rajonal I BE/KiE "Nxitja e të drejtave të njeriut dhe e mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore" është hartuar për të eliminuar barrierat përballë pakicave, në mënyrë që t'i gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre. Projekti mbështetet në faktin se përvojat dhe sfidat që ndihen në nivel vendor, përfshirë edhe burimet e kufizuara, mund të jenë shumë të ngjashme në vendet përfituese, dhe se masat praktike të ndërmarra me sukses në një njësi të vetëqeverisjes vendore për ta rritur kohezionin dhe mundësinë e gëzimit të të drejtave mund të jenë të dobishme edhe për të tjerat. Të gjithë komponentët e projektit janë hartuar në atë mënyrë që të ndryshojnë situatën e individëve në terren në mënyrë koherente dhe me grup të synuar qartë, mbështetur në standardet evropiane dhe në veçanti në Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KMPK) dhe në Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare (KEGJRM).



Centre for  
Southeast  
European  
Studies



Financuar nga  
Bashkimi Europian



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatuar nga  
Këshilli i Europës